

KISHA E JEZU KRISHTIT E SHENJTORËVE TË DITËVE TË MËVONSHME • PRILL 2015

Liahona



**Të Kuptuarit e
Sakrificës së Shenjtë
të Shpëtimtarit, f. 34**

**Përse të Jesh i Dobët
nuk Është Mëkat, f. 20**

**Si të Kesh Sukses në
Mbrëmjen Familjare, f. 10, 80**



*“Cili njeri prej jush, që ka njëqind dele dhe një prej tyre t’i humbasë, nuk i lë të nëntëdhjetë e nëntat në shkretirë dhe nuk shkon pas asaj që humbi deri sa ta gjejë?
Dhe, kur e gjen, e merr mbi supe gjithë gaz.”*

Luka 15:4-5



MESAZHET

- 4 Mesazhi i Presidencës së Parë: Presidenti Monson Bën Thirrje për Guxim**
Nga Presidenti Tomas S. Monson
- 7 Mesazhi i Vizitave Mësimore: TËpare të Jezu Krishtit – Pa Mashtrim ose Hipokrizi**

ARTIKUJT KRYESORË


- 14 Ndikimi Shpirtëror i Grave**
Nga Starla Oerkemp Batler
Ndikimi juaj si grua shtrihet përtej asaj që mund të shihet.
- 20 Nuk Është Mëkat të Jesh i Dobët**
Nga Uendi Ulrih
Mësoni se si të bëni dallimin midis mëkateve dhe dobësive dhe se si t'i ktheni dobësitë në pika të forta.
- 26 Feja e Pastër**
Nga Plaku W. Kristofer Uadell
Lexoni këta tre hapa drejt shërbimit vetëmohues.
- 30 “Çdo Or’ Më Duhesh Ti”**
Nga Xhonatan H. Uestover
Të kënduarit e një himni solli gjithë ndryshimin për këtë familje kërkuesish koreanë.
- 34 Sakrifica Vetëmohuese dhe e Shenjtë e Shpëtimtarit**
Nga Presidenti Bojd K. Paker
Nëpërmjet Shlyerjes së Shpëtimtarit ne mund të paguajmë për llogaritë tona shpirtërore të mëkatit dhe fajit.
- 80 100 Vite të Mbrëmjes Familjare**
Në vitin 1915, Presidenti Jozef F. Smith dhe këshilltarët e tij i ftuan anëtarët që të fillonin të mbanin mbrëmje familjare, duke shpjeguar formatin, synimet dhe bekimet e saj.

RUBRIKAT

- 8 Ne Flasim për Krishtin: Fuqia e Besimit**
Nga Amber Barlou Dal
- 10 Shtëpitë Tona, Familjet Tona: Mbrëmja Familjare – Ti Mund ta Bësh!**
- 12 Klasikët e Ungjillit: Ai Është Ngritur**
Nga Presidenti Dejvid O. Mek-Kei
- 40 Zëra të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme**

NË KOPERTINË

Përpara: *Rruga për në Emaus*, nga Liz Lemon Swindle, nuk lejohet kopjimi. Brenda kapakut të përparmë: Fotografi nga Jim Jeffery. Brenda kapakut të pasëm: Ilustrim me foto nga Cody Bell.



44

44 Shko Përpara me Besim

Nga Plaku Entoni D. Perkins

Mësoni nga Nefi se çfarë të bëni kur përballeni me vendime shumë të rëndësishme.



Shihni nëse mund ta gjeni Liahonën e fshehur në këtë botim. E dhënë: Ku mund të ndizni një qiri?



54

49 Afishe: Kërkojeni Atë**50 Për Shkak të Jozefit**

Nga Ted Barns

Ka të paktën gjashtë mënyra se si jeta juaj është e ndryshme për shkak të Profetit Jozef Smith.

53 Profeti i Gjallë

Nga Presidenti Ezra Taft Benson

Adami? Nefi? Moisiu? Mund të befasoheni kur të mësoni se cili është profeti më i rëndësishëm.

54 Shembulli i Shpëtimtarit për Bindjen

Nëntë mënyra se si Jezu Krishti caktoi shtegun që ne ta ndjekim.

58 Hapësira Jonë**60 Si të Jemi të Urtë**

Nga Plaku Nil L. Andersen


Cili është ndryshimi midis urtësisë së botës dhe urtësisë së Perëndisë?

61 Pikës Shkurt**62 Një Tufë dhe një Bari**

Të kuptuarit e hollësive të detyrës së një bariu mund të na sjellë më pranë Shpëtimtarit.

64 Pyetje e Përgjigje

Si mund të ndihem mjaft i qetë për të folur me peshkopin tim rreth problemeve ose shqetësimeve?



75

66 Cili Është Heroi Juaj?

Nga Sharlot Mej Shepard

Eli kishte frikë t'ia tregonte klasës se cili ishte hero i saj i vërtetë.

68 Lutje dhe Katedrale

Nga Mek-Kelli Xhorxh

Kur Deni vizitoi një katedrale në Angli, ajo mësoi një mësim të rëndësishëm për lutjen.

70 Dëshmitar i Veçantë: Përse të qenit i bindur është kaq i rëndësishëm?

Nga Plaku Rasëll M. Nelson

71 Ide e Shkëlqyer**72 Koha e Shkrimit të Shenjtë: Jezusi Shëron një Lebro**

Nga Erin Sanderson

74 Figura të Shkrimit të Shenjtë: Jezusi Shëron të Sëmurin**75 Shtegu i Drejtë**

Nga Plaku Klaudio D. Zivic

Ndjekja e shtegut të drejtë e sjell gjithë ndryshimin.

76 Për Fëmijët e Vegjël: E Di se Jezusi më Do

Nga Xhejn Mek-Brajd Çoejt

Ide për Mbrëmje Familjare

Ky numër përmban artikuj dhe veprimtari që mund të përdoren për mbrëmje familjare. Sa vijon janë dy ide.



“Çdo Or’ Më Duhesh Ti”, faqe 30:

Pikërisht ashtu si fjalët e himnit “Çdo Or’ Më Duhesh Ti” e ndihmuan Pak Mi-Jungun të vendoste që të pagëzohej, himnet mund të kenë një ndikim të fuqishëm në jetën tonë. Mendoni për një kohë kur fjalët e një himni kanë bekuar jetën tuaj dhe merrni parasysh t’ia tregoni përvojën familjes suaj. Ftojeni çdo pjesëtar të familjes që të zgjedhë një himn të parapëlqyer dhe të tregojë se si ia ka bekuar jetën. Pastaj këndojeni secilin himn me familjen tuaj. (Mund ta vazhdoni këtë për një dy javë.)

“Lutje dhe Katedrale”, faqe 68:

Pasi ta lexoni këtë ndodhi, paraqitni figura ose përmendni kisha të ndryshme në qytetin tuaj dhe flisni rreth këtyre pyetjeve me familjen tuaj: Cilat janë disa ngjashmëri që ne kemi me fetë e tjera? Si ndihet Ati Qjellor për të gjithë fëmijët e Tij? Si duhet t’i trajtojmë njerëzit që kanë besime të ndryshme? Merrni parasysh që të përdorni artikullin “Balancing Truth and Tolerance” [“Baraspeshimi i së Vërtetës dhe Tolerancës”] nga Plaku Dallin H. Ouks, i Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve (*Liahona*, shkurt 2013, f. 28–35) për të ndihmuar për përgjigjen e këtyre pyetjeve.

NË GJUHËN TUAJ

Liahona dhe materiale të tjera të Kishës gjenden në shumë gjuhë të languages.lds.org.

TEMAT NË KËTË BOTIM

Numrat përfaqësojnë faqen e parë të artikullit.

Agjërimi, 30
Besimi, 8, 20, 44
Bindja, 44, 54, 58
Dashuria, 76
Dhiata e Re, 54, 62, 72, 74
Faji, 20, 34
Falja, 20, 34
Familja, 10, 50
Fryma e Shenjtë, 30, 41, 42, 43, 44, 50, 58
Gratë, 14
Guximi, 4
Jezu Krishti, 7, 8, 12, 20, 26, 34, 49, 54, 62, 66, 72, 74, 76

Jozef Smithi, 12, 50
Karakteri hyjnor, 58
Kthimi në besim, 30
Liria e zgjedhjes, 4, 20, 44
Lutja, 68
Mbrëmja familjare, 10, 80
Mëkati, 20, 34
Muzika, 30, 40
Pendimi, 34, 64
Pikëllimi, 30, 41
Pornografia, 34
Priftëria, 50
Profetët, 53
Puna misionare, 30, 40

Puna në tempull, 30, 43
Ringjallja, 12, 49
Rivendosja, 50
Satani, 34, 61
Shembulli, 14, 66
Shërbimi, 26, 42
Shërimi, 8, 72, 74
Shlyerja, 20, 34, 49
Udhëheqësit e Kishës, 53, 64
Urdhërimet, 70, 75
Vdekja, 30, 41
Vendimet, 44, 60, 75



Nga Presidenti
Tomas S. Monson

Presidenti Monson Bën Thirrje për


GUXIM

Presidenti Tomas S. Monson ka vërejtur se rrallë kalon ndonjë orë pa u thirrur për të bërë zgjedhje të një lloji apo një tjetër.

Për të bërë zgjedhje të mençura, këshilloi ai, na duhet kurajë – “kurajë për të thënë jo, kurajë për të thënë po. Vendimet vërtet përcaktojnë fatin.”¹

Në fragmentet vijuese, Presidenti Monson u kujton shenjtorëve të ditëve të mëvonshme se u duhet guxim që të qëndrojnë për të vërtetën dhe drejtësinë, për ta mbrojtur atë që besojnë dhe për t’u përballur me një botë që po i hedh poshtë vlerat dhe parimet e përhershme.

“Thirrja për guxim i vjen vazhdimisht secilit prej nesh”, tha ai. “Përherë ka qenë kështu dhe kështu do të jetë përherë.”²



Guximi Sjell Miratimin e Perëndisë.

“Ne të gjithë do të hasim frikë, do të përjetojmë tallje dhe do të ndeshemi me kundërshtim. Paçim – ne të gjithë – guximin për t’iu kundërvënë mendimit të përgjithshëm, guximin për ta mbrojtur parimin. Guximi, jo kompromisi, e sjell buzëqeshjen e miratimit të Perëndisë. Guximi bëhet një virtut i gjallë dhe tërheqës kur mbahet parasysht jo vetëm si një gatishmëri për të vdekur si burrë, por si vendosmëria për të jetuar denjësisht. Ndërsa ecim përpara, duke u përpjekur që të jetojmë siç duhet, ne sigurisht do të marrim ndihmë nga Zoti dhe mund të gjejmë ngushëllim në fjalët e Tij.”³

Rezistoni me Guxim

“Çfarë do të thotë të durosh? Më pëlqen shumë ky përkufizim: *të rezistosh me kurajë [guxim]*. Kuraja mund të jetë e nevojshme që ju të besoni; nganjëherë do të jetë e nevojshme ndërsa ju bindeni. Me sigurinë më të madhe do të kërkohet ndërsa ju duroni deri në atë ditë kur ta lini këtë ekzistencë në vdekshmëri.”⁴

Kini Guxim për të Qëndruar për të Vërtetën

“[Paçi] kuraj[ën] për të qëndruar të palëkundur për të vërtetën dhe drejtësinë. Meqenëse prirja në shoqëri sot është larg prej vlerave dhe parimeve që Zoti na ka dhënë, ju thujse me siguri do të thirreni për të mbrojtur atë që ju besoni. Po qe se rrënjët e dëshmisë tuaj nuk janë mbjellë me vendosmëri, do të jetë e vështirë për ju të përballoni talljet e atyre që vënë në dyshim besimin tuaj. Kur mbillet me vendosmëri, dëshmia juaj për ungjillin, për Shpëtimtarin dhe për Atin tonë Qiellor do të ndikojë gjithçka bëni gjatë gjithë jetës tuaj.”⁵

Na Duhet Guxim Shpirtëror dhe Moral

“Mesazhet që paraqiten në televizor, në filma dhe në media të tjera [sot] janë shpesh në kundërshtim të drejtpërdrejtë me ato që duam që fëmijët tanë të përqafojnë dhe t’i mbajnë si të çmuara. Është përgjegjësia jonë që jo vetëm që t’i mësojmë të shëndoshen në besim dhe doktrinë, por gjithashtu t’i ndihmojmë ata të qëndrojnë në atë mënyrë, pavarësisht nga forcat e jashtme me të cilat mund të përballen. Kjo do të kërkojë mjaft kohë dhe përpjekje nga ana jonë – dhe në mënyrë që të ndihmojmë të tjerët, neve vetë, na duhet kuraja shpirtërore dhe morale për t’i qëndruar së ligës të cilën e shohim nga të gjitha anët.”⁶

Qofshim Përherë të Guximshëm

“Ndërsa ne jetojmë ditë pas dite, është pothuajse e pashmangshme që besimi ynë do të vihet në provë. Ndonjëherë, ne mund ta gjejmë veten të rrethuar nga njerëz të tjerë dhe prapë se prapë duke qenë pjesë e pakicës ose duke qëndruar të vetëm lidhur me atë që është e pranueshme dhe atë që nuk është. . . .

Qofshim ne gjithmonë të guximshëm dhe të përgatitur që të qëndrojmë për atë që besojmë, dhe nëse do të na duhet të qëndrojmë vetëm në këtë proces, e bëfshim këtë me guxim, të forcuar nga njohuria se në të vërtetë ne nuk jemi kurrë vetëm kur ne qëndrojmë për Atin tonë në Qiell.”⁷ ■

MËSIMDHËNIA NGA KY MESAZH

Mund t’iu kërkoni atyre të cilëve u jepni mësim, që të mendojnë për një situatë javën e ardhshme – në shtëpi, në punë, në shkollë ose në kishë – që do të kërkojë prej tyre të veprojnë me guxim. Ata mund të përballen me një frikë, të durojnë diçka sfiduese, të qëndrojnë për bindjet e tyre ose të vendosin t’i binden një parimi të ungjillit më plotësisht. Ftojini të japin mendimet e tyre ose t’i hedhin në letër.

SHËNIME

1. Tomas S. Monson, “Tre Parimet e Zgjedhjes”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 68.
2. Thomas S. Monson, “The Call for Courage”, *Liahona*, maj 2004, f. 55.
3. Tomas S. Monson, “Ji i Fortë dhe Guximtar”, *Liahona*, maj 2014, f. 69.
4. Tomas S. Monson, “Besoni, Binduni dhe Duroni”, *Liahona*, maj 2012, f. 129.
5. Tomas S. Monson, “Paçi Kurajë”, *Liahona*, maj 2009, f. 126.
6. Tomas S. Monson, “Tre Qëllime për t’Ju Udhëhequr”, *Liahona*, nëntor 2007, f. 118–119.
7. Tomas S. Monson, “Kini Guxim të Qëndroni Vetëm”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 60, 67.

Sara e Dikujt Tjetër

Nga Mek-Kenzi Miller

Ekisha zakon të më dukej e vështirë t'i përdorja bindjet e mia si përgjigje për një pyetje aq të thjeshtë sa "Përse nuk e pi kafënë?" Në të kaluarën sajoja justifikime si "Është shumë e hidhur" ose "Nuk më pëlqen shija".

Përse më vinte zor? Përse kisha aq frikë të qëndroja për atë që besoj? Kur shoh prapa tani, nuk e kuptoj me saktësi se nga çfarë frikësohesha. Por e mbaj mend me saktësi kur pushova së fshehuri pas justifikimeve.

Një ditë në orën e anglishtes në shkollë të mesme, mësuesja lajmëroi se do të shikonim një episod të një emisioni televiziv që e dija se nuk duhet ta shikoja. Ndërkohë që nxënësit e tjerë brohoritën me entuziazëm, shoqja ime e klasës, Sara, ngriti dorën dhe pyeti a mund të largohej.

Kur mësuesja e pyeti përse, Sara u përgjigj troç: "Sepse jam mormone dhe nuk shikoj emisione me blasfemi".

Guximi i saj për t'u ngritur në këmbë përpara klasës ishte mahnitës. Falë Sarës, edhe unë u ngrita dhe prita jashtë me ndërgjegje të pastër që emisioni të mbaronte.

Ndryshova njëherë e mirë. Fillova t'i shpjegoja bindjet e mia në vend që ta shmangia temën. Dhe për pasojë, gjeta siguri te vetja ime dhe mora pjesë edhe më shumë në veprimtaritë e Kishës e të shkollës.

Nuk i thashë kurrë Sarës sa shumë domethënie pati shembulli i saj për mua, por përpiqem ta imitoj shembullin e saj me siguri. Tani e kuptoj se të qenit anëtar i Kishës së mrekullueshme e të shenjtë të Perëndisë nuk ka fare asgjë për të cilën të vijë turp. Shpresoj që të mundem, nëpërmjet shembullit tim, të jem Sara e dikujt tjetër.

Autori jeton në Juta, SHBA.

FËMIJËT

Guximi në Shkrimet e Shenjta

Presidenti Monson na mëson të kemi guxim dhe të qëndrojmë për atë që besojmë. Ka shembuj të shumtë në shkrimet e shenjta të njerëzve që treguan guxim. Lexojeni shkrimin e shenjtë në krah të çdo emri. Si treguan guxim dhe qëndruan për atë që e dinin se ishte e drejtë, këta njerëz? Përdorini hapësirat për të shkruar ose vizatuar një figurë të përgjigjeve tuaja.

Jozef Smithi (Joseph Smith – Historia 1:11–17)

Danieli (Danieli 6:7, 10–23)

Samuel Lamaniti (Helamani 13:2–4; 16:1–7)

Esteri (Esterit 4:5–14; 5:1–8; 7:1–6)

Studiojeni këtë material me lutje dhe kërkoni të dini se çfarë të tregoni. Në ç'mënyrë të kuptuarit e jetës dhe roleve të Shpëtimtarit do ta rritë besimin tuaj tek Ai dhe do t'i bekojë ato për të cilat kujdeseni nëpërmjet vizitës mësimore? Për më tepër informacion, shkoni te reliefsociety.lds.org.

Tipare të Jezu Krishtit: Pa Mashtrim ose Hipokrizi

Kjo është pjesë e një serie të Mesazheve të Vizitave Mësimore që paraqesin tipare të Shpëtimtarit.

Të kuptuarit se Jezu Krishti është pa mashtrim dhe hipokrizi do të na ndihmojë të përpiqemi besnikërisht për të ndjekur shembullin e Tij. Plaku Jozef B. Wirthlin (1917–2008), i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha: “Të mashtrosh është të gënjesh ose të çosh në drejtim të gabuar. . . . Një njeri pa mashtrim është një njeri i pafajshëm, me qëllime të ndershme dhe me motive të pastra, jeta e të cilit pasqyron praktikën e thjeshtë të përputhjes së veprimeve të tij [ose të saj] të përditshme me parimet e integritetit moral. . . . Unë besoj se nevoja e anëtarëve të Kishës për të qenë pa mashtrim mund të jetë më e ngutshme tani se në kohë të tjera, sepse shumë njerëz në botë me sa duket nuk e kuptojnë rëndësinë e këtij virtyti.”¹

Për hipokrizinë, Presidenti Diter F. Uhtdorf, Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë, tha: “Asnjëri prej nesh nuk



është tërësisht si Krishti, siç e dimë se duhet të jemi. Por ne me zell dëshirojmë t'i mposhtim gabimet tona dhe dëshirën për të mëkatuar. Me zemër dhe shpirt ne dëshirojmë fort të bëhemi më të mirë me ndihmën e Shlyerjes së Jezu Krishtit.”²

Ne e dimë se “ne do të gjykojemi sipas veprimeve tona, dëshirave të zemrave tona dhe llojit të njeriut që jemi bërë”³. Sidoqoftë, ndërsa përpiqemi të pendohemi, ne do të bëhemi më të pastër – dhe “lum ata që janë të pastër në zemër, sepse ata do ta shohin Perëndinë” (Mateu 5:8).

Shkrime të Shenjta Shtesë

Psalmeve 32:2; Jakob [Bibël] 3:17;
1 Pjetër 2:1–2, 22

SHËNIME

1. Joseph B. Wirthlin, “Without Guile”, *Ensign*, maj 1988, f. 80, 81.
2. Diter F. Uhtdorf, “Ejani, Bashkohuni me Ne”, *Liahona*, nëntor 2013, f. 23.
3. *Manuali 2: Administrimi i Kishës* (2010), 1.2.1.



Besim, Familje,
Ndhmë

Nga Shkrimet e Shenjta

Fëmijët e vegjël janë pa mashtrim. Jezu Krishti tha: “I lini fëmijët e vegjël të vijnë tek unë dhe mos i pengoni, sepse e tyre është mbretëria e Perëndisë. . . . Dhe, si i mori [fëmijët] në krahë, i bekoji duke vënë duart mbi ta” (Marku 10:14, 16).

Krishti u shërbeu edhe fëmijëve në kontinentet amerikane pas Kryqëzimit të Tij. Ai urdhëroi që njerëzit t'i sillnin fëmijët e tyre të vegjël tek Ai dhe “i ulën përdhe rreth e përqark tij dhe Jezusi qëndroi në mes; . . .

. . . [Dhe] ai qau dhe turma e dëshmoi këtë gjë dhe ai i mori fëmijët e tyre të vegjël, një nga një, dhe i bekoji dhe iu lut Atit për ta. . . .

Dhe si u kthyen të shikonin, ata hodhën sytë drejt qiellit . . . dhe panë engjëj që po zbritnin nga qielli sikur të ishin në mes të një zjarri; dhe ata zbritën dhe rrethuan të vegjlit e tyre, . . . dhe engjëjt u shërbyen atyre” (3 Nefi 17:12, 21, 24).

Merreni Parasysh Këtë

Çfarë mund të mësojmë nga fëmijët e vegjël rreth të qenit pa mashtrim? (Shih Udhëzuesin për Shkrimet e Shenjta, “Mashtrim”.)

FUQIA E BESIMIT

Nga Amber Barlou Dal

Nëse Ati Qiellor do të na çlironte nga sfidat tona thjesht sepse ne ia kërkuam, Ai do të na i mohonte vetë përvojat e nevojshme për shpëtimin tonë.

Një herë kur isha në kolegj, po bëja një provim kur filloi të më dhembte qafa. Dhembja nuk iku kur kishte kaluar tensioni i provimit. Mora mendimin e doktorëve dhe fizioterapistëve dhe provova një larmi trajtimesh, por dhembja vazhdonte prapë. Gjatë vitit vijues, teksa mundohesha ta përballoja këtë dhembje, u mundova edhe që ta shtoja besimin tim. Kalova shumë kohë me lutje, studiova shkrimet e shenjta dhe kërkova bekime nga priftëria. Ndjeva se, nëse do të kisha besim të mjaftueshëm, do të shërohesha.

Jezu Krishti shëroi të sëmurët, të verbrit, të çalët, lebsosët – “sipas besimit [të tyre]” (Mateu 9:29). E dija se Ai kishte fuqinë për të më shëruar mua ashtu siç kishte shëruar kaq shumë të tjerë gjatë jetës së Tij në vdekshmëri. Prandaj, arrita në përfundimin që vetëm mungesa e besimit tim më pengonte nga të qenit e shëruar, kështu që i dyfishova përpjekjet e mia. Ndërkohë që vazhdova fizioterapinë, u luta e agjërova dhe studiova e besova. Prapëseprapë dhembja ime ngulmonte.

Shkrimet e shenjta na mësojnë se me besim ne mund të kryejmë mrekulli (shih Mateu 17:20) e megjithatë unë nuk mund të lehtësohesha nga kjo vuajtje më e vogël. Ku ishte fuqia te besimi im? Më në fund, e pranova qetësisht situatën time, gjeta mënyra

për ta përballuar shqetësimin tim dhe u kënaqa për marrjen e një kuptueshmërie të plotë për besimin dhe shërimin në një kohë të ardhme.

Vite më vonë po flisja me një shoqe që ishte munduar nga të përziera të tmerrshme që e kishin çuar në spital më shumë se një herë gjatë shtatzënisë së saj të parë. Erina dëshironte të kishite një fëmijë tjetër, por ishte e tmerruar se do t'i duhej të duronte të njëjtat shqetësime që hasi në shtatzëninë e saj të parë. Ajo më tregoi se kishte qenë duke agjëruar dhe duke u lutur dhe se ajo besonte njëmend se Ati Qiellor

nuk do ta kërkonte atë prej saj një herë të dytë.

Teksa flisnim, m'u kujtua shkrimi i shenjtë: “Ndaluni dhe pranoni që jam Perëndi” (Psalmëve 46:10). Mendova për përvojën time vetjake kur mësova të ndalem në mes të vuajtjes dhe e nxita Erinën të vazhdonte të kishte besim, por të mos e bënte atë besim të varej nga fakti nëse do të përjetonte ose jo të përziera në shtatzëninë e saj të ardhshme.

Teksa vazhdoja ta studioja parimin e besimit, u drejtova te fjalimi i Almës mbi besimin në të cilin ai jep mësim se “në qoftë se keni besim, ju



NGRITJA MBI SPROVAT

“A nuk ka urtësi [nga Ati Qiellor] te dhënia e sprovave, përgjegjësi që mund të arrijmë, punës që të forcojmë muskujt tanë, pikëllimeve për t'i vënë në provë shpirtrat tanë ndaj nesh që të mund të ngrihemi mbi to? A nuk jemi të ekspozuar ndaj tundimeve që të vihet në provë forca jonë, ndaj sëmundjeve që të mund të mësojmë durimin, ndaj vdekjes që të mund të bëhemi të pavdekshëm e të përlëvdur?”

Nëse të gjithë të sëmurët për të cilët lutemi, të shëroheshin, nëse të gjithë të drejtët do të mbroheshin dhe të ligjtë do të shkatërroheshin, i gjithë plani i Atit do të anulohet dhe parimi bazë i ungjillit, liria e zgjedhjes, do të mbaronte. Asnjë njeriu nuk do t'i duhej të jetonte sipas besimit.”

Presidenti Spencer W. Kimball (1895–1985), *Teachings of Presidents of the Church: Spencer W. Kimball* (2006), f. 15.



shpresoni për gjëra që nuk shihen, të cilat janë të vërteta” (Alma 32:21).

Duke e përsiatur këtë shkrim të shenjtë, zbulova se besimi nuk ishte ai që mendoja se ishte. Besimi, na mëson Alma, është shpresë të parimet e vërteta. Të kesh besim nuk do të thotë që ne besojmë se Ati ynë Qiellor na jep gjithnjë atë që i kërkojmë kur ia kërkojmë. Pasja e besimit se Krishti do të ma shëronte qafën ose që Ai do t'i dhuronte Erinës një shtatzëni pa të përziera është të mos kesh besim te parimet e vërteta. Megjithatë, ne mund të kemi besim se Krishti ka fuqinë për të shëruar, që Ai është i vëmendshëm ndaj nesh, që Ai do të na forcojë dhe që, nëse durojmë mirë, ne mund të kualifikohemi për jetën e përjetshme.

Zoti premtoi: “Çfarëdo gjëje që ti do të kërkosh në besim, duke besuar se do ta marrësh, në emrin e Krishtit, ti do ta marrësh atë” (Enosi 1:15). Unë besoj se fuqia në këtë premtim qëndron te këshilla për të besuar “në emrin e Krishtit”. Shënimi tek Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta mbi lutjen na mëson: “Ne lutemi në emrin e Krishtit kur mendja jonë është mendja e Krishtit dhe dëshirat tona janë dëshirat e Krishtit – kur fjalët e Tij qëndrojnë me ne (Gjoni 15:7). Atëherë ne kërkojmë gjëra që janë të mundshme për Perëndinë për të na i dhënë. Disa lutje mbeten pa përgjigje, sepse ato nuk janë aspak në emrin e Krishtit; ato në asnjë mënyrë nuk përfaqësojnë mendjen e Tij, por burojnë nga zemra egoiste e njeriut.”

Kur ne kërkojmë me besim diçka që

është në pajtim me vullnetin e Perëndisë, Ai do të na e japë sipas dëshirave tona. Ati Qiellor na njeh, na do dhe dëshiron gjithçka që është nevojshme për ne që të kthehemi në praninë e Tij. Dhe ndonjëherë ato përfshijnë sprova, telashe dhe sfida (shih 1 Pjetër 1:7). Nëse Ati Qiellor do të na çlironte nga sfidat tona thjesht sepse ne ia kërkuam, Ai do të na i mohonte vetë përvojat e nevojshme për shpëtimin tonë. Ne duhet të mësojmë të mirëbesojmë te plani i Perëndisë për ne dhe t’ia dorëzojmë vullnetin tonë të Tijit. Teksa i përputhim dëshirat tona me dëshirat e Tij dhe e pranojmë varësinë tonë të plotë nga Ai, ne mund të kualifikohemi për të marrë “përmbushjen e besimit [tonë], shpëtimin e shpirtave [tanë]” (1 Pjetër 1:9). ■

Autorja jeton në Oregon, SHBA.

MBRËMJA FAMILJARE – TI MUND TA BËSH!

Pavarësisht se si është familja juaj, mbrëmja familjare mund t'ju bekojë e t'ju forcojë.

Një baba vjen në shtëpi i lodhur pas një dite të gjatë pune dhe e gjen pjesën tjetër të familjes duke u munduar nga ndjenja të ngjashme idhnake. Është mbrëmja e së hënës dhe mbajtja e një mbrëmjeje familjare duket e pamundur. Pasi bën një lutje për ndihmë, babai dhe nëna vendosin t'i bëjnë gjërat sa më të thjeshta. Ata i bëjnë thirrje familjes të mblidhet, këndojnë një himn dhe luten së bashku. Ata i japin çdo pjesëtar një qiri të vogël për ta ndezur teksa ata tregojnë rreth diçkaje që i frymëzoi kohët e fundit. Në një dhomë të errët, drita e qirinjeve përfaqëson frymëzimin dhe e përqendron vëmendjen e fëmijëve. Teksa jepen dëshmitë, një ndjenjë e ëmbël paqeje dhe dashurie hyn në shtëpi. Familja e përfundon natën mirënjohëse që e mbajti mbrëmjen familjare.

A e dinit se mbrëmja familjare ka qenë program i Kishës për 100 vjet? Në prill 1915, Presidenca e Parë i drejtoi anëtarët që të linin mënjanë një natë çdo javë për lutje familjare, muzikë, nxënie ungjilli, histori dhe veprimtari. (Shih faqen 80 për një fragment nga letra e Presidencës së Parë.) Profetët vazhdojnë të na e kujtojnë rëndësinë e mbrëmjes familjare. “Ne nuk mund t’ia lejojmë vetes ta

shpërfillim këtë program të frymëzuar nga qielli”, tha Presidenti Tomas S. Monson. “Ai mund t’i sjellë rritje shpirtërore çdo pjesëtar të familjes, duke e ndihmuar atë t’iu bëjë ballë tundimeve që janë kudo.”¹

Këtu janë disa qëndrime për t’u mbajtur në mendje teksa e bëni mbrëmjen familjare pjesë të javës suaj:

Kjo gjën zbatim për mua. “Mbrëmjet familjare janë për gjithsecilin”, tha Plaku L. Tom Peri, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve.² Të gjithë ne – të martuar apo beqarë, me ose pa fëmijë – mund t’i kushtojmë kohë forcimit të familjes dhe të mësuarit të ungjillit.

Unë mund ta gjej kohën. Kisha jep shembull duke i lënë mbrëmjet e së hënës të lira nga veprimtaritë e Kishës. Ju mund t’i tregoni Zotit dhe familjes suaj se jeni të gatshëm të lini kohë mënjanë për atë që është me më shumë rëndësi.

Unë mund ta gjej se çfarë hyn në punë për familjen time. Nëse familja juaj është e ndarë gjeografikisht, provoni një “mbrëmje familjare në internet” për të folur me pjesëtarët e familjes në internet ose nëpërmjet telefonit. Dikujt i duhet të punojë deri vonë? Mbani një “mbrëmje familjare në park” pranë vendit të punës gjatë

një pushimi. Një baba i divorcuar mbante një “mbrëmje familjare me letra” çdo të hënë, duke u shkruar fëmijëve të tij që jetonin shumë larg.³ Lërimi pengesat të jenë një katalizator për krijueshmëri më të madhe.

Unë mund ta filloj këtë javë.

Mbrëmja familjare mund të organizohet sipas nevojave dhe rrethanave të shtëpisë suaj. Këtu janë disa sugjerime të përgjithshme:

- Fillojeni dhe përfundojeni me lutje.
- Përdorni muzikë, përfshirë himne dhe këngë të Fillores.
- Mësoni nga shkrimet e shenjta dhe fjalët e profetëve bashkëkohorë.
- Përfshini një larmi veprimtarish fizike, projektesh shërbimi dhe veprimtari të përqendruara tek ungjilli nga java në javë.
- Argëtohuni! Luani një lojë ose bëni gostitje.
- Jini të qëndrueshëm. Nëse nuk mund ta bëni të hënën, gjeni një ditë tjetër që funksionon.

Unë i dua bekimet. Profetët kanë premtuar se, nëse marrim pjesë në një mbrëmje familjare, bekime të mëdha do të rrjedhin: Dashuria dhe bindja në



shtëpi do të shtohen. Besimi do të zhvillohet në zemrat e fëmijëve. Familjet “do të fitojnë fuqi për t’i luftuar ndikimet e këqija dhe tundimet” që i rrethojnë.⁴

Ndërkohë që mbrëmjet tuaja familjare mund të mos jenë përvoja të përsosura çdo herë, familja juaj do të forcohet dhe bekohet nga përpjekjet tuaja. “Secila mbrëmje familjare në shtëpi është një gjurmë peneli në telajon e shpirtit tonë”, dha mësim Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. “As edhe një ndodhi nuk duket të jetë shumë mbresëlënëse apo e paharrueshme. Por

ashtu si gjurmët e . . . bojës, plotësojnë njëra-tjetrën dhe japin një kryevepër mbresëlënëse, po ashtu konsekuencë jonë në kryerjen e gjërave në dukje të vogla mund të çojë në rezultate shpirtërore të rëndësishme.”⁵ ■

SHËNIME

1. Thomas S. Monson, “Constant Truths for Changing Times”, *Liahona*, maj 2005, f. 19.
2. L. Tom Perry, “Therefore I Was Taught”, *Ensign*, maj 1994, f. 38.
3. “Family Home Evening: Any Size, Any Situation”, *Ensign*, dhjetor 2001, f. 42.
4. First Presidency, në James R. Clark, përpil., *Messages of the First Presidency of The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints*, 6 vëll. (1965–1975), 4:339.
5. Dejvid A. Bednar, “Më të Zellshëm dhe më të Përfshirë në Shtëpi”, *Liahona*, nëntor 2009, f. 20.

JEPINI PËRPARËSINË MË TË LARTË

“Ne i këshillojmë prindërit dhe fëmijët t’i japin përparësinë më të lartë lutjes familjare, mbrëmjes familjare, studimit e udhëzimit të ungjillit dhe aktiviteteve të dobishme familjare. . . . Sado të denja dhe të përshtatshme qofshin kërkesat ose aktivitetet e tjera, ato nuk duhet të lejohen të zëvendësojnë detyrat e caktuara në mënyrë hyjnore që vetëm prindërit dhe familjet mund t’i kryejnë ashtu si duhet.”

Letër e Presidencës së Parë, 11 shkurt 1999.

AI ËSHTË NGRITUR

Një besim i palëkundur në Krisht është nevoja më e rëndësishme e botës sot.



**Nga Presidenti
Dejvid O. Mek-Kei
(1873–1970),**

Presidenti i Nëntë
i Kishës

*Dejvid O. Mek-Kei u lind
më 8 shtator 1873. Ai u
shugurua Apostull më*

*9 prill 1906, në moshën 32-vjeçare dhe më
9 prill 1951, ai u mbështet si Presidenti i
nëntë i Kishës. Sa vijon është shkëputur nga
një fjalim që ai dha në konferencën e përgjithshme të prillit 1966. Për fjalimin e plotë,
shih Conference Report, prill 1966, f. 55–59.*

Nëse një mrekulli është një ngjarje e mbinatyrshme forcat shkaktuese të së cilës janë përtej urtësisë së fundme të njeriut, atëherë Ringjallja e Jezu Krishtit është mrekullia më e jashtëzakonshme e të gjitha kohëve. Te vetë ajo zbulohet plotfuqia e Perëndisë dhe pavdekshmëria e njeriut.

Ringjallja, sidoqoftë, është një mrekulli vetëm në kuptimin që është përtej të kuptuarit dhe aftësisë rrokëse të njeriut. Për të gjithë ata që e pranojnë atë si fakt, ajo nuk është gjë tjetër

veçse një shpalosje e një ligji të një-trajtshëm të jetës. . . .

Quajeni fakt që Krishti e mori përsëri trupin e tij dhe u shfaq si një genie e përlëvdur dhe e ringjallur dhe do t'i jepni përgjigje pyetjes së epokave: “Në qoftë se njeriu vdes, a mund të kthehet përsëri në jetë?” (Jobit 14:14).

Dëshmitarët e Ringjalljes

Që ringjallja e mirëfilltë e Krishtit nga varri ishte një realitet për dishepujt që e njihnin Krishtin, kjo është gjë krejt e sigurt. Në mendjen e tyre, nuk kishte absolutisht asnjë dyshim. Ata ishin dëshmitarë të faktit; e dinin pasi sytë e tyre e kishin parë, veshët e tyre e kishin dëgjuar, duart e tyre e kishin ndier praninë fizike të Shëlbuesit të ringjallur.

Pjetri, Kryeapostulli, në një rast kur të njëmbëdhjetët ishin takuar për të zgjedhur dikë që të zinte vendin e Juda Iskariotit, tha: “Duhet, pra, që ndër burrat . . . një prej tyre të bëhet dëshmitar me ne, i ringjalljes së tij” (Veprat e Apostujve 1:21–22). . . .

Në një rast tjetër Pjetri shpalli përpara armiqve të tyre, po ata burra që e kishin dënuar me vdekje në kryq Jezusin: “Burra të Izraelit, dëgjoni këto fjalë; . . . Këtë Jezus, Perëndia e

ka ringjallur; dhe për këtë të gjithë ne jemi dëshmitarë!”

(Veprat e Apostujve
2:22, 32). . . .

Dëshmitarët e Tjerë

Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme qëndron me Pjetrin, me Palin, me Jakobin dhe me të gjithë Apostujt e tjerë të hershëm që e pranuan Ringjalljen jo vetëm që ishte me plot kuptimin e fjalës e vërtetë, por edhe si përmbushjen e misionit hyjnor të Krishtit në tokë.

Një mijë e tetëqind vjet pasi Jezusi vdiq në kryq, Profeti Jozef Smith shpalli se Zoti i ringjallur iu shfaq atij, duke thënë: “Unë pashë dy Personazhe, shkëlqimi dhe lavdia e të cilëve i kapërcejnë të gjitha përshkrimet, duke qëndruar mbi mua në ajër. Një prej tyre më foli, duke më thirrur në emër dhe tha, duke treguar tjetrin – *Ky është Biri Im i Dashur. Dëgjoje Atë!*” (Joseph Smith–Historia 1:17). . . .

Nëse dëshmia e Jozef Smithit qëndroi e vetme, do të ishte, ashtu si tha Krishti për dëshminë e Tij kur foli për Vetën, pa asnjë dobi; por Jezusi kishte dëshminë e Perëndisë dhe atë të Apostujve. Dhe Jozef Smithi kishte dëshmitarë të tjerë [që] e vërtetuan dëshminë e [tij], e vërteta e së cilës u ishte bërë e njohur nga shfaqja e engjëllit Moroni para tyre. . . .

. . . Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme e pohon [gjithashtu] vegimin e lavdishëm të Profetit Jozef Smith:

“Dhe tani, pas shumë dëshmive që janë dhënë për të, kjo është dëshmia, e fundit e të gjithave, që ne japim për

KRISHTI I GJALLË

Lexojeni dëshminë për Jezu Krishtin të dhënë nga apostujt dhe profetët bashkëkohorë të *Liahona*, prill 2000, f. 2–3.



i vërtetë nuk kënaqet duke e pranuar Atë thjesht si një reformator të madh, si mësuesin ideal ose madje si njeriun e vetëm të përkryer. Burri i Galileesë është – jo figurativisht, por *me plot kuptimin e fjalës* – Biri i Perëndisë së gjallë. . . .

Vërtet i Lindur Përsëri

Asnjë njeri nuk mund t’ia dalë sinqerisht t’i zbatojë në jetën e tij të përditshme mësimet e Jezusit të Nazaretit pa ndier një ndryshim në të gjithë qenien e tij. Fraza “i lindur përsëri” ka një domethënie më të thellë nga ajo që njerëzit zakonisht i veshin asaj. . . . I lumtur është njeriu që e ka ndier vërtet fuqinë lartësuese e shndërruese që vjen nga kjo afërsi me Shpëtimtarin, kjo lidhje e ngushtë me Krishtin e gjallë. Jam mirënjohës që e di se Krishti është Shëlbuesi im. . . .

Mesazhi i Ringjalljes . . . është më ngushëlluesi, më i lavdishmi që i është dhënë ndonjëherë njeriut, sepse kur vdekja na e merr një njeri të dashur, zemrat tona të pikëlluara lehtësohen nga shpresa dhe sigurimi hyjnor i shprehur me fjalët: “*Ai nuk është këtu, sepse u ringjall!*” [shih Mateu 28:6; Marku 16:6].

Unë e di me gjithë shpirt se vdekja mposhtet nga Jezu Krishti dhe për shkak se Shëlbuesi ynë jeton, edhe ne do të jetojmë. ■

Nëntituji janë ndryshuar; shkrimi me germë të madhe dhe pikësimi janë standardizuar.

të: Se ai jeton!” (DeB 76:22). . . .

Në dritën e dëshmimeve të tilla të panjolla siç u dhanë nga Apostujt e lashtë – dëshmi që datojnë pak vite pas vetë ngjarjes – në dritën e asaj zbulesë jashtëzakonisht të mrekullueshme në këtë epokë të Krishtit të gjallë, duket njëmend e vështirë të kuptohet se si njerëzit mundën ende ta hedhin poshtë Atë dhe ta vënë në dyshim pavdekshmërinë e njeriut.

Ajo që na Nevojitet Sot

Një besim i palëkundur në Krisht është nevoja më e rëndësishme e

botës sot. Ajo është më shumë sesa thjesht një ndjenjë. Ajo është fuqia që të çon në veprim dhe duhet të jetë në jetën njerëzore më thelbësorja nga të gjitha forcat shtytëse. . . .

Nëse njerëzit thjesht “do të bënin vullnetin e Tij”, në vend që të shihnin të pashpresë varrin e errët e të zymtë, ata do t’i kthenin sytë nga qielli dhe do ta dinë se Krishti është ringjallur! . . .

Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme i shpall të gjithë botës se Krishti është Biri i Perëndisë, Shëlbuesi i botës! Asnjë ndjekës

NDIKIMI SHPIRTËROR I

“Ne do t’i thërrasim gratë e Kishës që të qëndrojnë të bashkuara për drejtësinë. . . . Unë e shoh këtë si të vetmin burim shprese të shëndritshme në . . . botë.” – Presidenti Gordon B. Hinkli (1910–2008)



GRAVE

A e rrokim fuqinë e forcës tonë shpirtërore?

Nga Starla Oerkemp Batler

Shumë gra të mrekullueshme, të përlura në Kishë japin shërbim të përkushtuar pa e kuptuar ndikimin gjithëpërfshirës që ka jeta e tyre – si shembuj të shërbimit tokësor, por edhe si trashëgimi të forcës shpirtërore. Një grua e tillë është gjyshja ime, Sheri Pitersen. Ajo ka shërbyer me besnikëri në thirrje të heshtura gjithë jetën e saj. Nëse do ta pyesnit, ajo do të pohonte se nuk ka shumë talente për t'i dhënë botës. Mirëpo, ndërsa kam filluar të mësoj për jetën e saj, unë kam kuptuar pikërisht se sa shumë forca e saj shpirtërore ka ndikuar në jetën time.

Prindërit e Sherit reshtën së frekuentuari kishën dhe u ndanë kur ajo ishte ende shumë e re, kështu që ajo u rrit me të ëmën, Florencën, e cila ishte përherë në punë. Florenca [vetë] ishte lënë edhe më shumë pas dore kur ishte fëmijë, meqë qe rritur në një shkollë me konvikt ndërsa e ëma, Xhorxhia, bëri një jetë të kësaj bote. Pavarësisht nga vështirësitë gjatë rritjes së vet, Sheri qëndroi aktive në ungjill, duke e frekuentuar kishën me familjen e stërgjyshes së saj, Elizabetës, ose me miq. Ajo pa në familjet e tyre atë që ajo dëshironte të kishte në familjen e saj. Ajo nuk e dinte saktësisht se si duhej të ishte një familje, por ajo e dinte atë çfarë nuk duhet të ishte dhe ajo qe e vendosur të bënte që familja e saj e ardhshme të ishte ndryshe.

Bashkëshorti i Sherit – gjyshi im, Delli – njëherë më tha: “Që të kesh një dëshmi duhet ta dëshirosh atë. Sheri gjithmonë dëshironte një dëshmi.” Ndonëse vitet e tyre të para të martesës ishin të ngarkuara me mundime, ata ishin të vendosur të qëndronin të fortë si familje. Ata ishin më pak aktivë gjatë vitit të parë të martesës së tyre për shkak të orarit të punës së Dellit, por një thirrje për të shërbyer në Filllore e nxiti Sherin që të fillonte të merrte pjesë dhe Delli shpejt iu bashkua asaj në kishë si këshillues i kuorunit të dhjakëve. Që nga ajo kohë, ata kanë qenë të dy aktivë dhe të fortë

BIVA TË HYANISË, KATHLEEN PETERSON, NUK LEJOHET KOPIMI



në Kishë. Gatishmëria e Sherit për të shërbyer dhe vendosmëria e saj për të rritur një familje të fortë e ndihmoi mamam në time të bëhej ajo gruaja e fortë siç [dhe] është; dhe shembulli i nënës sime ka ndihmuar duke ndikuar në jetën time, veçanërisht ndërsa unë tani nis vetë familjen time.

Si gra ne mund të kemi një ndikim të thellë shpirtëror në jetën e njerëzve përreth nesh. Me të vërtetë, Jozef Smithi dha mësim se roli ynë “nuk është vetëm për të ndihmuar të varfrit, por për të shpëtuar shpirtra”¹. Jezu Krishti i ka thirrur gratë e Kishës së Tij që të jenë dishepullet e Tij dhe që të jenë të forta shpirtërisht. Forca dhe ndikimi ynë shpirtëror janë jetësorë në përparimin e punës për shpëtim dhe ne duhet të kërkojmë mundësi për t’i forcuar shpirtërisht njerëzit përreth nesh. Kur e bëjmë këtë, ndikimi i besimit dhe i drejtësisë sonë do të vazhdojë mjaft përtej asaj që ne mund të kuptojmë.

Të Thirrura për të Qenë Dishepulle

Plaku Xhejms E. Talmixh (1862–1933), i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, shkroi: “Mbështetësi më i madh botëror i grave dhe i të qenit grua është Jezusi, Krishti”². Mendoni, për shembull, për atë që Ai u mësoi dy prej dishepulleve të Tij femra në Dhiatën e Re, dy motrave Maria dhe Marta. Libri *Daughters in My Kingdom [Bija në Mbretërinë Time]* shpjegon: “Lluka 10 përmban një rrëfim të Martës tek e hap shtëpinë e saj për Jezusin. Ajo i shërbeu Zotit duke u kujdesur për nevojat e Tij fizike dhe Maria u ul te këmbët e Mësuesit dhe përvetësonte mësimet e Tij.

Në një epokë kur nga gratë pritej përgjithësisht të jepnin vetëm shërbim tokësor, Shpëtimtari i mësoi Martës dhe Maries se edhe gratë mund të merrnin pjesë shpirtërisht në punën e Tij. Ai i ftoi ato të bëheshin dishepullet e Tij dhe të merrnin nga shpëtimi ‘pjesën më të mirë’ që nuk do t’u hiqej kurrë atyre.”³

Ashtu si Marta, ndonjëherë ne biem në gabimin e të menduarit se roli kryesor i grave është që të japin shërbim

tokësor, të tillë si të sigurojnë vakte, të qepin dhe të pas-trojnë për të tjerët. Ky shërbim është një sakrificë e çmuar




Katër breza: Elizabeta (në të majtë) duke mbajtur mbesën e saj, Florencën. Eni (në qendër) erdhi në Jutë me prindërit e saj dhe është nëna e Elizabetës. Xhorxhia (në të djathtë) është e bija e Elizabetës, por Xhorxhia dhe e bija e saj Florenca u larguan nga Kisha. Ishte Elizabeta besnike që e ndihmoi stërmbesën e saj, Sherin dhe pasardhësit e Sherit që të ktheheshin në ungjill.

dhe e shtrenjtë; sidoqoftë, më tepër sesa ka nevojë për motra që mund të qepin e të gatujnë, Zoti ka nevojë për gra me fuqi shpirtërore, besimi, drejtësia dhe mirëdashja e të cilave ndriçon dukshëm në jetën e tyre. Ai e di se secila prej nesh ka kaq shumë për të dhënë. Jezu Krishti na thërret *të gjithave* ne që të kalitim forcën dhe aftësinë tonë shpirtërore për të marrë zbulësë e për të vepruar në përputhje me të që të ndihmojmë për çuarjen përpara të veprës së Tij. Linda K. Barton, presidente e përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës, u tha motrave: “Ju jeni dërguar në tokë në këtë periudhë ungujllore për shkak të njeriut që jeni dhe për atë që jeni përgatitur të bëni! Pavarësisht nga

ajo që Satani do të përpiqet të na bëjë të mendojmë rreth asaj se cilat jemi, identiteti ynë i vërtetë është ai i një dishepulle të Jezu Krishtit!”⁴

Zoti na njeh ne dhe rrethanat tona dhe Ai ka një punë për secilën prej nesh që ta bëjmë në këtë tokë. Asnjë motër nuk di tepër pak ose ka tepër pak talente për të qenë një forcë shpirtërore për mirë dhe për t’i sjellë të tjerët te Krishti. Me këtë potencial hyjnor ne kemi përgjegjësi-në për t’u bërë udhëheqëse shpirtërore në shtëpitë dhe komunitetet tona. Plaku M. Rasëll Ballard, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, shpalli: “Çdo motër në këtë Kishë, që ka bërë besëlidhje me Zotin, ka një urdhërim hyjnor që të ndihmojë për të shpëtuar shpirtra, që të udhëheqë gratë e botës, që të forcojë shtëpitë e Sionit dhe që të ndërtojë mbretërinë e Perëndisë”⁵.

Ne nuk duhet të jemi në pozicione të larta ose të bëjmë gjëra të jashtëzakonshme për t’i ndihmuar njerëzit përreth nesh që të bëjnë zgjedhje që do t’i çojnë ata më pranë Jezu Krishtit – gjë që është detyra jonë më e rëndësishme. Si gjërat më të mëdha edhe ato më të voglat që bëjmë në jetën e një apo dy njerëzve, edhe thjesht brenda vetë familjes sonë, mund të kenë një efekt të thellë.



Gra në Punën e Shpëtimit

Një himn i shtrenjtë pohon: “Dhe puna e engjëjve u jepet grave; Kjo është dhurata që ne motrat kemi”⁶. Ne kemi shumë për të dhënë në jetën e atyre që duam. Plaku Riçard G. Skot, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, ka treguar histori për mënyrën se si forca shpirtërore e dy grave ndikoi në jetën e tij:

“Kur isha fëmijë i vogël, babai im nuk ishte anëtar i Kishës dhe mamaja ime ishte bërë më pak aktive. . . . Disa muaj pas ditëlindjes sime të tetë, Gjyshe Uitëlli udhëtoi përmes të gjithë vendit për të na vizituar. Gjyshja ishte e shqetësuar se as unë, as vëllai im më i madh, nuk ishim pagëzuar. Nuk e di se çfarë u tha ajo prindërve të mi për këtë, por e di vërtet se një mëngjes ajo na çoi në një park vëllanë tim dhe mua dhe na tregoi

*“Shpëtimtari i mësoi
Martës dhe Maries
se gratë mund të
merrnin pjesë shpirtërisht
në punën e Tij. Ai i ftoi ato të
bëheshin dishepullet
e Tij dhe të merrnin
nga shpëtimi.”*

ndjenjat e saj mbi rëndësinë e të qenit të pagëzuar dhe të pjesëmarrjes rregullisht në mbledhjet e Kishës. Nuk i mbaj mend hollësitë e asaj që tha ajo, por fjalët e saj prekën diçka në zemrën time dhe shpejt vëllai im dhe unë u pagëzuam. . . .

Gjyshja përdori pikërisht sasinë e duhur të guximit dhe respektit për ta ndihmuar babanë tonë të kuptonte sa e rëndësishme ishte të na çonte në kishë me makinë për mbledhjet tona. Në çdo mënyrë të përshtatshme, ajo na ndihmoi të ndienim një nevojë për ungjillin në jetën tonë.”⁷

Një tjetër burim force shpirtërore ishte gruaja e Plakut Skot, Xhenina. Kur po dilnin në takime, ata filluan të bisedonin rreth të ardhmes. Xhenina, e cila ishte rritur në një shtëpi të fortë misionare, shprehu dëshirën e saj për t'u martuar



FOSHME, NGA KATHLEEN PETERSON, NUK LEJOHET KOPIMI

në tempull me një misionar të kthyer. Plaku Skot, i cili më përpara nuk kishte menduar seriozisht për të shërbyer në një mision, u ndikua fuqimisht. “Shkova në shtëpi dhe nuk mund të mendoja për asgjë tjetër. Ndenja zgjuar gjithë natën. . . . Pas shumë lutjesh, mora vendimin të takohesha me peshkopin tim dhe të filloja aplikimin tim për misionar.”⁸ Ndonëse Xhenina i dha atij udhërrëfimin dhe nxitjen për të cilën kishte nevojë, Plaku Skot tha: “Xhenina nuk më kërkoi asnjëherë që të shërbeja një mision *për të*. Ajo më donte mjaftueshëm sa të më tregonte bindjen e saj dhe pastaj më dha mundësinë të zgjidhja drejtimin e vetë jetës sime. Ne të dy shërbyem në misione dhe më vonë u vulosëm në tempull. Guximi dhe zotimi i Xheninës ndaj besimit të saj kanë sjellë gjithë ndryshimin në jetën tonë së bashku. Jam i sigurt se nuk do ta kishim gjetur lumturinë që gëzojmë, pa besimin e saj

Një himn i shtrenjtë pohon: “Dhe puna e engjëjve u jepet grave; Kjo është dhurata që ne motrat kemi”. Ne kemi shumë për të ofruar në jetën e atyre që i duam.

të fortë në parimin e shërbimit ndaj Zotit së pari. Ajo është një shembull i mrekullueshëm, i drejtë!”⁹

Ishte ndikimi shpirtëror i këtyre grave në jetën e tij që ndihmoi vetëm një të ri – Plakun Skot – të merrte disa nga vendimet më të rëndësishme në jetën e tij: të pagëzohet, të shërbente në një mision dhe të martohet në tempull.

Ne mund t’i ndihmojmë të tjerët të kenë dëshirë për të bërë zgjedhje të mira nëpërmjet shembullit, veprimeve, fjalëve dhe drejtësisë sonë vetjake. Motra Karol M. Stivens, këshilltare e parë në presidencën e përgjithshme të Shoqatës së Ndhmës, shpall: “Ne jemi bija të besëlidhjes në mbretërinë e Zotit, dhe ne kemi mundësinë të jemi mjete në duart e Tij. . . . [Ne] marrim pjesë në punën e shpëtimit çdo ditë në mënyra të vogla e të thjeshta – duke u kujdesur, duke e forcuar

dhe mësuar njëra-tjetrën.”¹⁰ Kur mbështetemi te Shpirti dhe shkojmë përpara me përpjekje të sinqerta e të përu-lura për t’i ndihmuar njerëzit përreth nesh që t’i afrohen më shumë Krishtit, ne do të udhëhiqemi në atë që mund të bëjmë e do të na jepet forcë për ta bërë atë dhe ne do të ndiejmë gëzimin e sjelljes së fëmijëve të Zotit tek Ai.

Të Bëhemi një Ndikim Shpirtëror

Duke e ditur përgjegjësinë tonë, ne, ashtu si dishepujt e lashtë, mund të pyesim: “Ç’duhet të bëjmë” (Veprat e Apos-tujve 2:37) që të jemi një ndikim shpirtëror? Në një konfe-rencë të përgjithshme të kohëve të fundit, Motra Barton i ftoi motrat të përfytyronin “disa nga afishet e mundshme shpirtërore që shënojnë ‘kërkohet ndihmë’, të lidhura me punën për shpëtim:

- Kërkohet ndihmë: prindër që t’i rritin fëmijët e tyre në dritë e të vërtetë
- Kërkohet ndihmë: bija . . . , motra . . . , emta . . . , kushërira, . . . gjyshe dhe mi[kesha] të vërtet[ë] për të shërbyer si këshillues[ë] dhe për të dhënë një dorë ndihme nëpër shtegun e besëlidhjes
- Kërkohet ndihmë: ata që i dëgjojnë nxitjet e Frymës së Shenjtë dhe veprojnë sipas përshtypjeve që marrin
- Kërkohet ndihmë: ata që e jetojnë ungjillin përditë në mënyra të vogla e të thjeshta
- Kërkohet ndihmë: punonjës të historisë familjare dhe punonjës tempulli për t’i lidhur familjet në përjetësi
- Kërkohet ndihmë: misionarë dhe anëtarë për të përhapur ‘lajmin e mirë’ – ungjillin e Jezu Krishtit
- Kërkohet ndihmë: shpëtues për të gjetur ata që e kanë humbur udhën e tyre
- Kërkohet ndihmë: mbajtës të besëlidhjeve që të qënd-rojnë të palëkundur për të vërtetën dhe drejtësinë
- Kërkohet ndihmë: dishepujt të vërtetë të Zotit Jezu Krisht.”¹¹

Këto nuk janë gjëra të reja por, kur ne kërkojmë mundë-si për të marrë pjesë në punën për shpëtim, ne do ta për-mirësojmë aftësinë tonë për t’i ndihmuar njerëzit përreth nesh. Plaku Ballard tha: “Nuk ka gjë në këtë botë aq vet-jake, aq edukuese, apo aq jetëndryshuese sa ndikimi i një gruaje të drejtë”¹². Ndërsa e kalitim fuqinë tonë shpirtërore nëpërmjet lutjes dhe studimit vetjak të shkrimeve të shenja, bindjes së paepur dhe mbajtjes me besnikëri të besëlidhje-ve tona, ne do të arrijmë të jemi ai ndikim.

Përtej Asaj që Mund të Kuptojmë

Presidenti Brigam Jang (1801–1877) tha: “A mund ta merrni me mend totalin e të mirave që nënat dhe bijat në Izrael janë në gjendje të bëjnë? Jo, është e pamundur. Dhe të mirat që ato do të bëjnë, do t’i shoqërojnë ato në gjithë përjetësinë.”¹³

Vendimet e drejta të gjyshe sime kanë ndikuar në brezat e familjes së saj përtej asaj që ajo mund të kup-tonte kur ishte e re. Mirëpo, ndikimi shpirtëror i grave në familjen time shtrihet edhe më tej në të shkuarën. Sheri mori një sasi të madhe force vetjake shpirtërore nga të vëzhguarit e stërgjyshe së saj (stër-katragjyshe sime), Elizabetës. Shembulli i besimit dhe i dëshmisë së Elizabetës pati ndikim përtej dy brezash të ardh-shëm joaktivë në Kishë duke ndihmuar stërmbesën e saj, Sherin, të ndryshonte një prirje për familje të ndara dhe të kthehej në Kishë.

Ndërsa bëhemi një forcë shpirtërore për njerëzit përreth nesh, ndikimi ynë do të shtrihet përtej asaj që mund të kuptojmë. Presidenti Gordon B. Hinkli (1910–2008) tha: “Ne do t’i thërrasim gratë e Kishës që të qëndrojnë të bashkuara për drejtësinë. Ato duhet të fillojnë [me të] në vetë shtëpitë e tyre. Ato mund ta japin mësim atë në klasat e tyre. Ato mund të bëhen zëri i saj në klasat e tyre. . . .

Unë e shoh këtë si të vetmin burim shprese të shndrit-shme në një botë që po marshon drejt vetëshkatërrimit.”¹⁴

Kur e plotësojmë këtë urdhër, punës së Zotit do t’i jepet shtysë përpara si në botën përreth nesh dhe, më e rëndë-sishmja, në familjet tona dhe në jetën e njerëzve që duam. ■

Autorja jeton në Jutë, SHBA.

SHËNIME

1. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2007), f. 483.
2. James E. Talmage, *Jesus the Christ*, bot. i 3-të (1916), f. 475.
3. *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society* (2011), f. 3–4.
4. Linda K. Barton, “Kërkohen: Duar dhe Zemra për Përsheptimin e Punës”, *Liahona*, maj 2014, f. 123.
5. M. Russell Ballard, “Women of Righteousness”, *Ensign*, prill 2002, f. 70.
6. “As Sisters in Zion”, *Hymns*, nr. 309.
7. Riçard G. Skot, “Ju Kam Dhënë Shembullin”, *Liahona*, maj 2014, f. 32.
8. Riçard G. Skot, “Ju Kam Dhënë Shembullin”, f. 33.
9. Riçard G. Skot, “Ju Kam Dhënë Shembullin”, f. 33.
10. Karol M. Stivens, “Kemi Arsye të Madhe për t’u Gëzuar”, *Liahona*, nëntor 2013, f. 117.
11. Linda K. Barton, “Kërkohen: Duar dhe Zemra për Përsheptimin e Punës”, f. 124.
12. M. Rasëll Ballard, “Nëna dhe Bija”, *Liahona*, maj 2010, f. 18.
13. *Discourses of Brigham Young*, përzgji. John A. Widtsoe (1954), f. 216.
14. Gordon B. Hinckley, “Standing Strong and Immovable”, *Worldwide Leadership Training Meeting*, 10 janar 2004, f. 20.

Nuk Është MËKAT TË JESH I DOBËT

Nga Uendi Ulrih

“**A** jam vërtet i denjë të hyj në shtëpinë e Perëndisë? Si mund të jem nëse nuk jam i përsosur?”

“A mundet Perëndia vërtet ta kthejë dobësinë time në forcë? Unë kam agjëruar dhe jam lutur për ditë me radhë që ky problem të largohet prej meje, por asgjë nuk duket se po ndryshon.”

“Në fushën e misionit, unë e jetoja ungjillin në mënyrë më të qëndrueshme sesa në çdo periudhë në jetën time, por nuk kam qenë kurrë më i vetëdijshëm për të metat e mia. Përse atëherë, kur po sillesha aq mirë, ndonjëherë ndihesha aq keq?”

Ndërsa përsiatim pyetje të tilla, është thelbësore të kuptojmë se, ndërkohë që *mëkati* në mënyrë të pashmangshme na largon nga Perëndia, *dobësia*, ndryshe nga ç’pritet, mund të na çojë drejt Tij.

Dallimi ndërmjet Mëkatit dhe Dobësisë

Përgjithësisht, ne e mendojmë mëkatin dhe dobësinë thjesht si njolla të zeza të madhësive të ndryshme në cohën e shpirtit tonë, shkallë të ndryshme të rënda shkeljeje. Por shkrimet e shenjta bëjnë të ditur se mëkati dhe dobësia janë qenësisht të ndryshme, kërkojnë mjete të ndryshme ndreqjeje dhe kanë potencialin që të sjellin pasoja të ndryshme.

Shumica prej nesh e kuptojnë më mirë mëkatin sesa e vrasim mendjen

ta pranojmë, por le ta rishqyrtojmë: Mëkati është një zgjedhje për të mos iu bindur urdhërimeve të Perëndisë ose për të ngritur krye kundër Dritës së Krishtit brenda nesh. Mëkati është një zgjedhje për t’i mirëbesuar Satanit në vend të Perëndisë, duke na vënë në armiqësi me Atin tonë. Ndryshe nga ne, Jezu Krishti qe tërësisht

*Kufizimet dhe mangësitë
nuk janë mëkate dhe nuk na
pengojnë që të jemi të pastër e të
denjë për Shpirtin.*





Ndërkohë që mëkati në mënyrë të pashmangshme na largon nga Perëndia, dobësia, ndryshe nga ç'pritet, mund të na çojë drejt Tij.



pa mëkate dhe mund të shlyente për mëkatet tona. Kur pendohemi sinqerisht – duke përfshirë ndryshimin e mendjes, zemrës e sjelljes sonë; ofrimin e kërkesës për falje ose rrëfimeve me vend; bërjen e dëmshtëpërblimeve ku është e mundur; dhe mos përsëritjen e atij mëkati në të ardhmen – ne kemi të drejtë për Shlyerjen e Jezu Krishtit, mund të falemi nga Perëndia dhe të jemi përsëri të pastër.

Të bërit të pastër është thelbësor pasi asgjë e papastër nuk mund të jetojë në praninë e Perëndisë. Por nëse synimi ynë i vetëm është që të jemi po aq të pafaj sa ishim kur u larguam nga prania e Perëndisë, atëherë do të qe më mirë që të gjithë të rrinim shtrirë sa gjatë e gjerë në djepat tanë për tërë jetën tonë. Përkundrazi, ne erdhëm në tokë për të mësuar nëpërmjet përvojës që të dallojmë të mirën nga e liga, për t'u rritur në urtësi e aftësi, për t'i jetuar vlerat që çmojmë, dhe për të fituar karakteristika të perëndishmërisë – përparim të cilin nuk mund ta arrijmë brenda caqeve të sigurt të një djepi.



PREMTIMI I SHLYERJES

“Rikthimi i asaj që ju nuk mund ta riktheni, shërimi i plagës që

nuk mund ta shëroni, rregullimi i asaj që thyet dhe nuk mund ta rregulloni, është pikërisht qëllimi i Shlyerjes së Krishtit. . . .

E përsëris, me përjashtim të atyre pak njerëzve që i bashkohen humbjes së përrjetshme, nuk ka asnjë zakon, asnjë varësi, asnjë rebelim, asnjë shkelje, asnjë braktisje, asnjë krim që bën përjashtim nga premtimi i faljes së plotë. Ky është premtimi i Shlyerjes së Krishtit.”

Presidenti Boyd K. Paker, President i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “The Brilliant Morning of Forgiveness”, Ensign, nëntor 1995, f. 19–20.

Dobësia njerëzore luan një rol të rëndësishëm në këto qëllime thelbësore të vdekshmërisë. Kur Moroni u shqetësua se dobësia e tij në të shkruar do t'i bënte johebrejtë të tallnin gjërat e shenja, Zoti e siguroi atë me këto fjalë:

“Dhe në qoftë se njerëzit vijnë tek unë, unë do t'u tregoj atyre dobësinë e tyre. Unë u jap njerëzve dobësi, që ata të jenë të përgjyer dhe hiri im është i mjaftueshëm për të gjithë njerëzit që përgjyeren para meje; pasi në qoftë se ata përgjyeren para meje dhe kanë besim tek unë, atëherë unë do të bëj që gjërat e dobëta, të bëhen të forta në ta” (Ethëri 12:27; shih edhe 1 Korintasve

15:42–44; 2 Korintasve 12:7–10; 2 Nefi 3:21; dhe Jakobi [LiM] 4:7).

Deduksionet e kësaj shkrimi të shenjtë të

njohur janë të thella dhe na ftojnë ta dallojmë mëkatin (të nxitur prej Satanit) nga dobësia (e përshkruar këtu si një gjendje “që na jepet” nga Perëndia).

Ne mund ta përkufizojmë dobësinë si kufizim në urtësinë, fuqinë dhe shenjtërinë tonë që vjen me të qenit njeri. Si njerëz të vdekshëm ne jemi lindur të pafuqi dhe të varur, me të meta fizike e prirje natyrore të ndryshme. Ne jemi rritur e rrethohemi nga njerëz të tjerë të vdekshëm e të dobët dhe mësimet, shembujt e sjelljet e tyre ndaj nesh janë të gabuara dhe ndonjëherë dëmtuese. Në gjendjen tonë të dobët, të vdekshme, ne vuajmë sëmundje fizike dhe emocionale, uri dhe lodhje. Ne përjetojmë emocione njerëzore si: zemërim, hidhërim dhe frikë. Ne na mungon urtësia, zotësia, aftësia për të duruar dhe forca. Dhe ne u nënshtrohemi tundimeve të shumë llojeve.



DALLIMI NDËRMJET MËKATIT DHE DOBËSISË

	Mëkati	Dobësia
Përkufizimi?	Mosbindje e vullnetshme ndaj Perëndisë	Kufizim njerëzor, mangësi
Burimi?	Nxitet nga Satani	Pjesë e natyrës sonë të vdekshme
Shembuj?	Shkelja me dijeni e urdhërimeve të Perëndisë, të besuarit e Satanit në vend të Perëndisë	Cenueshmëria nga tundimi, emocioni, lodhja, sëmundja fizike ose mendore, padituria, prirjet natyrore, trauma, vdekja
A kishte Jezusi?	Jo	Po
Përgjigjja jonë duhet të jetë?	Pendimi	Përlësia, besimi në Krisht dhe përpjekjet për ta mposhtur
Përgjigjja e Perëndisë ndaj përpjekjes sonë?	Falja	Hiri – fuqi aftësuese
E cila çon në?	Të pastruarit nga mëkati	Të fituarit e shenjtërisë, forcës

Ndonëse ishte pa mëkat, Jezu Krishti u bashkua me ne në mënyrë të plotë në gjendjen e dobësisë së vdekshme (shih 2 Korintasve 13:4). Ai u lind si një foshnjë e pafuqi në një trup të vdekshëm dhe u rrit nga kujdestarë të papërsosur. Atij iu desh të mësonte se si të ecte, të fliste, të punonte dhe të ishte në harmoni me të tjerët. Ai kishte uri dhe lodhje, ndiente emocione njerëzore dhe mund të sëmurëj, vuante, mund t'i rridhte gjak dhe të vdiste. Ai “u tundua në të gjitha ashtu si ne, por pa mëkatuar”, duke ia nënshtruar Vetën vdekshmërisë në mënyrë që të “mund t'i vijë keq për dobësitë tona” dhe të na ndihmojë për dobësitë ose mangësitë *tona* (Hebrenjve 4:15; shih edhe Alma 7:11–12).

Ne nuk mundet që thjesht të pendo kemi për të qenit të dobët – as dobësia vetë nuk na bën të papastër. Ne nuk mund të rritemi shpirtërisht, përveçse nëse *e flakim* mëkatin, por ne gjithashtu nuk rritemi shpirtërisht, përveçse nëse *e pranojmë* gjendjen tonë të dobësisë njerëzore, i përgjigjemi asaj me përlësi e besim dhe mësojmë nëpërmjet dobësisë sonë që t'i mirëbesojmë Perëndisë. Kur Moroni u shqetësua rreth dobësisë në të shkruarin e tij, Perëndia nuk i tha që të pendohej. Përkundrazi, Zoti e mësoi të ishte i përlur dhe të kishte besim në Krisht. Kur jemi të bindur dhe besnikë, Perëndia na jep hir – jo falje – si kurë për dobësinë. Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta e përkufizon hirin si një fuqi aftësuese nga Perëndia për të bërë atë që nuk mund ta bëjmë vetë (shih Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Hiri”, f. 64–65) – kura e duhur e përditshme me anë të së cilës Ai mund “të bëj[ë] që gjërat e dobëta, të bëhen të forta”.

Të Ushtrijmë Përlësi dhe Besim

Që herët në përvojën tonë në Kishë, neve na jepen mësim elementet thelbësore të pendimit, por saktësisht si e ushqejmë përlësinë dhe besimin? Merrni parasysh sa vijon:

- **Përsiatni dhe lutuni.** Ngaqë jemi të dobët, ne mund të mos e dallojmë nëse kemi të bëjmë me *mëkat* (që kërkon një ndryshim të menjëhershëm e depërtues të mendjes, zemrës e sjelljes) apo me *dobësi* (që kërkon përpjekje të përlur, të vazhdueshme, mësim e përmi-rësim). Mënyra se si i shikojmë këto gjëra mund të varet nga mënyra si jemi rritur dhe pjekuria jonë. Mund të ketë madje elemente si të mëkatisht edhe të dobësisë në një sjellje të vetme. Të thuash që një mëkat është në të vërtetë dobësi çon në arsytim në vend që të çojë në pendesë. Të thuash që një dobësi është mëkat mund të çojë në turpërim, fajësim, dëshpërim dhe heqje dorë nga premtimet e Perëndisë. Përsiatja dhe lutja na ndihmojnë t'i bëjmë këto dallime.
- **Vendosni përparësitë.** Ngaqë jemi të dobët, ne nuk mund ta bëjmë çdo ndryshim të nevojshëm gjithë njëherësh. Ndërsa ne përlësisht dhe besnikërisht përpiqemi ta mposhtim dobësinë tonë njerëzore duke u marrë me disa aspekte një e nga një, ne mundet gradualisht ta ulim paditurinë, t'i bëjmë zakon modelet e mira, ta zhvillojmë shëndetin tonë fizik dhe emocional e aftësinë tonë për të duruar dhe të forcojmë mirëbesimin tonë te Zoti. Perëndia mund të na ndihmojë të dimë se ku të fillojmë.

- **Planifikoni.** Ngaqë jemi të dobët, të forcuarit do të kërkojë më tepër sesa një dëshirë të drejtë dhe shumë vetëdisiplinim. Ne gjithashtu duhet të planifikojmë, të mësojmë nga gabimet, të zhvillojmë strategji më të efektshme, të rishikojmë planet tona dhe të përpiqemi përsëri. Ne kemi nevojë për ndihmë nga shkrimet e shenjta, libra të përshtatshëm dhe njerëz të tjerë. Ne fillojmë nga pak, gëzohemi me përmirësimin dhe pranojmë rreziqe (edhe pse ato na bëjnë të ndihemi të cenueshëm dhe të dobët). Ne kemi nevojë për mbështetje që të na ndihmojë të bëjmë zgjedhje të mira edhe kur jemi të lodhur ose të shkurajuar dhe plane për t'u kthyer në udhën e duhur kur gabojmë.
- **Ushtroni durim.** Ngaqë jemi të dobët, ndryshimi mund të kërkojë kohë. Ne nuk [mundet që] thjesht të heqim dorë nga dobësia jonë në të njëjtën mënyrë si heqim dorë nga mëkati. Dishepuj të përulur bëjnë me gatishmëri atë që u kërkohet, mësojnë përtëritjen, vazhdojnë të përpiqen dhe nuk dorëzohen. Përlësia na ndihmon të kemi durim me veten dhe të tjerët, të cilët janë gjithashtu të dobët. Durimi është shfaqje e besimit tonë në Zot, mirënjohje për besimin e Tij te ne dhe mirëbesim në premtimet e Tij.

Edhe kur pendohemi me sinqeritet për mëkatet tona, marrim falje dhe bëhemi përsëri të pastër, ne mbetemi të dobët. Ne ende i nënshtrohemi sëmundjes, emocionit, paditurisë, prirjeve natyrore, lodhjes dhe tundimit. *Por kufizimet dhe mangësitë nuk janë mëkate dhe nuk na pengojnë që të jemi të pastër e të denjë për Shpirtin.*

Dobësia në Forcë

Ndonëse Satani është i etur ta përdorë dobësinë tonë për të na nxitur që të mëkatojmë, Perëndia mund ta përdorë dobësinë njerëzore për të na mësuar, forcuar



**DALLIMI I NDJENJËS DOBIPRURËSE TË FAJIT (PIKËLLIMIT TË PERËNDISHËM)
DHE PËRULËSISË NGA TRILLIMI I PADOBISHËM I TURPIT**

Ndjenja Dobiprurëse e Fajit – Pikëllimi i Perëndishëm për Mëkatin	Besimi & Përlësia – Përlësia si e Krishtit në Përjetimin e Dobësisë	Turpi Shkatërrimtar – Trillim i Padobishëm
<p align="center">Ne kemi prirjen që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndiejmë keqardhje për shkeljen e kodit tonë moral. • Pendo kemi, ndryshojmë mendjen, zemrën, sjelljen tonë. • Jemi të hapur, rrëfejmë gabimet tona, bëjmë korrigjime. • Shikojmë dhe mësojmë. • Shikojmë veten si qenësisht të mirë, me vlerë. • Dëshirojmë ta përputhim sjelljen tonë me imazhin tonë pozitiv për veten. • Mirëbesojmë plotësisht në fuqinë shëlbuese të Shlyerjes së Krishtit. 	<p align="center">Ne kemi prirjen që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndiejmë siguri të qetë dhe vetëpranim, pavarësisht gjithë të metave vetjake. • Pranojmë rreziqe për t'u rritur dhe për të ndihmuar. • Mbajmë përgjegjësi për veprimet e gabuara, dëshirojmë të përmirësohemi. • Mësojmë nga gabimet dhe përpiqemi përsëri. • Zhvillojmë një ndjenjë humori dhe gëzojmë jetën dhe të tjerët. • Shikojmë dobësinë tonë si diçka që na bën të ngjashëm me të tjerët. • Jemi të duruar ndaj dobësive dhe të metave të të tjerëve. • Rritemi në vetëbesim në dashurinë dhe ndihmën e Perëndisë. 	<p align="center">Ne kemi prirjen që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndiehemi të pavlerë, duke u dëshpëruar. • Përpiqemi t'i fshehim dobësitë tona prej të tjerëve. • Kemi frikë se mos zbulohemi. • Fajësojmë të tjerët për problemet. • Shmangim pranimin e rreziqeve, duke e parë dështimin si poshtëruar. • Konkurrojmë dhe krahasojmë veten me të tjerët. • Bëhemi justifikues dhe kokëfortë ose të lëkundur. • Jemi sarkastikë ose jashtë mase seriozë. • Merakosemi për mangësitë tona ose epërsitë tona. • Kemi frikë mospranimit dhe neverinë nga Perëndia.

dhe bekuar. Sidoqoftë, në kundërshtim me atë që mund të presim ose shpresojmë, Perëndia jo gjithmonë “bë[n] që gjërat e dobëta, të bëhen të forta” në ne duke e hequr dobësinë tonë. Kur Apostulli Pal u lut vazhdimisht që Perëndia t'i hiqte një “gjëmb në mish” që Satani e përdorte për t'i rënë me grushta, Perëndia i tha: “Hiri im të mjafton, sepse fuqia ime përsoset në dobësi” (2 Korintasve 12:7, 9).

Ka shumë mënyra se si Zoti i bën “gjërat e dobëta, të bëhen të forta”. Ndonëse Ai mund ta heqë dobësinë nëpërmjet kurës së jashtëzakonshme për të cilën shpresojmë, nga përvoja ime vetjake kjo ndodh disi rrallë. Për shembull, nuk shoh asnjë provë që Perëndia e hoqi dobësinë e Moronit në të shkruar pas vargut të famshëm tek Ethëri 12. Perëndia gjithashtu mundet që gjërat e dobëta t'i bëjë të forta duke na ndihmuar të punojmë me dobësitë tona, të fitojmë një ndjenjë humori ose perspektivë të përshtatshme rreth tyre dhe të përmirësohemi gradualisht me kalimin e kohës lidhur me to. Gjithashtu, forcat dhe dobësitë shpesh janë të ndërlidhura (si p.sh. forca e këmbënguljes dhe dobësia e kokëfortësisë) dhe ne mund të mësojmë të vlerësojmë forcën dhe të zbutim dobësinë që e shoqëron atë.

Ka një mënyrë tjetër, edhe më të fuqishme, se si Perëndia gjërat e dobëta i bën të forta në ne. Zoti i thotë Moronit tek Ethëri 12:37: “Pasi ti ke parë dobësinë tënde, do të bëhesh i fortë, madje sa të ulesh në vendin që unë kam përgatitur në pallatet e Atit tim”.

Këtu Perëndia nuk po parashtron që të ndryshojë dobësinë e Moronit, por të ndryshojë Moronin. Duke u përpjekur ta mposhte sfidën e dobësisë njerëzore, Moroni – dhe ne – mund të mësojmë dashurinë hyjnore, dhembshurinë, përlësinë, durimin, guximin, stoicizmin, urtësinë, forcën për të duruar, faljen, përtëritjen, mirënjohjen, krijimtarinë dhe një mori virtytesh të tjera që na bëjnë më të ngjashëm me Atin tonë në Qiell. Këto janë pikërisht tiparet për të cilat erdhëm në tokë që t'i mprihnim, cilësitë si të Krishtit që na përgatitin për pallatet atje lart.

Askund nuk është më e dukshme dashuria, urtësia dhe fuqia shëlbuese e Perëndisë sesa në aftësinë e Tij për ta kthyer luftën tonë me dobësinë njerëzore në virtytet e paçmueshme të perëndishme dhe forcat që na bëjnë më të ngjashëm me Të. ■

Autorja jeton në Jutë, SHBA.





Nga Plaku
W. Kristofer Uadell,
i Të Shtatëdhjetëve

Feja E PASTER

Shërbimi vetëmohues – harrimi i vetes, përgjigja ndaj nevojave të të tjerëve dhe vënia e jetës sonë në shërbim të tyre – ka qenë përherë një karakteristikë e dishepujve të Jezu Krishtit.

Te Mateu kapitulli 11, Shpëtimtari na jep një mësim të rëndësishëm nga ajo që *nuk* tha në përgjigje të një pyetjeje të bërë nga dishepujt e Gjon Pagëzorit:

“Por Gjoni, që kishte dëgjuar në burg të flitej për veprat e Krishtit, dërgoi dy nga dishepujt e vet për t’i thënë:

‘A je ti ai që duhet të vijë, apo duhet të presim një tjetër?’

Dhe Jezusi, duke u përgjigjur, u tha atyre: ‘Shkoni dhe i tregoni Gjonit gjërat që dëgjoni dhe shikoni:

Të verbërit po shohin, të çalët po ecin, lebrozët janë pas-truar dhe të shurdhërit po dëgjojnë; të vdekurit po ngjallen dhe ungjilli po u predikohet të varfërve’” (Mateu 11:2–5).

Në vend që të jepte një shpjegim të shkurtër doktrinor duke përshkruar se Ai ishte vërtet “ai që duhet të v[inte]”, Shpëtimtari u përgjigj me anë të gjërave që bënte – shembullin e Tij të shërbimit.

Në konferencën e përgjithshme të prillit 2014, Plaku Riçard G. Skot, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, na kujtoi: “Ne i shërbejmë më së miri Atit tonë në Qiell duke ndikuar drejtësisht tek të tjerët dhe duke u shërbyer atyre. Shembulli më i madhërishtëm që eci ndonjëherë mbi tokë, është Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti.”¹

Shërbimi vetëmohues – harrimi i vetes, përgjigja ndaj nevojave të të tjerëve dhe vënia e jetës sonë në shërbim të tyre – ka qenë përherë një karakteristikë e dishepujve të Jezu Krishtit. Siç dha mësim mbreti Beniamin mbi 100 vite

përpara lindjes së Shpëtimtarit: “Kur jeni në shërbimin e bashkëqenieve tuaja, ju jeni vetëm në shërbimin e Perëndisë tuaj” (Mosia 2:17).

Jakobi na kujton se një aspekt thelbësor i “fe[së] [së] pastër” vërehet te shërbimi ynë ndaj të tjerëve kur ne “vizitojmë” jetimet dhe të vejat në pikëllimet e tyre” (Jakob [Bibël] 1:27). “Feja e pastër” është më tepër sesa një shpallje e besimit; ajo është një shfaqje e besimit.

Duajini Bashkudhëtarët Tuaj

Në mes të korrikut të vitit 1984, vetëm disa javë pasi unë dhe gruaja ime, Karol, ishim martuar në Tempullin e Los Anxhelosit në Kaliforni, ne ishim duke shkuar drejt Jutas, ku unë do të filloja karrierën time dhe Karola do të përfundonte arsimimin e saj në kolegji. Ne ishim duke ngarë makina të ndryshme. Ndërmjet dy automjeteve, ne po transportonim gjithçka zotëronim.

Afro në gjysmë të rrugës për në pikëmbërritjen tonë, Karola bëri përpara anash makinës time dhe filloi të më bënte me shenja. Kjo ndodhi në ditët përpara telefonave celularë e smart, dërgimit të mesazheve dhe Tuterit. Duke parë shprehjen në fytyrën e saj përmes dritares së makinës, mund të vija re se nuk ndihej mirë. Ajo tha se mund të vazhdonte ta ngiste makinën, por unë isha i shqetësuar për nusen time të re.

Kur iu afroam qytetit të vogël të Bivërit, Juta, ajo sërish lëvizi përpara anash meje dhe mund ta vija re se kishte nevojë të ndalonte. Ajo ishte sëmure dhe nuk mund të vazhdonte më. Ne kishim dy makina plot me rroba dhe dhurata martese, por fatkeqësisht ne kishim pak para. Një dhomë në hotel nuk kishte vend në buxhetin tonë. Nuk isha i sigurt se çfarë të bëja.

Asnjëri prej nesh nuk kishte qenë ndonjëherë në Bivër dhe, duke mos e ditur në të vërtetë se çfarë po kërkoja, ne lëvizëm me makina vërdallë për disa minuta derisa pashë një park. Shkuam drejt vendparkimit dhe gjetëm një pemë me hije, ku shtrova një batanije në mënyrë që Karola të mund të pushonte.

Pak minuta më vonë, një makinë tjetër hyri në vendparkimin pothuaj bosh dhe e parkoi makinën anash dy makinave tona. Një grua, me moshë pothuaj sa nënat tona, doli nga makina e saj dhe pyeti nëse kishte diçka që nuk shkante dhe nëse mund të ndihmonte. Ajo përmendi se na kishte vënë re ndërsa po lëvizte me makinë aty afër dhe ndjeu se duhej të ndalonte. Kur i shpjegua rrethanat tona, ajo menjëherë na ftoi ta ndiqnim për në shtëpinë e saj, ku mund të pushonim për sa kohë të kishim nevojë.

Shpejt e gjetëm veten në një krevat të rehatshëm në një dhomë gjumi të freskët në katin përdhes të shtëpisë së saj. Sapo ishim sistemuar, kjo motër e mrekullueshme përmendi se kishte një numër porosish për të përfunduar dhe se do të na linte vetëm për disa orë. Na tha se, nëse kishim uri, ishim të mirëpritur të shfrytëzonim gjithçka që mund të gjenim në kuzhinë dhe nëse do të largoheshim përpara se të kthehej ajo në shtëpi, ishim të lutur të mbyllim derën kryesore.

Pasi bëri ca gjumë tepër të nevojshëm, Karola u ndie më mirë dhe ne vijam me udhëtimin tonë pa ndalur në kuzhinë. Kur u larguam, gruaja e përzemërt nuk ishte kthyer ende në shtëpi. Për turpërimin tonë, ne nuk e mbajtëm shënim adresën dhe nuk e kemi falënderuar kurrë si duhet samaritanen tonë të mirë, e cila ndaloi në udhë dhe ia hapi shtëpinë e saj të panjohurve në nevojë.

Ndërsa reflektoj për këtë përvojë, fjalët e Presidentit Tomas S. Monson, i cili mishëron porosinë e Shpëtimtarit për të “shk[uar] dhe bë[rë] kështu” (shih Lluka 10:37) po aq sa çdo njeri i vdekshëm, më vijnë në mendje: “Ne nuk mund ta duam me të vërtetë Perëndinë, në qoftë se nuk i duam bashkudhëtarët tanë në këtë udhëtim në vdekshmëri”².

Kudo që hasim “bashkudhëtarë” – në rrugë apo në shtëpitë tona, në sheshin e lojërave apo në shkollat tona, në vendin e punës apo në kishë – ndërsa kërkojmë, shikojmë dhe veprojmë, ne do të bëhemi më shumë si Shpëtimtari, duke bekuar e shërbyer gjatë udhës.

Kërkoni

Plaku Nil A. Maksudell (1926–2004), i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim:

“Ndryshe nga Shpëtimtari ynë i çmuar, ne sigurisht nuk mund të shlyejmë për mëkatet e njerëzimit! Për më tepër, ne me siguri nuk mund të mbajmë të gjitha sëmundjet, dobësitë dhe brengat e vdekshmërisë (shih Alma 7:11–12).

Megjithatë, në shkallën tonë më të vogël, ashtu siç Jezusi na ka ftuar, ne me të vërtetë mund të përpiqemi të bëhemi ‘madje siç [është Ai]’ (3 Nefi 27:27).”³

Ndërsa përpiqemi të bëhemi madje siç është Ai, me një dëshirë të sinqertë për të bekuar “bashkudhëtarët tanë”, neve do të na jepen mundësi për ta harruar veten dhe për të ngritur të tjerët. Këto mundësi mund të jenë shpesh jo të lehta, duke vënë në provë dëshirën tonë të vërtetë për t’u bërë më shumë si Mësuesi, shërbimi më i madh i të cilit nga të gjitha, Shlyerja e Tij e pafund, në asnjë mënyrë nuk qe e lehtë. “Megjithatë”, thotë Ai, “lavdi i qoftë Atit dhe unë mora pjesë e i mbarova përgatitjet e mia për fëmijët e njerëzve” (DeB 19:19).

Të kërkuarit me sinqeritet për t’u bërë më shumë si Shpëtimtari do të na lejojë të shohim atë që përndryshe mund të mos e shohim. Samaritania jonë e mirë ishte sa duhej e ndjeshme ndaj Shpirtit për t’iu përgjigjur një nxitjeje dhe për t’iu qasur një të panjohuri në nevojë.

Shihni

Të shohësh me sy shpirtërorë është t’i shohësh gjërat siç janë në të vërtetë dhe të dallosh nevoja që përndryshe mund të mos i kishim vënë re. Në shëmbëlltyrën e deleve dhe cjeppvë, as ata që u “bekuan”, as ata që u “mallkuan” nuk kishin dalluar Shpëtimtarin te njerëzit që ishin të uritur, të etur, të zhveshur ose në burg. Ata reagueshan ndaj shpërblimit të tyre duke pyetur: “Kur të pamë?” (Shih Mateu 25:34–44).

Vetëm ata që kishin parë me sy shpirtërorë duke e dalluar nevojën, vepruan dhe i bekuan ata që vuanin. Samaritania jonë e mirë e dalloj nevojën ndërsa pa me sy shpirtërorë.

Veproni

Ne mund të shohim nevoja rreth nesh, por të ndihe-
mi të papërshtatshëm për t'u përgjigjur, duke supozuar
se ajo që kemi për të dhënë, nuk është e mjaftueshme.
Ndërsa përpiqemi që të bëhemi madje siç është Ai dhe
ndërsa shikojmë nevoja të bashkudhëtarët tanë nëpër-
mjet syve shpirtërorë, ne duhet të kemi mirëbesim se
Zoti mund të veprojë nëpërmjet nesh dhe atëherë ne
duhet të veprojmë.

Duke hyrë në tempull, Pjetri dhe Gjoni ndeshën një
burrë të “çalë që prej lindjes”, i cili u kërkoi lëmoshë (shih
Veprat e Apostujve 3:1–3). Përgjigja e Pjetrit është shembull
dhe ftesë për secilin prej nesh:

“Unë nuk kam as argjend, as ar, por atë që kam po
ta jap: në emër të Jezu Krishtit Nazarenas, çohu dhe ec!”

Dhe, si e kapi nga dora e djathtë, e ngriti në këmbë”
(Veprat e Apostujve 3:6–7).

Ne mund të veprojmë duke dhënë nga koha e talentet
tona, duke dhënë një fjalë të mirë ose punë fizike. Ndërsa
kërkojmë e shikojmë, ne do të vendosemi në rrethana dhe
situata ku mund të veprojmë e bekojmë. Samaritania jonë
e mirë veproji. Ajo na mori në shtëpinë e saj dhe na dha atë
që kishte. Në thelb, ajo tha: “Atë që kam po ta jap”. Ishte
tamam ajo për të cilën kishim nevojë.

Presidenti Monson ka dhënë mësim po këto parime:

“Secili prej nesh, në udhëtimin gjatë vdekshmërisë, do të
shkelë vetë Udhën e tij për në Jeriko. Cila do të jetë përvoja
juaj? Cila do të jetë përvoja ime? Vallë mos nuk do të arrij
ta vë re atë që ka rënë në duart e hajdutëve dhe kërkon
ndihmën time? Po ju?

Vallë mos do të jem personi që e shikon të lënduarin dhe e
dëgjon lutjen e tij e prapëseprapë kalon në anën tjetër? Po ju?

Apo do të jem personi i cili shikon, i cili dëgjon, i cili
ndalon dhe i cili ndihmon? Po ju?

Jezusi na dha kushtimin: ‘Shko dhe bëj kështu edhe ti’.
Kur i bindemi asaj deklaratë, pamjes sonë për përjetësinë
i shpaloiset një tablo gëzimi të cilës rrallë i gjendet shoku
dhe që kurrë nuk tejkalohet.”⁴

Ndërsa bëhemi më shumë si Shpëtimtari duke kërkuar,
shikuar dhe vepruar, ne do të arrijmë të dimë për vërtetë-
sinë e fjalëve të mbretit Beniamin: “Kur jeni në shërbimin e
bashkëqenieve tuaja, ju jeni vetëm në shërbimin e Perëndi-
së tuaj” (Mosia 2:17). ■

SHËNIME

1. Riçard G. Skot, “Ju Kam Dhënë Shembullin”, *Liahona*, maj 2014, f. 35.
2. Tomas S. Monson, “Dashuria – Thelbi i Ungjillit”, *Liahona*, maj 2014, f. 91.
3. Neal A. Maxwell, “Apply the Atoning Blood of Christ”, *Ensign*, nëntor 1997, f. 22.
4. Thomas S. Monson, “Your Jericho Road”, *Ensign*, maj 1977, f. 71.


KËRKONI ME SINGHERITET



SHIKONI ME SY SHPIRTËRORË



VEPRONI DHE BEKONI





함께 합소서
Need That Every Hour

신소프신
우쿠슬하

없기되소



“ÇDO OR’

Më Duhesh Ti”

*Kur ne nuk dinim më se çfarë mund të jepnim mësim,
shoku im i misionit sugjeroi që të këndonim këtë himn.*

Nga Xhonatan H. Uestover

Një pasdite të këndshme të diele në misionin tim në Balsan të Koresë, unë dhe shoku im po u thoshim mirupafshim anëtarëve pas [mbarimit] të kishës dhe ishim gati të fillonim predikimin kur udhëheqësi i misionit të lagjes na njohu me një djalë 12-vjeçar, Kong Sung-Gunin. Ai kishte marrë pjesë në kishë atë ditë dhe dëshironte të mësonte më shumë rreth ungjillit.

Natyrisht, ne ishim të lumtur rreth shpresës për t'i dhënë atij mësim, por unë isha gjithashtu i shqetësuar për të mësuar dikë kaq të ri. Vendosëm që të siguroheshim se kishim lejen e prindërve të tij, kështu që mora në telefon familjen e Kong Sung-Gunit dhe bisedova shkurtimisht me nënën e tij, Pak Mi-Jungun. U habita kur ajo tha se ishte e gëzuar që djali i saj po kërkonte të merrte pjesë në kishë dhe se ajo do të ishte e lumtur që ne të shkonim ta mësonim atë.

Kërkues të Paparashikuar

Mbrëmjen vijuese ne mbërritëm në shtëpinë e djalit, gati për të dhënë mësim. U habitëm kur morëm vesh se Pak Mi-Jungu donte që ne të mësonim edhe vajzën e saj, Kong Su-Jinin. Dhe meqenëse ishim të huaj në shtëpinë e saj, Pak Mi-Jungu donte që të ulej me ne gjatë mësimëve. Sigurisht që ne ishim të lumtur të mësonim aq njerëz sa donin të dëgjonin.

Pasi na kishin qerasur, ne u ulëm së bashku dhe filluam të bisedonim. Në vend që të nisnim direkt mësimin, Pak Mi-Jungu dëshironte të na njihte më mirë dhe të na tregonte për rrethanat e familjes së saj. Ajo na tregoi për sprovat e fundit dhe vështirësitë që kishin kaluar, përfshirë betejën e fundit të djalit të saj me kancerin. Ai e kishte kaluar me sukses trajtimin me rreze dhe kanceri aktualisht ishte pakësuar, por doktorët i paralajmëruan se mund të rishfaqej në çdo kohë. Kjo ishte shumë e vështirë për familjen. Ata ishin një familje e klasës punëtore dhe babai duhej të punonte jashtëzakonisht shumë vetëm për të mbajtur një çati mbi kokat e tyre dhe ushqim në tryezë.

Isha i tronditur dhe i trishtuar nga sprovat në jetën e tyre. Jeta nuk ishte e lehtë për ta, por afërsia brenda familjes ishte shumë më e dukshme sesa e kisha parë në ndonjë familje tjetër që kisha takuar në Kore, që do të thotë shumë për një shoqëri si Korea, të orientuar drejt familjes. Ne u larguam nga shtëpia e tyre atë mbrëmje duke e njohur më mirë këtë familje të veçantë dhe duke pasur mundësinë të ndanim mesazhet e ungjillit me ta.

Unë dhe shoku im u kthyem për t'i mësuar disa herë atë javë, çdo herë duke përjetuar të njëjtën ngrohtësi dhe bujari që kishim përjetuar në vizitën tonë të parë. Kur u

përmend tema e pagëzimit, të dy fëmijët ishin shumë të zellshëm për t'u bashkuar me Kishën. Megjithatë, nëna e tyre nuk ndau të njëjtin entuziazëm me ta. Megjithëse mësimet tona e tërhiqnin dhe ajo shpresonte të ishin të vërteta, ajo ndiente se nuk mund të bënte dhe mbante llojin e zotimeve që kërkonte bashkimi me Kishën. Ajo gjithashtu ndiente se nuk do të ishte e përshtatshme të pagëzohej pa bashkëshortin e saj, të cilin akoma nuk e kishim takuar. Megjithatë, ajo ishte më shumë se e gatshme të vazhdonte të takohej me ne dhe gjithashtu dëshironte të bashkohej me fëmijët e saj në pjesëmarrjen në Kishë.

Drejt fundit të asaj jave të dytë, ndërsa vazhduam të jepnim mësim në shtëpinë e saj, ne takuam bashkëshortin e saj, Kong Kuk-Uonin – një burrë i përrulur, shpirtmirë dhe bujar. Ai na u bashkua për disa nga diskutimet e fundit dhe besoi menjëherë çdo gjë që i mësuam, përfshirë doktrinat që të tjerët shpesh i konsiderojnë të vështira si e dhjeta dhe Fjala e Urtësisë. Pavarësisht nga gjendja financiare në prag skamjeje, ata filluan të paguanin të dhjetën. Pengesa e vetme e babait ishte se i duhej të punonte të dielave. Ai punonte në aeroportin ndërkombëtar të Seulit çdo të diel, kështu që nuk ishte në gjendje të vinte në kishë me pjesën tjetër të familjes. Pavarësisht nga orari i punës, ai dhe bashkëshortja e tij e rregulluan që të merrnin pjesë në pagëzimin e fëmijëve të tyre të dielën vijuese.

Pas pagëzimit të fëmijëve, ne vazhduam të takoheshim shpesh në shtëpinë e familjes. Ne bënim mbrëmje familjare, ndanim shkrime të shenjta e përvoja lartësuese, dhe i njohëm ata me anëtarë të lagjes. Megjithatë, pavarësisht nga përvojat e vazhdueshme me ungjillin, prindërit nuk ishin afër pagëzimit.

Nërkohë, shoku im u transferua dhe shoku im i ri i misionit ishte një elder [plak] që vinte drejt e nga qendra e trajnimit të misionarëve. Ai ishte plot besim, energji e gjallëri dhe sinqerisht unë pata një kohë të vështirë të matesha me të. Pasi u takua me Kong Kuk-Uonin dhe Pak Mi-Jungun në disa raste, shoku im m'u afrua dhe më pyeti nëse unë dhe shoku im i mëparshëm kishim agjëruar me ta. Ne nuk kishim agjëruar. Në fakt, as nuk më kishte vajtur në mendje. Kështu që u takuam me familjen dhe u sugjeruam një agjërim. U trondita kur zbulova se ata vetë



Shpirti ishte i fuqishëm në dhomë ndërsa përfunduam strofën e fundit. Pak Mi-Jungu më pa drejt e në sy dhe tha: "Unë kam nevojë të pagëzohem".

kishin qenë duke agjëruar sistematikisht, si për shëndetin e djalit të tyre edhe për një ndryshim në orarin e punës, që do ta lejonte Kung Kuk-Uonin të merrte pjesë në kishë. Pasi unë e shoku im iu bashkuam atyre në agjërim, lutjet tona morën përgjigje dhe orari i punës së Kong Kuk-Uonit ndryshoi. Por Pak Mi-Jungu ishte ende e vendosur për të mos u pagëzuar.

Një Ide e Frymëzuar

Atëherë shoku im pati një tjetër ide të shkëlqyer. Ai nxori librin e tij të himneve në madhësinë e xhepit dhe pyeti nëse mund të këndonim me ta. Megjithëse ne

kishim kënduar së bashku në raste të mëparshme, unë kurrë nuk e kisha parë Pak Mi-Jungun të këndonte, dhe thjesht hamendësova se asaj nuk i pëlqente të këndonte ose nuk ndihej rehat sepse muzika ishte diçka e re për të. Shoku im e pyeti nëse ajo kishte ndonjë himn të parapëlqyer dhe për habinë time, ajo u prek dhe u përgjigj se, që kur ishte vajzë e vogël, himni i saj i parapëlqyer kishte qenë “Çdo Or’ Më Duhesh Ti” (*Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 12). Ne filluam duke kënduar një harmoni me katër pjesë, me babain duke kënduar melodinë, nënën duke kënduar si alto, shokun tim duke kënduar si tenor dhe unë duke kënduar si bas.

Shpirti ishte i fuqishëm në dhomë. Kur kënduam strofën e tretë, emocioni e pushtoi atë dhe zëri i saj u ul ndërsa vazhduam:

*Çdo or’ më duhesh Ti,
Në dhembje o gëzim.
Shpejt eja, pran’ më rri,
O jeta s’ka kuptim.
Më duhesh, më duhesh Ti;
Çdo or’, më du’esh mua Ti!
Bekomë, Shpëtuesi im;
Te ty un’ vij!*

Kur përfunduam strofën e katërt dhe të fundit, ajo po qante me dënësë. Ndërsa bashkëshorti i saj u përpoq ta ngushëllonte, ajo përfundimisht arriti ta mblidhte veten. Ajo më pa drejt e në sy dhe tha: “Unë kam nevojë të pagëzohem”.

Shërbimi i pagëzimit për Kong Kuk-Uonin dhe Pak Mi-Jungun atë pasdite të diele ishte një nga shërbimet më shpirtërore të misionit tim. Fëmijët e tyre morën pjesë në program dhe shumë anëtarë vendorë erdhën për të treguar mbështetjen e tyre për familjen më të re të kthyer në besim në lagjen e tyre.

Unë dhe shoku im dhamë një numër të veçantë muzikor: “Çdo Or’ Më Duhesh Ti”.

Përfundimisht, unë e mbarova misionin tim dhe u ktheva në shtëpi. Pas një viti në kolegji, unë u ktheva në Kore për një stazh vere dhe çdo fundjavë caktoja një kohë për të vizituar shumë nga miqtë dhe familjet e veçanta që kisha takuar në misionin tim. Pas pak javësh, u ktheva në Balsan dhe u takova me këtë familje të veçantë. Kur mbërrita në shtëpinë e tyre, vura re se dikush mungonte – djali i tyre. Me lot në sy, Pak Mi-Jungu më dha lajmin: kanceri i djalit të tyre ishte kthyer dhe, në moshën 14-vjeçare, ai e kishte humbur betejën.

Teksa përpiquesha t’i shprehja ngushëllimet e mia dhe të përballeshja edhe me dhimbjen që ndieja, Kong Kuk-Uoni më siguroi se çdo gjë do të ishte mirë. Ata e donin ungjillin, merrnin pjesë besnikërisht në kishë dhe prisnim me padurim ditën kur familja e tyre do të mund të vulosej së bashku për përjetësinë në Tempullin e Seulit në Kore. Pavarësisht nga dhimbja që ndienin, familja e dinte se ata do ta shikonin përsëri Kong Sung-Gunin dhe do të bashkoheshin sërish. Pak Mi-Jungu më tha gjithashtu se këndimi i himneve çdo ditë e ndihmonte të gjente forcë për t’i bërë ballë dhe për të ndier paqen shoqëruese që sjell Shpirti.

Kur u largova nga shtëpia e tyre atë mbrëmje, reflektova përsëri mbi fjalët e himnit të parapëlqyer të Pak Mi-Jungut. Unë jam mirënjohës që Ati Qiellor e bekoji familjen me paqe pas vdekjes së Kong Sung-Gunit, dhe jam veçanërisht mirënjohës për rolin e Shpirtit në kthimin në besim të Pak Mi-Jungut, e cila i mundësoi familjes që të kualifikohet për bekimet e përjetshme të tempullit. ■

Autori jeton në Juta, SHBA.

HIMNET QETËSOJNË ATA QË VAJTOJNË

“Disa prej ligjëratave më të mëdha janë predikuar duke kënduar himne. Himnet na çojnë në pendim dhe vepra të mira, forcojnë dëshminë dhe besimin, ngushëllojnë zemërlëshuarit, qetësojnë ata që vajtojnë dhe na frymëzojnë të durojmë deri në fund.”

*“First Presidency Preface”,
Hymns, f. ix.*



**Nga Presidenti
Boyd K. Packer,**
President i Kuorumit
të Dymbëdhjetë
Apostujve

Sakrifica Vetëmohuese dhe e Shenjtë e Shpëtimtarit

*Zoti është gjithmonë gati për t'ju
ndihmuar. Ai ka vuajtur dhe ka
paguar dënimin nëse keni vullnetin
ta pranoni Atë si Shëlbuesin tuaj.*


Ne të gjithë jetojmë me një borxh shpirtëror. Në një mënyrë apo një tjetër, llogaria shtohet e shtohet. Nëse ju e shlyeni ndërsa shkoni, ju keni pak nevojë të shqetësoheni. Shpejt ju filloni të mësoni disiplinën dhe të dini se ka një ditë gjykimi përpara. Mësoni ta mbani llogarinë tuaj shpirtërore të shlyer në periudha të rregullta, në vend që ta lejoni të grumbullojë interesa dhe gjoba.

Ngaqë ju jeni duke u provuar, pritet që ju do të bëni disa gabime. Unë mendoj se ju keni bërë gjëra në jetën tuaj që ju vjen keq, gjëra për të cilat as që mund të



shfajësoheni, jo më t'i korrigjoni; prandaj, ju mbani një barrë. Është koha tani të përdoret fjala *faj*, e cila mund të njollosë si boja që nuk fshihet dhe nuk mund të hiqet lehtë. Ndjesia e fajësisë është zhgënjim, keqardhje për bekime dhe mundësi të humbura.

Nëse po luftoni me fajin, ju nuk jeni ndryshe nga njerëzit e Librit të Mormonit për të cilët profeti tha: “Dhe për shkak të paudhësisë së tyre, kisha kishte filluar të zvogëlohej; dhe ata filluan të mos besonin në shpirtin e profecisë dhe në shpirtin e zbulesës; dhe gjykimet e Perëndisë i shikonin rreptë ndër sy” (Helamani 4:23).



Ne shpesh përpiqemi ta zgjidhim problemin e fajit duke i thënë njëri-tjetrit dhe vetes se nuk prish punë. Por disi, thellë në brendësi, ne nuk e besojmë këtë. As e besojmë veten nëse e themi atë. Ne e dimë më mirë. Prish punë!

Profetët na kanë mësuar gjithmonë pendesën. Alma tha: “Dhe vini re, ai vjen për të shëlbuar ata që do të pagëzohen në pendim, nëpërmjet besimit në emrin e tij” (Alma 9:27).

Alma i tha hapur birit të tij të pabindur: “Tani, pendimi nuk mund të vinte mbi njerëzit po të mos kishte një dënim i cili të ishte gjithashtu i përjetshëm, sikurse duhet të jetë edhe jeta e shpirtit, e vendosur kundërshtimisht planit të lumturisë” (Alma 42:16).

Ka dy qëllime themelore për jetën e vdekshme. I pari është që të marrim një trup që mund, nëse e duam atë, të pastrohet, të ekzaltohet dhe të jetojë përgjithmonë. Qëllimi i dytë është që të provohemi. Kur provohemi, ne sigurisht që do të bëjmë gabime. Por nëse do t'i bëjmë, ne mund të mësojmë nga gabimet tona. “Po të themi se s’kemi mëkatuar, e bëjmë atë gënjeshtar dhe fjala e tij nuk është në ne” (1 Gjon 1:10).

Ju, ndoshta, mund të ndiheni inferiorë në mendje e trup dhe jeni të shqetësuar apo të rënduar nga pesha e ndonjë llogarie shpirtërore që është shënuar si “borxh i mbetur”. Kur ju kuptoni të vërtetën rreth vetes në ato çaste meditimi të qeta (që shumë prej nesh përpiqen t’i shmangin), a ka disa gjëra të pazgjidhura që ju shqetësojnë? A keni diçka në ndërgjegjen tuaj? A jeni ende, në një shkallë apo një tjetër, fajtor për diçka të vogël ose të madhe?

Shumë shpesh ne marrim letra nga ata që kanë bërë gabime tragjike dhe janë të rënduar. Ata lutën: “A mund të falem ndonjëherë? A mund të ndryshoj ndonjëherë?” Përgjigjja është po!

Pali u mësoi korintasve: “Asnjë tundim nuk ju ka gjetur juve, përveç se tundimi njerëzor; por Perëndia është besnik dhe nuk do të lejojë që t’ju tundojnë përtej fuqive tuaja, por me tundimin do t’ju japë dhe rrugë dalje, që ju të mund ta përballoni” (1 Korintasve 10:13).

Ungjilli na mëson se ai lehtësim nga mundimi dhe faji mund të fitohet nëpërmjet pendimit. Përveç atyre të paktëve – atyre shumë të paktëve – që zgjedhin të ndjekin humbjen e shpirtit pasi kanë njohur një plotësi, nuk ka zakon, nuk ka varësi, nuk ka rebelim, nuk ka shkelje, nuk ka faj, të vogël apo të madh që përjashtohet nga premtimi për falje të plotë. Pavarësisht se çfarë ka ndodhur në jetën tuaj, Zoti ka përgatitur një rrugë kthimi për ju nëse do të mbani vesh nxitjet e Shpirtit të Shenjtë.

Disa janë të mbushur me një dëshirë të fortë, një tundim që vjen përsëri dhe përsëri në mendje, ndoshta për t’u bërë një zakon dhe pastaj një varësi. Ne jemi të prekshëm ndaj shkeljes e mëkatit dhe gjithashtu një arsyesimi se ne nuk kemi faj sepse u lindëm të tillë. Ne ngecim në kurth dhe nga ajo vjen dhimbja e mundimi që vetëm Shpëtimtari mund ta shërojë. Ju e keni fuqinë ta ndaloni dhe të shëlbëheni.

Satani Sulmon Familjen

Presidenti Marion G. Romni (1897–1988) më tregoi njëherë: “Mos u trego thjesht që

ata të mund të kuptojnë, tregojnë në mënyrë që ata të mos mund të keqkuptojnë”.

Nefi tha: “Pasi shpirti im kënaqet në qartësi; pasi sipas kësaj mënyre vepron Zoti Perëndi mes fëmijëve të njerëzve. Pasi, Zoti Perëndi i jep dritë të kuptuarit” (2 Nefi 31:3).

Kështu që dëgjoni me vëmendje! Unë do të flas qartë si një njeri që është thirrur dhe nën detyrimin për të vepruar kështu.

Ju e dini se ka një kundërshtar. Shkrimet e shenjta e përkufizojnë atë me këto terma: “Ai gjarpri i vjetër që është djalli, . . . ati i të gjitha gënjeshtrevë” (2 Nefi 2:18). Ai u zbuva që në fillim (shih DeB 29:36–38) dhe iu mohua trupi i vdekshëm. Ai është betuar tani për të prishur “planin e madh të lumturisë” (Alma 42:8) dhe për t’u bërë një armik i gjithë drejtësisë. Ai i përqendron sulmet e tij mbi familjen.

Ju jetoni në një kohë kur fshikullimi i pornografisë po përfshin gjithë botën. Është vështirë t’i shpëtosh. Pornografia është përqendruar në atë pjesë të natyrës suaj nëpërmjet së cilës ju keni fuqinë të krijoni jetë.

Kënaqja me pornografi çon në vështirësi, prishje martesë, sëmundje dhe andralla dhjetëra llojesh. Nuk ka pjesë të saj që të jetë e pafajshme. Ta mbledhësh, ta shikosh apo ta marrësh atë me vete andej-këndej në çfarëdo forme, është si të mbash gjarprin me zile në çantën e shpinës. Ajo ju ekspozon tek pasoja e njëjtë e pashmangshme shpirtërore e kafshimit prej gjarprit me injektim me helm vdekjeprurës. Mund të kuptohet lehtësisht, me botën që është ashtu siç është, që ju mundet thujtë në mënyrë të pafajshme të ekspozoheni ndaj saj, ta lexoni atë ose ta shihni pa i kuptuar pasojat e tmerrshme. Nëse kjo ju përshkruan ju, unë ju paralajmëroj që ta ndërprisni. Ndaleni tani!



Pati vetëm Një në të gjitha kronikat e historisë njerëzore që ishte tërësisht i pamëkatar dhe i kualifikuar të përgjigjej për mëkatet dhe shkeljet e të gjithë njerëzimit.

Libri i Mormonit na mëson se të gjithë “njerëzit janë udhëzuar mjaftueshëm që ata të kuptojnë të mirën nga e keqja” (2 Nefi 2:5). Dhe kjo përfshin ju. Ju e dini çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar. Jini shumë të kujdesshëm të mos bëni diçka që e dini se është e gabuar.

Edhe pse shumë gabime mund të rrëfohen privatisht te Zoti, ka disa shkelje që kërkojnë më shumë sesa kjo që të ketë falje. Nëse gabimet tuaja kanë qenë të rënda, takohuni me peshkopin tuaj. Përndryshe, rrëfimi i zakonshëm, i qetë dhe personal, do të mjaftojë. Por mbani mend, ai mëngjes i mrekullueshëm i faljes mund të mos vijë i gjithi menjëherë. Nëse në fillim pengoheni, mos u dorëzoni. Mposhtja e shkurajimit është pjesë e provës. Mos u dorëzoni. Dhe siç kam këshilluar përpara, me të pranuar dhe braktisur mëkatet tuaja, mos shihni prapa.

Shpëtimtari Vuajti për Mëkatet Tona

Zoti është gjithmonë gati për t’ju ndihmuar. Ai ka vuajtur dhe ka paguar dënimin nëse keni vullnetin ta pranoni Atë si Shëlbuesin tuaj.

Ngaqë jemi të vdekshëm, ne nuk mund, vërtet nuk mund, të kuptojmë plotësisht *se si* Shpëtimtari e përmbushi sakrificën e Tij shlyese. Por për tani *se si-ja* nuk është aq me rëndësi sa *pse-ja* e vuajtjes së Tij. Përse e bëri Ai atë për ju, për mua, për të gjithë njerëzimin? Ai e bëri atë për shkak të dashurisë për Perëndinë, Atin, dhe gjithë njerëzimin. “Askush s’ka dashuri më të madhe nga kjo: të japë jetën e vet për miqtë e tij” (Gjoni 15:13).

Në Gjetseman, Krishti u veçua nga Apostujt e Tij për t’u lutur. Gjithçka që ndodhi është përtej të kuptuarit tonë për ta ditur! Por ne dimë se Ai e përfundoi Shlyerjen. Ai ishte i

gatshëm të merrte mbi Vete gabimet, mëkatet dhe fajet, dyshimet dhe frikën e të gjithë botës. Ai vuajti për ne në mënyrë që ne të mos na duhet të vuajmë. Shumë të vdekshëm kanë vuajtur mundime e kanë pasur vdekje të dhimbshme e të tmerrshme. Por agonia e Tij i kapërceu të gjitha ato.

Në moshën time unë kam arritur të di çfarë është dhimbja fizike dhe nuk është argëtim! Askush nuk i shpëton kësaj jete pa mësuar diçka rreth vuajtjes. Por mundimi vetjak që unë nuk mund ta duroj, është kur unë kam arritur të kuptoj se i kam shkaktuar vuajtje një tjetri. Është atëherë që unë kuptoj në një shkallë të vogël agoninë që përjetoj Shpëtimtari në Kopshtin e Gjetsemanit.

Vuajtja e Tij ishte e ndryshme nga të gjitha vuajtjet e tjera të mëparshme ose më të mëvonshme sepse Ai mori mbi Vete të gjitha ndëshkimet që i ishin dhënë ndonjëherë familjes njerëzore. Imagjinojeni atë! Ai nuk kishte asnjë borxh për të shlyer. Ai nuk kishte bërë asnjë gabim. Megjithatë, një grumbullim i të gjithë fajit, brengës e hidhërimit, dhimbjes e poshtërimit, të të gjithë torturave mendore, emocionale dhe fizike që njehe njeriu – Ai i përjetoj ato të gjitha. Pati vetëm Një në të gjitha kronikat e historisë njerëzore që ishte tërësisht i pamëkat dhe i kualifikuar të përgjigjej për mëkatet dhe shkeljet e të gjithë njerëzimit, dhe t'i mbijetonte dhimbjes që e shoqëroi për të paguar për ta.

Ai ishte i gatshëm për ta sakrifikuar jetën e Tij dhe në thelb tha: “Jam unë që marr përsipër mëkatet e botës” (Mosia 26:23). Ai u kryqëzua; Ai vdiq. Ata nuk mund ta hiqnin jetën e Tij prej Tij. Ai dha pëlqimin që të vdiste.

Falja e Plotë është e Mundur

Nëse jeni penguar ose keni humbur ndonjëherë për njëfarë kohe, nëse ndieni se kundërshtari tani ju mban peng, ju mund të shkoni përpara me besim dhe të mos endeni më lart e poshtë në botë. Ka nga ata që qëndrojnë gati që t’ju drejtojnë përsëri te paqja dhe siguria. Madje hiri i Perëndisë, siç është premtuar në shkrimet e shenja, vjen “pas gjithçkaje që ne mund të bëjmë” (2 Nefi 25:23). Mundësia për këtë, për mua, është e vërteta më e vlefshme për t’u ditur.

Unë premtoj se mëngjesi i shkëlqyer i faljes mund të vijë. Atëherë “paqja e Perëndisë, që ia tejkalon çdo zgjuarësie” (Filipianëve 4:7) vjen në jetën tuaj përsëri, diçka si lindje dielli dhe ju dhe Ai, “nuk do ta kujto[ni] më mëkatit [tuaj]” (Jeremia 31:34). Si do ta dini ju? Ju do ta dini! (Shih Mosia 4:1–3.)

Kjo është ajo për të cilën kam ardhur t’ju mësoj juve që jeni në vështirësi. Ai do të hyjë dhe do ta zgjidhë problemin që ju nuk mund ta zgjidhni, por ju duhet të paguani çmimin. Kjo nuk ndodh nëse ju nuk bëni tuajën. Ai është një sundues shumë bujar sepse Ai e ka paguar çmimin e nevojshëm, por Ai do që ju të bëni atë që duhet, edhe nëse është e dhimbshme.

Unë e dua Zotin dhe unë e dua Atin që e dërgoi Atë. Barrët tona të zhgënjimit, mëkatit dhe fajit mund të vihen para Atij dhe në kushtet e Tij bujare, çdo zë në llogari mund të shënohet “e paguar plotësisht”.

“Ejani, pra, dhe të diskutojmë bashkë, thotë Zoti, edhe sikur mëkatet tuaja të ishin të kuqe flakë, do të bëhen të bardha si bora, edhe sikur të ishin të kuqe të purpur, do të bëhen si leshi.” Që do të ndodhë,

vazhdoi Isaia: “Në rast se jeni të gatshëm të bindeni” (Isaia 1:18–19).

Ejani tek Ai

Shkrimi i shenjtë “mëso urtësi në rininë tënde; po, mëso në rininë tënde të zbatosh urdhërimet e Perëndisë” (Alma 37:35) është një ftesë që shoqërohet me premtimin për paqe dhe mbrojtje nga kundërshtari. “Askush të mos e shpërfillë moshën tënde të re, por bëhu shembull për besimtarët në fjalë, në sjellje, në dashuri, në Frymë, në besim dhe në dëlirësi” (1 Timoteut 4:12).

Mos prisni që gjithçka do të shkojë shtuar gjatë gjithë jetës tuaj. Madje edhe për ata që po jetojnë siç duhet, nganjëherë do të ndodhë e kundërta. Përballojeni çdo sfidë të jetës me optimizëm e siguri dhe ju do të keni paqen e besimin që t’ju mbështetin tani dhe në të ardhmen.

Për ata që ende nuk i kanë të gjitha bekimet që ndieni se i doni dhe keni nevojë për t’i pasur, unë vendosmërisht besoj se asnjë përvojë apo mundësi thelbësore për shëlbim dhe shpëtim nuk do t’ju mohohet juve që jetoni besnikërisht. Qëndroni të denjë; jini plot shpresë, të durueshëm dhe plot lutje. Gjërat kanë një mënyrë për t’u rregulluar më në fund. Dhurata e Frymës së Shenjtë do t’ju udhëheqë dhe do të drejtojë veprimet tuaja.

Nëse ju jeni një nga ata që luftojnë me fajin, zhgënjimin apo depresionin si pasojë e gabimeve që keni bërë apo të bekimeve që ende nuk kanë ardhur, lexoni mësimet risiguruese që gjenden në himnin “Come unto Jesus” [“Te Jezusi t’Vini”]:

*Te Jezusi t’vini, ju t’munduar,
T’lodhur që nga m’kati shtypeni.*



*Barrët tona
të zhgënjimit,
mëkatit dhe fajit
mund të vihen
para Zotit dhe
në kushtet e Tij
bujare, çdo zë në
llogari mund të
shënohet “e paguar
plotësisht”.*

*N’limantin e sigurt’ për t’ju çuar
Ku besimtar’t mund t’prehen, t’prehen.*

*Te Jezusi t’vini; v’mendje kushton,
Dhe pse udhën humbët n’errësir’.
Dashuri’ e Tij but’sisht ju drejton
Nga nat’ e errët në dit’, në dit’.*

*Te Jezusi t’vini; vërtet ju d’gjon,
Po t’i luteni për dashuri.
S’e dini se pran’ engjëjt ju qëndrojnë
Nga mbretërit’ lart me drit’, me drit’?¹*

Unë pohoj, me Vëllezërit e mi Apostujt, të jem një dëshmitar i veçantë i Zotit Jezu Krisht. Ajo dëshmi vërtetohet çdo herë që unë ndiej brenda vetes ose te të tjerët ndikimin pastrues të sakrificës së Tij të shenjtë. Dëshmia ime dhe ajo e Vëllezërve të mi, është e vërtetë. Ne e njohim Zotin. Ai nuk është i huaj për profetët, shikuesit dhe zbuluesit e Tij.

E kuptoj se ju nuk jeni të përsosur, por ju po ecni në atë rrugë. Kini kurajë. Dijeni se çdo person që ka një trup, ka fuqi mbi një që nuk ka.² Satanit i është mohuar trupi; kështu që, nëse ndonjëherë ju do të përballeni me tundime, dijeni që ju ua kaloni të gjitha atyre tundimeve nëse do të ushtroni lirinë e zgjedhjes që iu dha Adamit dhe Evës në kopsht dhe që është përcjellë deri te ky brez.

Dhe nëse prisni me shpresë dhe dëshirë që të bëni atë që Zoti do t’ju ngarkonte të bënit – ajo është gjithçka që pritet nga ju. ■

Nga një fjalim i takimit shpirtëror, “Truths Most Worth Knowing” [“Të Vërtetat më të Vlefshme për t’u Njohur”], dhënë më 6 nëntor 2011 në Universitetin “Brigam Jang”. Për tekstin e plotë në anglisht, shkoni tek adresa speeches.byu.edu.

SHËNIME

1. Shih “Come unto Jesus”, *Hymns*, nr. 117.
2. Shih *Mësime të Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2007), f. 221.

KËNDONI HIMNIN TUAJ TË PARAPËLQYER

Unë sapo kisha lindur bijën tonë, Rebekën. Dhimbjet e lindjes kishin qenë të forta dhe unë isha e rraskapitur.

Kur ma vendosën Rebekën në krahë, unë pata ndjenjën e papërmbajtshme që duhet të këndoja himnin tim të parapëlqyer “Fëmi i Per’ndis’ Jam” (*Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 58). Reagimi im fillestar ishte: “Jo, jam tepër e lodhur. Do t’ia këndoj më vonë asaj.” Por atëherë mendimi erdhi sërish. Kështu që, megjithëse isha e rraskapitur, fillova të këndoja strofën e parë. Bashkëshorti dhe nëna ime m’u bashkuan.

Kur e mbaruam këngën, ndjeva një emocion të veçantë në dhomë. Edhe doktoreshës, e cila deri në atë pikë kishte qenë profesionale dhe disi e ftohtë, i rrodhën lot nëpër faqe. Ajo na falënderoi që kënduam një këngë kaq të bukur. Ajo tha se në të gjitha vitet

që kishte ndihmuar në lindjen e foshnjave, kurrë nuk ishte ndier siç ndihej në atë çast.

Unë reflektova për atë përvojë dhe pyeta veten nëse duhet të gjeja një regjistrim të himnit dhe t’ia jepja asaj. Fatkeqësisht, fillova të ngarkohesha me jetën dhe e harrova atë.

Pastaj erdhi dita për kontrollin tim të paslindjes. Ndërsa doktoresha hyri në dhomë, iu ndriçua fytyra dhe më dha një përqafim. Ajo tha se nuk kishte qenë në gjendje ta hiqte nga mendja këngën dhe madje ishte përpjekur të gjente muzikën në internet në mënyrë që të mund t’ia këndonte familjes së saj. Atëherë ndodhi që Fryma e Shenjtë më kujtoi se duhet të kisha marrë një kopje të muzikës për të. I premtova se brenda javës do të kthehesha me muzikën.

Atë natë u luta për ndihmë që të gjeja aranzhimin e këngës që do të ishte më i miri për të. Pasditën tjetër porosita një disk që përmbante këngën. Kur erdhi me postën pas disa ditësh, mezi po prisja t’ia jepja.

Ajo që e emocionuar ta merrte dhe më falënderoi për dhuratën. Ajo më tha se nuk ishte e sigurt për arsyen, por për të ishte shumë e rëndësishme që këtë këngë t’ia tregonte familjes së saj. Ndërsa vazhduam të flisnim, i shpreha asaj jo vetëm dashurinë time për këngën, por edhe dëshminë time për të vërtetat e thjeshta që ajo na mëson.

Kur po kthehesha në shtëpi atë ditë, ndjeva dashurinë e Atit tonë Qiellor për një prej bijave të Tij – doktoreshën time. Ai e njuh dhe e do atë dhe dëshiron që ajo të kuptojë se edhe ajo mund të kthehet të jetojë me Të përsëri. ■
Anxhela Olsen Sentër, Ohajo, SHBA

Kur e mbaruam këngën, doktoreshës, e cila deri në atë pikë kishte qenë profesionale dhe disi e ftohtë, i rrodhën lot nëpër faqe.



Përse Ati Qiellor nuk do të na mbrojë dhe paralajmërojë “gjithmonë”?



PREMTIMI I TIJ: “GJITHMONË”

Ndërsa isha ulur në mbledhjen e sakramentit duke përsiatur lutjen e bukës, fjalët vijonin të përsëriteshin në mendjen time: “Që të mund të kenë gjithmonë Shpirtin e tij me ta” (Moroni 4:3; DeB 20:77).

“Gjithmonë”, thoshte ajo – jo vetëm në periudha të caktuara. Përse, atëherë, disa muaj më parë, bashkëshorti im dhe unë nuk ishim nxitur në lidhje me mënyrën se si ta mbronin djalin tonë 11-vjeçar përpara se të vritej në një aksident automobilistik me biçikletë? Përse Ati Qiellor nuk do të na mbrojë dhe paralajmërojë “gjithmonë”?

Më ishte mësuar në Fillore dhe besoja se Fryma e Shenjtë do të na mbronte. Ai do ta përdorte zërin e vogël, të qetë për të na mbrojtur, udhëhequr dhe paralajmëruar për rrezikun. Ky mendim kishte qenë në mendjen time që kur Beni kishte ndërruar jetë. Më merrte shumë malli për të dhe zemra ime vuante për kuptim dhe paqe.

Ku ishte zëri im paralajmërues? Ku ishte Fryma e Shenjtë? Unë ndieja se

po bënim gjithçka mundeshim për të qenë të drejtë. Ne e paguanim të dhjetën tonë, merrnim pjesë në mbledhjet tona dhe shërbenim kurdoherë që na kërkohet. Ne ishim larg të qenit të përsosur, por i bënim mbrëmjet familjare dhe studimin e shkrimeve të shenjta. Ne po përpiqeshim.

Pak a shumë në këtë kohë, isha ulur në një klasë të Shoqatës së Ndihmës kur mësuesja tregoi historinë e një të afërmeje të ngushtë. Ndërkohë që priste para dritës së kuqe të semaforit, e afërmja kishte ndier një përshtypje të dallueshme për të qëndruar aty ku ishte kur drita ishte bërë e gjelbër. Ajo ia vuri veshin nxitjes dhe pothuaj menjëherë një kamion i madh erdhi me shpejtësi të madhe përmes kryqëzimit, duke shkelur dritën e kuqe. Po të mos e kishte dëgjuar dhe t'i ishte bindur atij zëri, ajo dhe fëmijët e saj mund të ishin lënduar ose vvarë madje.

Kjo histori më preku fuqishëm por, ndërsa isha ulur në karrigen

time në lot duke u përgatitur të ngrihesha dhe të largohesha nga dhoma, një ngushëllim i madh më pushtoi të tërën. Ndjeva paqe që Fryma e Shenjtë kishte qenë vërtet me mua. Në rastin tim, Ai nuk më ishte gjendur pranë si një zë paralajmërimi por si një ngushëllues.

Që nga koha e aksidentit të Benit, unë kisha ndier forcë përtej forcës time dhe isha ngushëlluar nga dashuria e Atit tim Qiellor. Ndonjëherë më mungonte të kuptuarit e arsyes se përse ndodhin disa gjëra, por kurrë nuk kisha dyshuar te dashuria e Tij.

Kam besim se Perëndia i kupton të gjitha gjërat dhe nuk do të më lërë kurrë të pangushëlluar. Fryma e Shenjtë luan shumë role në jetën tonë. Ai mund të na mbrojë, por Ai gjithashtu na udhëheq, na mëson dhe jep kuptueshmëri e bekime të tjera.

Mësova se Ati Qiellor vërtet i mban premtimet e Tij. Ai kishte qenë “gjithmonë” me mua. ■

Robin Kasper, Juta, SHBA



SHPIRTI MË PËSHPËRITI MUA

“Hej, çuna! Kthehuni!” bërtiti një zë thejjet i shqetësuar.

U ktheva dhe vura re dy djem, rreth pesë dhe shtatë vjeç, duke vrhapuar përmes vendparkimit të dyqanit me lot që u rridhnin nëpër faqe. Shitësi duke i merakosur ndërsa u thërriste atyre.

Teksa po kthehesha për nga makina ime, Shpirti pëshpëriti: “Mund të jesh e dobishme këtu”. Pëshpëritja ishte e qetë, sidoqoftë kaq e qartë sa një çast më vonë po vrapoja përmes vendparkimit drejt djemve.

E gjeta më të madhin duke qëndruar pranë një furgoni të vogël ngjyrë kafe. U qasa dhe u gjunjëzova krahtij.

“Çkemi. Emri im është Kristina. A je mirë?”

Pas fjalëve të mia, ai qau edhe më fort dhe e mbuloi fytyrën me kraht. Shitësi dhe djali tjetër na u bashkuan.

“Mendoj që flasin vetëm frëngjisht”, më tha shitësi. “Ne sapo i gjetëm duke vrhapuar nëpër dyqan, të humbur.”

E përsërita prezantimin tim me fëmijët në frëngjisht. Gjuha frënge

ishte gjuha ime amtare, por nuk e kisha folur që kur isha birësuar në një familje anglishtfolëse kur isha fëmijë e vogël. Zakonisht, frëngjishtja ime është e dobët. Megjithatë, në atë çast, nuk isha as e ngathët, as e ngadaltë në të folur. Fjalët ishin të qarta në mendjen time dhe zëri im ndërsa ngushëlloja djemtë.

Mes dënësash, djali më i madh shpjegoi me një lumë të vrullshëm fjalësh se ai dhe i vëllai nuk mund t’i gjenin prindërit e tyre askund në dyqan dhe kishin vrhapuar jashtë duke i kërkuar. Ndërsa e dëgjoja, u bëra turbull e vetëdijshme për atë se sa e mrekullueshme ishte që jo vetëm po flisja me lehtësi frëngjisht, por po i kuptoja e ngushëlloja pa vështirësi dy fëmijët e trembur.

“Kanë humbur prindërit dhe dëshirojnë t’i presin te makina e tyre”, i thashë shitësit. Djali i vogël më tha emrat e prindërve të tij, të cilat ia dhashë shitësit, në mënyrë që ai të mund t’i lokalizonte me altoparlantnin e dyqanit.

Vura re dy djem, rreth pesë dhe shtatë vjeç, duke vrhapuar përmes vendparkimit të dyqanit me lot që u rridhnin nëpër faqe.

Pak minuta më vonë, djali pikasi të atin duke dalë nga dyqani dhe vrapoiti takonte.

Ndërsa e ndoqa djalin për tek i ati, zbulova se nuk mundesha më as të thosha mirupafshim në frëngjisht. U përpoqa më kot të thosha ndonjë gjë që djemtë të mund ta kuptonin, por nuk mund të thosha asgjë më shumë sesa pak fjalë aty-këtu. Më në fund, iu ktheva anglishtes, duke i thënë djalit: “Mirupafshim. Ishte kënaqësi që u takuam.”

Teksa i lashë djemtë me prindërit e tyre, unë isha plot mirënjohje. Ati Qiellor kishte vepruar nëpërmjet meje për të lehtësuar dy prej të vegjëlve të Tij. U ndjeva e përulur që Zoti mundi të lartësonte aftësitë e mia të kufizuara për të përmbushur qëllimet e Tij. Isha mirënjohëse që dëshmovava atë që mund të ndodhë ndërsa ia përkushtojmë veten Atij kur thirremi, edhe në situatat më të pagjasa. ■

Kristina Albreht Erhart,
Uashington, SHBA

NE DUHET TË SHKOJMË NË TEMPULL TANI!

Një mëngjes të diele, një anëtare e pagëzuar rishtas iu paraqiti lagjes. Emri i saj ishte Lidia. Ajo na i fitoi zemrat aty për aty.

Lidia ishte e thyer në moshë dhe e verbër nga vitet e luftës me diabetin. Ajo shpejt filloi t'i njihte anëtarët e lagjes nga zërat e tyre dhe mënyra si i hidhnin hapat. Ajo do të thoshte emrat tanë e do të na jepte dorën dhe ne kurrë nuk hidhnim fjalë te fakti që ajo ishte e verbër.

Pas vitit të detyrueshëm të pritjes, Lidia u takua me peshkopin dhe presidentin e kungjit për të marrë rekomandimin e saj të tempullit. Një të diel, në Shoqatën e Ndhmës, ajo më tërhoqi nga vetja dhe thirri gëzueshëm: “Presidenti i kungjit më tha se duhet të shkoj në tempull sa më shpejt të jetë e mundur. A do të më çosh?”

Ishte java e parë e dhjetorit – periudhë e ngarkuar për të gjithë ne. U përpoqa të jepja shfaqësime të zakonshme dhe thashë: “A nuk mund të presim deri në janar?”

“Presidenti i kungjit më tha se duhet të shkoj në tempull sa më shpejt të jetë e mundur”, tha Lidia. “A do të më çosh?”

“Jo, duhet të shkojmë tani!”

Një grup grash nga lagjia shkonin në tempull çdo muaj, kështu që iu drejtova atyre që ta bënin udhëtimin me Lidian. Edhe ato ishin shumë të zëna. Por Lidia, me lot në sy, përsëri na tha që presidenti i kungjit i kishte thënë që të shkonte sa më shpejt të ishte e mundur.

Në përputhje me atë që tha, ne të gjitha ramë dakord ta bënim udhëtimin prej 150 miljesh (241 kilometrash) javën vijuese. Rrugës, ne e mbushëm furgonin me muhabetin dhe miqësinë e tetë grave. Lidia u gëzua tej mase nga përvoja e saj e tempullit dhe beki mi i marrjes së indaumentit të saj.

Javën e parë të janarit, gjendja e Lidias u përkeqësua dhe ajo u fut në spital për trajtim urgjence. Një javë më pas ajo u largua nga kjo jetë. Por

Lidia iku me bekimet e përjetshme që i kishte marrë në tempull vetëm pak javë më parë.

Më vonë i rrëfeva presidentit të kungjit historinë e udhëtimit tonë dhe i tregova se sa mbresa më kishte lënë që ai ishte ndier i nxitur t'i thoshte Lidias që duhej të shkonte menjëherë në tempull.

“Në të vërtetë nuk kisha parasysht që duhej të shkonte aty për aty”, u përgjigj ai. “Përherë u them mbajtësve të rinj të rekomandimeve që të shkojnë në tempull shpejt. Shpirti i foli Lidias, jo mua!”

Lidia na mësoi të gjithave që t'ia vinim veshin Shpirtit dhe të vepronim menjëherë në përputhje me të. Jam mirënjohëse për kujtuesin e saj që t'ia vëmë veshin zërit të vogël, të qetë. ■

Meri Houmz Euen, Kaliforni, SHBA





Nga Plaku
Entoni D. Perkins,
i Të Shtatëdhjetëve

SHKO PËRPARA ME Besim

Ju të rinj në moshë madhore, tani jeni duke jetuar në atë që është quajtur “Dekada e Vendimit”. Ju jeni duke bërë shumë prej zgjedhjeve më të rëndësishme të jetës suaj, të tilla si “vajtja në tempull, të shërbyerit në një mision, shkollimi, përzgjedhja e një profesioni si dhe zgjedhja e një shoku/shoqeje dhe të qenit i vulosur për kohën dhe për gjithë përjetësinë në tempullin e shenjtë”¹.

U flas veçanërisht atyre që janë duke luftuar me një ose më shumë prej këtyre vendimeve të rëndësishme – disa pothuaj të paralizuar nga frika e marrjes së vendimit të gabuar apo që kanë nevojë për përforsim që të mbeten vetëbesues për një vendim të marrë më parë.

Katër mësimet të vendimmarrjes së frymëzuar nga Nefi, nëse zbatohen, mund t’i zvogëlojnë pasiguritë tuaja dhe të rritin vetëbesimin tuaj për të ecur përpara.

1. Bindjuni Urdhërimeve

Vargu i fundit i analit të shenjtë të Nefit përmbledh jetën e tij: “Pasi kësh-tu më ka urdhëruar Zoti dhe unë duhet të bindem” (2 Nefi 33:15).

Besimi i Nefit te Shpëtimtari dhe dashuria për Të tregohet me anë të shembullit në bindjen e tij ndaj urdhërimeve të Perëndisë. Ai u lut (shih 1 Nefi 2:16). Ai i lexoi shkrimet e shenjta (shih 1 Nefi 22:1). Ai kërkoi dhe ndoqi udhëzimin nga një profet i gjallë (shih 1 Nefi 16:23–24). Një bindje e tillë e lejoi Frymën e Shenjtë që ta shoqëronte fuqishëm Nefin, gjatë gjithë jetës së tij, dhe i dha zbulësë vetjake të vazhdueshme.

Edhe ju duhet të qëndroni afër me Zotin duke mbajtur urdhërimet e Perëndisë. Unë dëshmoj se bindja e vazhdueshme ndaj gjërave të vogla si leximi i shkrimeve të shenjta, lutja e përditshme, pjesëmarrja në mbledhjet e Kishës, mbajtja vesh e këshillës

Katër mësimet të vendimmarrjes së frymëzuar nga Nefi, mund t’i zvogëlojnë pasiguritë tuaja dhe të rritin vetëbesimin tuaj për të ecur përpara.

së profetëve të gjallë dhe shërbimi ndaj të tjerëve do t’ju kualifikojnë për Shpirtin – dhe zbulësën që ai sjell.

Përsosmëria nuk është një kusht paraprak për zbulësë vetjake. Kushti paraprak është pendimi i përditshëm (shih Romakëve 3:23). Nëse pendimi



Besimi i Nefit te Shpëtimtari dhe dashuria për Të tregohet me anë të shembullit në bindjen e tij ndaj urdhërimeve të Perëndisë.

juaj është i sinqertë dhe i plotë (shih DeB 58:42–43), fuqia pastruese e Shlyerjes do të sjellë Shpirtin për t’ju udhëhequr në vendimet me peshë të jetës.

2. Ecni Përpara me Besim

Vëreni veten tuaj në situatën e Nefit. Babai ju thotë se Zoti e ka urdhëruar familjen tuaj ta lërë pasurinë dhe të niset për në vendin e shkretët. A nuk do të donit të dinit rreth udhëtimit dhe vendmbërritjes suaj?

Hamendësoj se Nefi do të kishte qenë shumë i lumtur sikur Zoti t’i kishte zbuluar qartësisht të ardhmen

PËR TË ZVOGËLUAR PASIGURITË DHE PËR TË RRITUR VETËBESIMIN

1. Bindjuni urdhërimeve.
2. Ecni përpara me besim.
3. Jetoni në të tashmen.
4. Mbështetuni te forca e të tjerëve.

e tij. Por nuk është kjo mënyra se si punoi Perëndia me Nefin dhe nuk është mënyra se si Ai do të punojë me ju.

Ndërsa familja e Nefit udhëtoi përmes vendit të shkretët, atij i erdhën udhëzimet vetëm “nga koha në kohë” (1 Nefi 16:29; 18:1). Të parit e udhëtimit të jetës së tij me siguri që në fillim, nuk do t’i kishte siguruar atij përvojat shpirt-tendosëse dhe besim-formuese që e ndihmuan të bëhet një njeri më shumë si Krishti.

Nëse po prisni që Perëndia t’ju zbulojë se çfarë dege akademike të ndiqni, me kë të martoheni, çfarë pune të pranoni, ku të jetoni, nëse duhet të bëni studime pasuniversitare dhe sa fëmijë të keni, ju kurrë nuk do ta lini apartamentin tuaj. Ju dëshmoj se zbulesa vetjake do të vijë vetëm nga “koha në kohë”.

Ati ynë Qiellor dëshiron që ne të rritemi dhe kjo përfshin zhvillimin e aftësisë sonë për të peshuar faktet, për të dhënë gjykime dhe për të marrë vendime. Por Ai gjithashtu na fton t’ia sjellim vendimet tona Atij në lutje (shih DeB 9:7–9). Plaku Riçard G.

Skot, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim se përgjigjet tona vijnë “në një nga *tri* mënyrat”².

Siguria Pohuese

“Së pari”, tha Plaku Skot, “ju mund të ndieni paqe, qetësi dhe siguri që konfirmojnë se vendimi juaj është i drejtë.”³ Unë dhe gruaja ime, Kristi, kemi zbuluar se siguria për vendimet kritike që ndikojnë në jetë, mund të komunikohet nëpërmjet shkrimeve të shenjta, shpesh pas adhurimit në tempull.

Për shembull, pas shumë përsiatjesh dhe lutjesh, ne vendosëm ta braktisnim shtëpinë e re të ëndrrave tona në Teksas, të prananim një transferim pune dhe të shpërnguleshim me gjashtë fëmijët tanë të vegjël në Pekin të Kinës. Por ne dëshironim në mënyrë të dëshpëruar një pohim shpirtëror për një shpërngulje të tillë shumë të rëndësishme. Siguria hyjnore na erdhi – në tempull – ndërsa lexuam këto fjalë në Doktrina e Besëlidhje: “Është vullneti im që ti . . . [të] mos qëndro[sh] shumë ditë në këtë vend; . . . mos mendo për pasurinë tënde. Shko në tokat e lindjes” (DeB 66:5–7).

Zëri i Jezu Krishtit në shkrimet e shenjta, i shoqëruar me ndjenja të fuqishme nga Fryma e Shenjtë, pohoi se vendimi ynë për t’u shpërngulur në Kinë, ishte i drejtë.

Ndjenjë e Turbulluar

Mënyra e dytë se si Ati Qiellor u përgjigjet lutjeve është përmes një “ndjenje të turbulluar, mpirje të mendimit, që tregojnë se zgjedhja juaj është e gabuar”⁴.

Pas misionit tim në Taivan, mendova se ligji ndërkombëtar do të ishte





Nefi do të kishte qenë shumë i lumtur sikur Zoti t'i kishte zbuluar qartësisht të ardhmen e tij. Por nuk është kjo mënyra se si punoi Perëndia me Nefin dhe nuk është mënyra se si Ai do të punojë me ju.

Dymbëdhjetë Apostujve, “ne do të marrim nxitje të Shpirtit kur të kemi bërë gjithçka që mundemi, kur të jemi jashtë në diell duke punuar në vend që të ulemi në hije duke u lutur për udhërrëfim për hapin e parë që duhet të marrim”⁶.

Ashtu si me Nefin, Shpirti në kohën e duhur do t’ju pohojë apo paralajmërojë për udhën e zgjedhur.

3. Jetoni në të Tashmen

Zotimi i Nefit në udhëtimin për në tokën e premtuar, qëndron në një kundërshtim të fortë me atë të vëllezërve të tij, Lamanit dhe Lemuelit. Ata e morën vendimin për të shkuar, por zemra e tyre nuk e la kurrë Jerusalemin. Nefi rregullonte harkun e tij të thyer që të gjuante për ushqim dhe gërmonte minerale për të ndërtuar një anije, ndërsa vëllezërit e tij dukej se rrinin kot në një çadër.

Sot, bota ka shumë Lamanë dhe Lemuelë. Por Zoti ka nevojë për burra dhe gra që zotohen, ashtu si Nefi. Ju do të përjetoni përparim më të madh në jetë, kur zotoheni plotësisht ndaj vendimeve tuaja dhe përpiqeni të shkëlqeni në rrethanat tuaja të tanishme, edhe kur keni plane për të ardhmen.

Nefi ilustron me anë të shembullit këshillën e mençur të Presidentit Tomas S. Monson: “Ëndërrimi me sy hapur i së kaluarës dhe dëshira e fortë për të ardhmen mund të japin qetësim, por nuk do ta zëvendësojnë të jetuarin në të tashmen. Kjo është dita e mundësisë tonë dhe ne duhet ta kapim atë.”⁷

një zgjedhje e mirë karriere. Ndërsa unë dhe Kristi e morëm në shqyrtim atë të ardhme të mundshme, ne kuptuam se shtriheshin përpara pesë vite më shumë të një arsimit të kushtueshëm.

Ekonomia e Shteteve të Bashkuara ishte në një rënie të thellë dhe fondet tona ishin të kufizuara, prandaj arsyetua se bashkimi me Forcat Ajrore ROTC [Korpusi i Trajnimit të Oficerëve të Rezervës] do të ishte një zgjedhje e mençur për të paguar shkollimin tim. Por kur bëra testimet e kërkuara dhe plotësova dokumentet, ne thjesht nuk ndiheshim rehat me bërjen e këtij zotimi. Nuk patëm asnjë mpirje mendimi apo ndjenja të errëta – vetëm një mungesë paqeje.

Ai vendim financiar në dukje i palogjikshëm ishte i frymëzuar, pjesërisht, sepse unë do të kisha qenë një avokat jo i mirë.

Mirëbesimi Hyjnor

Perëndia u përgjigjet lutjeve në një mënyrë të tretë: asnjë përgjigje. “Kur jetoni denjësisht dhe zgjedhja juaj është në përputhje me mësimet e Shpëtimtarit dhe keni nevojë të veproni”, tha Plaku Skot, “veproni me mirëbesim.”⁵

Orvatja përfundimtare e Nefit për të marrë fletët prej tunxhi ilustron mënyrën se si ne duhet të veprojmë me mirëbesim hyjnor. Ai shënoi:

“Dhe unë isha i udhëhequr nga Shpirti, duke mos ditur më parë gjërat që unë duhet të bëja.

Megjithatë, vazhdova të ecja”
(1 Nefi 4:6–7).

Çastet do të vijnë gjatë dekadës suaj të vendimit, kur ju nuk mund ta shtyni më gjatë dhe duhet të veproni. Kam mësuar se, siç ka dhënë mësim Plaku Dallin H. Ouks, i Kuorumit të

4. Mbështetuni te Forca e të Tjerëve

Edhe pasi ta kemi kërkuar Shpirtin, të kemi shkuar përpara me vendimin tonë dhe të jemi plotësisht të zotuar ndaj tij, prapëseprapë mund të ngrihen dyshime dhe të na bëjnë ta vëmë në pikëpyetje vendimin tonë. Në rrethana të tilla, një pjesëtar i besuar i familjes apo mik mund të japë këshillë dhe forcë për të qëndruar në shteg. Unë sugjeroj që, përgjatë udhëtimit të tij, nusja e Nefit u bë spiranca e tij e besuar.

Një vlerësim për bashkëshorten e Nefit më erdhi ndërsa po vizitoja



Një pjesëtar i besuar i familjes apo një mik mund të japë këshillë dhe forcë për të qëndruar në shteg.



Muzeun e Historisë së Kishës. Atje u mbërtheva nga një pikturë e Nefit, i lidhur në direkun e anijes, i lagur deri në lëkurë në një stuhi të furishme.⁸

Në krah të Nefit ishin bashkëshortja dhe një nga fëmijët e tij. Ajo po përjetonte të njëjtën stuhi dhe sfida si edhe Nefi, por sytë e saj ishin sfidues dhe krahët e saj të fortë ishin mbështjellë në mënyrë mbrojtëse rreth shpatullave të tij. Në atë çast e kuptova se edhe unë isha bekuar të kisha një bashkëshorte besnike që më ofron forcë në kohët e sprovësime. Shpresova që të isha një forcë e ngjashme për të.

Vëllezër, ruajtja dhe përmirësimi i forcës shpirtërore që zhvilluat (apo ende do ta zhvilloni) si misionar ose në shërbime të tjera të drejta, është vlera më e mirë për t'u bërë një bashkëshort dhe baba i dëshiruar. Motra, ndjeshmëria shpirtërore, besimi dhe guximi për të ndjekur Jezu Krishtin

janë midis cilësive më të mira si bashkëshorte dhe nënë.

Unë ju ftoj të bëheni lloji i personit ku bashkëshorti/ja aktual/e apo i/e ardhshëm/me mund të mbështetet për këshillë të mençur dhe forcë. Një burrë i virtytshëm dhe një grua e denjë, të vulosur në tempull për kohën dhe gjithë përjetësinë, mund të bëjnë gjëra të vështira si partnerë të barabartë.

Unë ju premtoj se, nëse do t'i zbatoni mësimet e mësuara nga Nefi dhe profetët e sotëm rreth marrjes së vendimeve, ju do të udhëhiqeni me zbulësë vetjake “nga koha në kohë”. Ndërsa përparoni përmes dekadës suaj të vendimit, paçi besimin për të thënë, ashtu si tha Nefi:

“Dhe unë isha i udhëhequr nga Shpirti, duke mos ditur më parë gjërat që unë duhet të bëja.

Megjithatë, vazhdova të ecja”
(1 Nefi 4:6–7). ■

Nga një fjalim i takimit shpirtëror, “Nevertheless I Went Forth” [“Megjithatë, Vazhdova të Ecja”], dhënë më 4 shkurt 2014 në Universitetin “Brigam Jang”. Për fjalimin e plotë në anglisht, shkoni tek adresa speeches.byu.edu.

SHËNIME

1. Robert D. Hejls, “Priftërisë Aarone: Përgatituni për Dekadën e Vendimit”, *Liahona*, maj 2007, f. 48; Konferenca e Përgjithshme, prill 2007, f. 58.
2. Riçard G. Skot, “Përdorimi i Dhuratës Hyjnore të Lutjes”, *Liahona*, maj 2007, f. 10; Konferenca e Përgjithshme, prill 2007, f. 7; theksimi në origjinal.
3. Riçard G. Skot, “Përdorimi i Dhuratës Hyjnore të Lutjes”, f. 7.
4. Riçard G. Skot, “Përdorimi i Dhuratës Hyjnore të Lutjes”, f. 7.
5. Riçard G. Skot, “Përdorimi i Dhuratës Hyjnore të Lutjes”, f. 7.
6. Dallin H. Oaks, “In His Own Time, in His Own Way”, *Liahona*, gusht 2013, f. 26.
7. Thomas S. Monson, “In Search of Treasure”, *Liahona*, maj 2003, f. 20.
8. Shih *Helpmeet*, nga K. Sean Sullivan, në “The Book of Mormon: A Worldwide View”, *Liahona*, dhjetor 2000, f. 37.

KËRKOJENI ATË

“Pse e kërkoni të gjallin midis të vdekurve?
Ai nuk është këtu, por është ringjallur.”

(Lluka 24:5-6.)



PËR SHKAK TË JOZEFIT

Zbuloni gjashtë mënyra se si jeta juaj është (ose mund të jetë) ndryshe për shkak të Profetit Jozef Smith.

Nga Ted Barns,

Departamenti i Priftërisë


Jozef Smithi vdiq mbi 170 vjet më parë. Ai jetoi vetëm 38 vjet, duke e kaluar pjesën më të madhe të asaj kohe në vende kaq të errëta, saqë ju ndoshta nuk do t'i gjeni askund, por vetëm në hartat më të detajuara. Dhe ndoshta ju keni dijeni për shumë gjëra që ai bëri në jetën e tij. Por a keni menduar rreth mënyrës se si ndikojnë ato te ju personalisht? Ndërkohë që ato mënyra janë të shumta për t'u numëruar, ju mund të filloni me këto të gjashta.

Për Shkak të Jozef Smithit:

1. Ju kuptoni se kush janë me të vërtetë Perëndia dhe Jezu Krishti.

Edhe sikur të mos ishte për Jozef Smithin, ju ende mund të besoni në Perëndinë, Atin, dhe në Jezu Krishtin. Ju mund të kishit dëshmitë e Biblës. Por mendoni sa më i thellë dhe më i pasur është të kuptuarit tuaj për shkak të asaj që rivendosi Jozef Smithi – dëshmitë e forta, pohuese të Librit të Mormonit, Doktrinës e Besëlidhjeve dhe Perlës me Vlerë të Madhe. Për shembull, ju dini diçka që shumica e botës nuk e di: se Shpëtimtari i ngritur u shfaq në kontinentet amerikane – duke vërtetuar, me fjalët e Tij, se Ai nuk është vetëm “Perëndia i Izraelit, [por gjithashtu] Perëndia i tërë tokës” (3 Nefi 11:14).

Mendoni për mënyrën se si është forcuar dëshmia juaj për Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin nga dëshmitë e fuqishme të profetëve si Nefi, Alma dhe Moroni – për të mos përmendur vetë Jozef Smithin, i cili deklaroi: “Ai jeton! Sepse ne e pamë atë, madje në të djathtën e Perëndisë” (DeB 76:22–23). Në një kohë kur besimi te Perëndia dhe Jezu Krishti sfidohet dhe shpesh braktiset, çfarë bekimi është të kesh këtë dritë tjetër!





3. Familja juaj mund të jetë e përjetshme.

Përse kaq shumë njerëz janë të pëshjtelluar rreth rëndësisë së martesës dhe familjes? Ndoshta sepse ata nuk e njohin doktrinën, të rivendosur nëpërmjet Jozef Smithit, se martesa dhe familja shugurohen nga Perëndia dhe kanë për qëllim të jenë të përjetshme (shih DeB 49:15; 132:7). Këto nuk janë thjesht tradita të bëra nga njeriu, për të cilat shoqëria jonë nuk ka më nevojë – ato janë pjesë e rendit të përjetshëm të qiellit. Dhe në saje të çelësave të priftërisë dhe ordinancave të tempullit që u rivendosën nëpërmjet Jozef Smithit, familja juaj e përjetshme mund të fillojë këtu në tokë.

2. Ju e dini se jeni një fëmijë i Perëndisë – dhe kështu është çdokush tjetër.

Ndoshta e vërteta më e rëndësishme që Jozef Smithi rivendosi, ishte e vërteta rreth marrëdhënies sonë me Perëndinë.¹ Ai është vërtet Ati ynë. A keni ndaluar ndonjëherë për të menduar rreth gjërave që rrjedhin nga ky fakt? Ai ndryshon mënyrën se si ju e shihni veten tuaj: pavarësisht nga ajo që bota mendon për ju, ju e dini se jeni një fëmijë i dashur i Perëndisë, me cilësitë e Tij brenda jush. Ai ndryshon mënyrën se si ju i shihni të tjerët: papritur çdo njeri – *çdo njeri* – është vëllai ose motra juaj. Ai ndryshon mënyrën se si ju e shihni vetë jetën: të gjitha gëzimet dhe sprovat e saj janë pjesë e planit të Atit Qiejllor për t'ju ndihmuar të bëheni si Ai. Jo keq për diçka që ju e këndonin në Filllore!²



4. Ju keni qasje ndaj priftërisë dhe bekimeve të saj.

Për shkak se Perëndia e rivendosi priftërinë e Tij nëpërmjet Jozef Smithit, ju mund të pagëzoheni dhe të merrni dhuratën e Frymës së Shenjtë. Ju mund të kërkonti bekimet e priftërisë për shërim, ngushëllim dhe udhërrëfim. Ju mund të bëni besëlidhje të shenjta që ju lidhin me Perëndinë. Dhe ju mund t'i përtërin besëlidhjet tuaja çdo javë kur merrni sakramentin. Nëpërmjet ordinancave të priftërisë, fuqia e Perëndisë hyn në jetën tuaj (shih DeB 84:20–21). Asnjë nga këto nuk do të ishte e mundur pa punën e kryer nëpërmjet Jozef Smithit.



MAYAS: DËSHIRAT E ZEMRËS SIME (VEGIMI I PARË), NGA WALTER RANE; LART: TEMPULLI I ASUNCIÓNIT NE PARAGUAI

5. Ju jeni i lirë nga varësia ndaj substancave të dëmshme.

Ose të paktën, ju mund të jeni të lirë nëse i bindeni zbulesës që mori Jozefi në vitin 1833 – kohë përpara se duhani të provohej klinikisht që shkaktonte kancer mushkërie dhe alkooli të kishte lidhje me sëmundje të mëlçisë. Kur ju keni një profet që ju zbulon urtësinë e Perëndisë, përse duhet të prisni për urtësinë e botës që të arrini tek i njëjti përfundim? Fjala e Urtësisë tregon se Perëndia nuk kujdeset vetëm për shpirtin tonë, por edhe për trupin tonë (shih DeB 89). Mbi të gjitha, siç e treguan zbulesat dhënë Jozef Smithit, të paturit e një trupi na bën më shumë – jo më pak – si Ati ynë në Qiell, i cili gjithashtu ka një trup prej mishi e kockash (shih DeB 130:22).

HYNI NË BASHKËBISEDIM

GJËRA QË TË PËRSIATNI PËR TË DIELËN

- Si mund ta forcoj dëshminë time për Profetin Jozef Smith?
- Si mund ta tregoj më mirë mirënjohjen për profetin e gjallë, nëpërmjet fjalëve dhe veprimeve të mia?

GJËRA QË MUND TË BËNI

- Në Kishë, me familjen dhe miqtë tuaj ose në mjetet mediatike shoqërore, tregoni mënyrën se si Profeti Jozef Smith ka ndikuar në jetën tuaj.
- Ashtu siç bëri Jozef Smithi, pyetjet tuaja bëjani Atit Qiellor. Gjenero kohë për t'u gjunjëzuar dhe për t'i kërkuar Atij udhërrëfim. Mandej, prisni dhe u vini veshin ideve ose ndjenjave. Shënojini mendimet vetjake në ditarin tuaj.
- Lexoni bisedën "Jozef Smithi" nga Plaku Nil L. Andersen, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, nga konferenca e përgjithshme e nëntorit 2014. Bëni një plan për t'i zbatuar të dy idetë që jep ai për ndërtimin dhe ndarjen e dëshmisë suaj për Jozef Smithin.



6. Ju mund ta dini të vërtetën për veten tuaj nëpërmjet Frymës së Shenjtë.

Kur Jozefi i ri vuri këmbë në Korijen e Shenjtë në 1820-ën, bindja e përgjithshme midis shumë kishave ishte se zbulesa ishte një gjë e së kaluarës. Vegimi i Parë i Jozefit provoi se kjo ishte e gabuar. Qiejt janë të hapur – dhe jo vetëm për profetët.

Çdokush me një pyetje mund të marrë një përgjigje përmes kërimit të përlur, të zellshëm (shih DeB 42:61; 88:63). Për shembull, ju mund të zbuloni për veten tuaj se Jozef Smithi ishte profet i Perëndisë, në të njëjtën mënyrë si e zbuloi Jozefi: duke i kërkuar Vetë Perëndisë.

Kjo listë është vetëm fillimi. Çfarë do të shtonit? Si është jeta juaj ndryshe për shkak të Jozef Smithit? ■

SHËNIME

1. Shih *Mësime të Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2007), f. 39–46.
2. Shih "Fëmi i Perëndisë Jam", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 58.

“Profeti i gjallë është më i rëndësishëm për ne sesa një profet i vdekur...”

... Zbulesa e Perëndisë dhënë Adamit nuk e udhëzoi Noeun se si të ndërtonte arkën. Noeut i nevojitej zbulesa e tij vetjake. Si rrjedhim, profeti më i rëndësishëm, për aq sa më intereson mua dhe juve, është ai që jeton në kohën dhe epokën tonë, të cilit Zoti po i zbulon tani vullnetin e Tij për ne. Prandaj, leximi më i rëndësishëm që mund të bëjmë është leximi i cilësdo prej fjalëve të profetit ... të përfshira çdo muaj në revistat e Kishës. Urdhrat tona për marshim për secilin gjash-tëmujor gjenden në fjalimet e konferencës së përgjithshme, që shtypen në revistën [Liahona]...

Jini vigjilentë ndaj atyre që do t'i ngrenë profetët e vdekur kundrejt profetëve të gjallë, sepse **profetët e gjallë gjithmonë marrin përparësi.” ■**

Nga Presidenti Ezra Taft Benson (1899–1994), “Fourteen Fundamentals in Following the Prophet” [“Katërmëdhjetë Pika Themelore në Ndjekjen e Profetit”], (takim shpirtëror në Universitetin “Brigam Jung”, 26 shkurt 1980), 2, speeches.byu.edu.

Jepni Idetë Tuaja

Çfarë do të thotë për ju të mbështetni profetët e gjallë? Tregojani idetë tuaja familjes dhe miqve ose në mjetet shoqërore të komunikimit.



SHEMBULLI SHPËTIMTARIT PËR *Bindjen*

Shembulli i Tij cakton modelin për të gjithë ne që ta ndjekim.

“**N**ga të gjitha mësimet që marrim nga jeta e Shpëtimtarit, asnjëri nuk është më i qartë dhe më i fuqishëm se mësimi i bindjes”, dha mësim Plaku Robert D. Hejls, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, në konferencën e përgjithshme të prillit 2014. Shembulli i Shpëtimtarit na mëson jo vetëm arsyen *përse* bindja ndaj Atit Qiellor është e rëndësishme, por edhe mënyrën se *si* ne mund të jemi të bindur. Ndërsa shqyrtoni shembujt vijues nga shërbesa e Tij, mendoni për mënyrën se si ata mund të përcaktojnë një shteg për ju që ta ndiqni në jetën tuaj.

“NUK KËRKOJ
VULLNETIN TIM,
POR VULLNETIN
E ATIT QË MË
KA DËRGUAR.”

(Gjoni 5:30; shih edhe
Gjoni 6:38; 8:28-29; 14:31)



ÇFARË MUND TË BËNI JU?

Plaku Hejls tha: “Jezusi na mësoi të bindemi me fjalë të thjeshta, që janë të lehta për t’u kuptuar: ‘Nëse më doni, zbatoni urdhërimet e mia’ [Gjoni 14:15] dhe ‘Eja e më ndiq’ [Lluka 18:22]”.

Çfarë do të bëni sot që të jeni më i bindur?



2

1. Ndonëse Jezusi ishte pa mëkat, Ai iu nënshtrua pagëzimit për të “përmbush[ur] çdo drejtësi” (Mateu 3:13-17; shih edhe 2 Nefi 31:4-7; Gjoni 3:5).

2. Në moshën 12 vjeç, kur Jozefi dhe Maria e gjetën Jezusin duke dhënë mësim në tempull, Ai iu “bind atyre” dhe me bindje u kthye në shtëpi me ta (shih Lluka 2:42-51).

3. Megjithëse u lut nëse kupa mund të largohej prej Tij, Ai iu nënshtrua vuajtjes në Kopshtin e Gjetsemanit (shih Mateu 26:36-44; Lluka 22:39-54).

4. Ai e mbante Shabatin dhe merre pjesë në shërbimet në sinagogë (shih Lluka 4:16-44).


5. Jezusi pranoi që të gjykohej nga njerëzit që të bënte të ndodhte vepra dhe lavdia e Atit (shih Isaia 53:7; Mateu 26:53; Moisiu 1:39).

6. Ai e përfundoi punën e Tij duke lejuar njerëz të ligj ta kryqëzonin Atë (shih Mateu 27:35; Gjoni 10:17-18; Galatasve 1:3-5).



3

NGAQË SHPËTIMTARI ISHTE I BINDUR



“Për shkak se Shpëtimtari ynë që e i bindur, Ai shleu për mëkatet tona, duke e bërë të mundur ringjalljen tonë e duke përgatitur udhën për ne që të kthehemi tek Ati ynë Qiellor, i cili e dinte se ne do të bënim gabime teksa mësonim bindjen në vdekshmëri. Kur bindemi, ne e pranojmë sakrificën e Tij, pasi ne besojmë se nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit, i gjithë njerëzimi mund të shpëtohet, me anë të bindjes ndaj ligjeve dhe ordinancave të Ungjillit.”

Plaku Robert D. Hejls, i Kuorimit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Nëse Më Doni, Zbatoni Urdhërimet e Mia”, *Liahona*, maj 2014, f. 35.



1



6



7

RINIA



4



8



9

“GJATË GJITHË SHËRBESES [SË KRISHTIT], ‘AI VUAJTI TUNDIME POR [ATYRE] NUK UA VURI VESHIN’

[DeB 20:22].”

- Plaku Robert D. Hejls

7. Gjithnjë i bindur ndaj Atit të Tij, Jezusi shkoi në botën e shpirtave dhe organizoi punën misionare atje (shih 1 Pjetër 3:18-20; 4:6).

8. Jezusi u tundua nga Satani, por nuk u dorëzua (shih Mateu 4:1-11; DeB 20:22).

9. Ai vazhdon të bëjë vullnetin e Atit dhe të drejtojë Kishën (shih Joseph Smith - Historia 1:16-17; DeB 19:2, 24).



5



ZJARRFIKËSIT DHE ARMATIMI I PERËNDISË

Ishte një ditë e qetë në punën time si zjarrfikës vullnetar, kështu që vendosa të lexoja Librin e Mormonit. Kur një nga shokët e punës më pa duke lexuar, ai më pyeti nëse e dija mënyrën se si mund të veshim armatimin e Perëndisë në kohët e sotme. Ndërsa po flisnim, u dha sinjali i alarmit. Kishte rënë zjarr në një dyqan aty afër.

Shpejt veshëm pajimet tona të zjarrfikësit dhe shkua drejt e atje. Flakët ishin vigane dhe, kur iu qasëm dyqanit, diçka shpërtheu drejt nesh. Na përfshinë flakët. Shpërthimi më çorientoi mua dhe shokun tim të punës për pak sekonda. Por falë pajisjes sonë dhe veshjes sonë mbrojtëse, nuk pësua asnjë dëm.

Kur u kthëm në stacionin zjarrfikës pasi fikëm zjarrin, e pyeta shokun tim të punës nëse i kujtohej pyetja e tij për armatimin e Perëndisë. Ai tha se i kujtohej dhe unë shpjegova se armatimi i Perëndisë është njësoj si pajimet tona mbrojtëse të zjarrfikësit. Ne duhet t'i mbajmë gjithnjë veshur në mënyrë që të mund t'u bëjmë ballë sulmeve të kundërshtarit. Nëse i mbajmë urdhërimet, ne do të bekohemi me fuqinë mbrojtëse të armatimit të Perëndisë dhe Fryma e Shenjtë do të jetë udhërrëfyese ynë. ■

Fernando de la Rosa Marron, Meksikë



SHKRIMI IM I SHENJTË I PARAPËLQYER

1 Samuelit 16:7. “ZOTI NUK SHIKON SI SHIKON NJERIU, NJERIU SHIKON PAMJEN, KURSE ZOTI SHIKON ZEMRËN.”

Përpara se të bashkohesha me Kishën, përherë e kisha parë veten si një person të zakonshëm me aftësi të zakonshme. Ndieja se nuk kisha asgjë me vlerë për të dhënë. Kisha frikë t'u tregoja njerëzve se cila isha për shkak të frikës se mos nuk pranohesha dhe lëndohesha. Mendoja se gjithsecili rreth meje ishte më i fortë, më i zgjuar dhe më i mirë se unë.

Por të gjitha këto pikëpamje ndryshuan kur u bëra anëtare e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Unë mësova se ne jemi të gjithë fëmijë të Perëndisë dhe ne trashëguam cilësi hyjnore. Tani e kuptoj se nuk ka asnjë garë për atë se cili është më i zgjuar, më i pasur ose më tërheqës. Në sytë e Zotit, ne jemi të gjithë të barabartë dhe Ai është ai që gjykon - jo në bazë të tipareve tona fizike, por sipas bindjes dhe dëshirës sonë për të ndjekur shtegun që Ai ka vendosur. ■

Xhoun Azusena, Filipinet

A DO TË PUNONI TË DIELËN?

Kur isha 15 vjeç, fitova një dëshmi të fortë për ungjillin e Jezu Krishtit dhe isha kaq i lumtur që u bashkova me Kishën. Në atë kohë, po punoja për të ndihmuar në mbajtjen e familjes sime. Megjithatë, jo shumë kohë pasi u pagëzova, e humba punën.

Duhej të gjeja shpejt një punë të re pasi familja varej nga unë, por çdo punë për të cilën aplikova, kërkonte që të punoja të dielave. Refuzova shumë oferta pune pasi e dija se duhet të isha në kishë të dielave (shih DeB 59:9–10).

Pas dy muajsh kërkimi, ende nuk kisha gjetur punë. Nëna ime nuk ishte anëtare e Kishës dhe ndonëse besonte në Perëndi, ishte shumë e zemëruar që po lija të iknin kaq shumë punë.

Një natë, më pa me lot në sy dhe pyeti: “Përse po e lejon Perëndia që kjo të na ndodhë kur je kaq besnik në bërjen e asaj që është e drejtë?”

Unë u përgjigja: “Nënë, unë nuk e di arsyen përse kjo po na ndodh, por e di vërtet se po bëj gjënë e duhur dhe e di se

Perëndia do të na bekojë për atë”.

Mëngjesin tjetër një person më ofroi një shumë të madhe parash për të punuar dy ditë duke lëvizur disa ngarkesa të rënda nga njëra shtëpi tek tjetra. Puna që e rëndë por, kur mora paratë, shkova drejt e në shtëpi dhe bëra një lutje mirënjohjeje. Shpejt gjeta një punë të mirë që më lejon-te t'i merrja pushim të dielat dhe që atëherë nuk kam qenë i papunë.

Jam i lumtur që zgjedha ta mbaja të shenjtë ditën e Shabatit. Ka shumë sfida në jetë, por e di se nëse, pavarësisht nga ato sfida, përpiqemi të jemi të fortë, Zoti do të na bekojë. ■

Sahil Sherma, Indi





Nga Plaku
Nil L. Andersen,
 i Kuorumit të
 Dymbëdhjetë Apostujve

SI TË JEMI TË URTË

Në valën e sotme vërsuese të informacionit, ne kemi në mënyrë të dëshpëruar nevojë për urtësi – urtësi për të **analizuar dhe dalluar** mënyrën se si ta zbatojmë atë që po mësojmë.

Le të mbajmë mend:

1. Ne duhet të kërkojmë urtësi.
2. Urtësia ka shumë veçori dhe gjen zbatim në situata të larmishme.
3. Urtësia e fituar herët në jetë sjell bekime të pamasa.
4. Urtësia në një fushë mund të mos zbatohet në një fushë tjetër.
5. Urtësia e botës, ndonëse në shumë raste mjaft e vlefshme, është më e vlefshme kur i nënshtrohet me përlësi urtësisë së Perëndisë.

Shkrimet e shenjta përshkruajnë dy lloje të urtësisë: urtësinë e botës dhe urtësinë e Perëndisë. Urtësia e botës ka përbërës edhe pozitivë edhe negativë. E përshkruar në mënyrën më të errët, mund të cilësohet si e vërtetë e pjesshme, e përzier me zgjuarsi dhe dredhi, për të arritur qëllime egoiste ose të liga.

Ka një tjetër lloj urtësie të botës që nuk është asfare kaq ogurzezë në shtysat e saj. Në fakt është shumë pozitive. Kjo urtësi fitohet në mënyrë të qëllimshme nëpërmjet **studimit, reflektimit, vëzhgimit dhe punës së palodhur**. Ajo është shumë e vlefshme dhe e dobishme në gjërat që bëjmë. Njerëzve të mirë e të hijshëm, u vjen ndërsa jetojmë në vdekshmëri.

Më e rëndësishmja, urtësia që sjell sukses në botë, duhet të jetë e gatshme të tërhiqet përmbas urtësisë së Perëndisë dhe të mos mendojë se mund ta zëvendësojë atë.

Jo e gjithë urtësia është njësoj e rëndësishme. Ne duhet të mësojmë se, kur ka kundërshtim ndërmjet urtësisë së botës dhe urtësisë së Perëndisë, ne duhet **t’ia nënshtrojmë vullnetin tonë urtësisë së Perëndisë**.

Ju këshilloj që të merrni parasysh disa prej problemeve që po hasni. Vendosni një vijë në mes të letrës. Renditni urtësinë e botës në anën e majtë dhe urtësinë e Perëndisë në anën e djathtë. Shkruani problemet që janë në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Çfarë zgjedhesh po bëni ju?

Në seksionin 45 të Doktrinës e Besëlidhjeve, i cili flet për ngjarjet që do të paraprijnë Ardhjen e Dytë të Shpëtimtarit, Zoti përsëri tregon historinë e dhjetë virgjëreshave dhe pastaj na lë këto fjalë: “Sepse ata që janë të urtë dhe e kanë pranuar të vërtetën, dhe kanë marrë Shpirtin e Shenjtë si udhëzuesin e tyre, dhe nuk janë mashtruar—në të vërtetë unë ju them, ata nuk do të priten e nuk do të hidhen në

zjarr, por do t’i qëndrojnë ditës” (shih DeB 45:57).

Le të **kërkojmë urtësinë e Perëndisë**. Ka shumë gjëra që mund të mësojmë pikërisht tani rreth urtësisë. Ju premtoj se bekimet e Zotit do të jenë me ju ndërsa kërkonit urtësi, urtësinë e Perëndisë. Ai është kaq i dëshiruar të na japë urtësinë e Tij. Dhe nëse do të jemi të bindur dhe plot lutje e do ta kërkojmë atë, ajo do të vijë. ■

Nga një fjalim në ceremoninë e diplomimit të Universitetit “Brigam Jang” dhënë më 10 prill 2009.

SI E KENI VËNË KËTË NË JETË?

“Ka përherë dy mundësi për të zgjedhur. Ju mund të zgjidhni kë të dëshironi. Por ju duhet të vendosni me urtësi. Unë mund të them se të zgjedhurit e Zotit mund t’ju ndihmojë gjatë çdo dite dhe të pasurit e Shpirtit të Shenjtë krahu mund t’ju ndihmojë gjatë çdo situatë. Zgjedhja e anës së gabuar mund të çojë në ndjenjë jo të lumtur, një ndjenjë që do të duket si lumturi për pak kohë, por më vonë ju do të shihni pasojat dhe do t’ju vijë tej mase keq për vendimin që keni marrë. Qëndroni në anën e Zotit! Nuk është gjithmonë e lehtë, por ia vlen ta bësh!”

Samuel J., Austri

PIKËS SHKURT



A ka gjë të keqe të shkoj në **mbrëmje vallëzimi** ose **festa** ku e di se do të ndodhin **gjëra të këqija**, në mënyrë që të jem një **shembull i mirë**?

Bëjini vetes pyetjen: “Çfarë lloj shembulli mendoj në të vërtetë që do të jap në atë situatë?” Nëse keni ndërmend të shkoni diku ku mund të ketë droga ose alkool, veshje të pahijshme, muzikë me fjalë epshore ose kërcim të fëlliqur, si do t’u tregoni njerëzve se sa shumë mund të argëtohen pa ato gjëra? Çfarë ka të ngjarë që do të mendojnë njerëzit përreth jush – “A nuk është ai një shembull i madh i besimit dhe i standardeve?” apo “Për çfarë erdhi ai person?” Në shumicën e rasteve, ju do të jeni një shembull shumë më i mirë duke mos shkuar fare, pasi ju nuk do ta vini veten qëllimisht dhe me vetëdije para tundimit. ■

Sa ndikim ka Satani në mendimet e mia?

Ati ynë Qiellor siguron që ne të kemi lirinë e zgjedhjes morale, aftësinë për të zgjedhur të mirën ose të ligën. Ai nuk do të na detyrojë të bëjmë të mirën dhe djalli nuk mund të na detyrojë të bëjmë të ligën (shih *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2007], f. 224).

Kështu që, kur vjen puna te mendimet tuaja, djalli ka po aq ndikim sa ju jeni të gatshëm t’i jepni atij. Profeti Jozef Smith tha: “Satani nuk mund të na joshë me anë të ndjelljeve të tij, veç nëse ne në zemrën tonë miratojmë dhe jepemi” (*Mësimet: Jozef Smith*, f. 224). Ai gjithashtu tha: “Djalli nuk ka fuqi mbi

ne, vetëm kur ne e lejojmë atë” (f. 224).

Përveç kësaj, shkrimet e shenjta na thonë se “s’ka asnjë tjetër, përveç Perëndisë, që i di mendimet e tua dhe qëllimet e zemrës tënde” (DeB 6:16), kështu që Satani në të vërtetë nuk e di se çfarë jeni duke menduar. Ai vetëm mund të ofrojë tundime dhe ndjellje. Por nëse zgjidhni t’i ndiqni ato, ai fiton fuqi më të madhe mbi ju dhe tundimet bëhen

më të forta. Në të njëjtën mënyrë, nëse i bëni ballë të ligës dhe zgjidhni të mirën, ju do të forcoheni e bekojeni. ■

Një Tufë e Vetme dhe NJË BARI i Vetëm

Një gardh për një tufë delesh na mëson rreth përkujdesjes së Shpëtimtarit për popullin e Tij.



Vatha e Lashtë

Çfarë është ajo: Një thark i thjeshtë, një rrethim me mur.

Qëllimi: Për ta mbrojtur një tufë delesh kundër grabitqarëve dhe hajdutëve, veçanërisht natën.

Materiali dhe ndërtimi: Gurë, zakonisht, me bimë gjembaçe shpesh të vendosura në majë të mureve. Shkurre të dendura gjembaçe përdoren shpesh edhe për të bërë një gardh, për një vathë të përkohshme të sajuar. Shpellat ndonjëherë shërbenin si vathë, me gardhe prej gurësh të vegjël ose shkurresh të vendosura përpara tyre.

FAKTE NGA BIBLA

- Delet ishin me shumë vlerë për mishin, qumështin, yndyrën, leshin, lëkurën e brirët e tyre, dhe ishin kafsha kryesore për flijime.
- Në Izrael, ujqërit, hienat, panterat dhe çakejtë, janë midis grabitqarëve që do të sulmonin delet. Në kohët e lashta, krahina banohej edhe nga luanë e arinj (shih 1 Samuelit 17:33-37).
- Barinjët përdornin një shkop për t'i udhëhequr delet dhe një shufër e një hobe për t'i mbrojtur ato.
- Një bari i çonte delet e tij për ushqim e ujë gjatë ditës (shih Psalmeve 23:1-2) dhe natën i kthente në vathë. Bariu do t'i numëronte delet kur ktheheshin, duke kërkuar për të larguarat nëse kishte ndonjë që mungonte. Pastaj ai do të shtrihej te hyrja e vathës për t'i mbrojtur ato.
- Jezu Krishti e quajti Vetën Bariu i Mirë (shih Gjoni 10:11-15) për shkak se Ai dha jetën e Tij për ne. Ai gjithashtu e krahasoi Vetën me derën e vathës (shih Gjoni 10:1-9) sepse është nëpërmjet Tij që ne marrim ushqim shpirtëror, prehje, paqe, shpëtim dhe ekzaltim.
- Apostulli Pal e krahasoi Kishën me një tufë delesh (shih Veprat e Apostujve 20:28).

ILLUSTRIMI NGA DAVID HABBEEN; HOLLËSI NGA KRISHTI DHE SUNDUESI / RI E / PASUR, NGA HEINRICH HOFMANN



DELE TË TJERA

Shpëtimtari foli për “dele të tjera . . . që nuk janë të kësaj vathe” (Gjoni 10:16), duke nënkuptuar nefitet dhe lamanitët, të cilët qenë çuar larg shtëpisë së Izraelit (shih 3 Nefi 15:14-24). Ai foli edhe për vizitën te fiset e humbura të Izraelit (shih 3 Nefi 15:20; 16:1-3).

Çfarë Mund të Mësojmë Ne

Vathët janë:

[Vende] ku mblidhet tufa. Si anëtarë të Kishës, ne ndajmë një lidhje uniteti përmes besimit tonë dhe besëlidhjeve tona, si edhe nëpërmjet të mbledhurit vërtet së bashku. Presidenti Henri B. Ajring, Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë, ka dhënë mësim: “Gëzimi i unitetit që [Ati Qiellor] dëshiron kaq shumë të na japë nuk është vetëm për individë. Ne duhet ta kërkojmë atë dhe të kualifikohemi për të bashkë me të tjerë. Nuk është e papritur atëherë që Perëndia na nxit të mblidhemi që Ai të mund të na bekojë. Ai na do të mblidhemi në familje. Ai ka krijuar klasa, lagje e degë dhe na ka urdhëruar të takohemi shpesh bashkë. Në ato mbledhje, . . . ne mund të lutemi dhe të punojmë për unitetin që do të na sjellë gëzim dhe do të shumëfishojë forcën tonë për të shërbyer” (“Zemrat Tona Thuren si Një e Vetme”, *Liahona*, nëntor 2008, f. 69).

Një vend sigurie dhe prehjeje. Në Jezu Krishtin, ne “gjejmë] prehje për shpirtrat [tanë]” (Mateu 11:29). Kisha e Tij është një “mbrojtje e . . . strehim” (DeB 115:6). Dhe ashtu si Presidenti Bojd K. Paker, President i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, ka dhënë mësim: “Ne gjejmë siguri dhe mbrojtje për veten tonë . . . nëpërmjet respektimit të besëlidhjeve që kemi bërë dhe nëpërmjet të jetuarit sipas veprimeve të thjeshta të bindjes, të kërkuara prej pasuesve të Krishtit” (“Këto Gjëra i Di”, *Liahona*, maj 2013, f. 7).

Të ruajtura nga bariu. Jezu Krishti është Bariu i Mirë i cili na shpëton. Ai vuajti dhe vdiq kështu që ne të mund ta mposhtim mëkatën e vdekjen dhe të kthehemi tek Ati ynë Qiellor. Ndërsa vijmë te Krishti dhe jemi të bindur ndaj urdhërimeve të Tij, Ai na bekon, drejton dhe mbron si individualisht edhe si populli i Tij i besëlidhjes. ■

“Si mund të ndihem mjaftueshëm i qetë për të folur me peshkopin tim rreth problemeve ose shqetësimeve?”

Ju mund të ndiheni të tensionuar për t'i folur peshkopit tuaj rreth gjërave me të cilat po ndesheni, dhe kjo është normale. Ne shpesh tensionohemi përpara përvojave të reja ose përpara se të flasim me një të rritur.

Por peshkopi juaj është thirrur nga Perëndia. Ai është thirrur ngaqë ai është një dishepull i zotuar i Jezu Krishtit. Ai do të bëjë gjithçka të mundshme për të qenë i përzemërt dhe i kuptueshëm. Qëllimi i tij është që t'ju ndihmojë të vini te Shpëtimtari në mënyrë që të mund të gjeni paqe. Fillimisht, ju mund të ndiheni të turpëruar për t'i folur për pyetjet ose mëkatet tuaja, por ai nuk do të ketë një opinion më të keq për ju. Në fakt, ai do të jetë i gëzuar që ju keni dëshirë të përmirësoheni. Dhe ai do të ruajë fshehtësinë e bisedave tuaja.

Ju nuk duhet t'i mbartni të vetëm barrët tuaja. Peshkopi juaj mund t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjet tuaja dhe, nëse është e nevojshme, mund t'ju ndihmojë të pendoheni e të mposhtni, nëpërmjet Shlyerjes së Krishtit, ndjenjat e fajit, dëshpërimit apo padenjesisë.

Kur të flisni me peshkopin tuaj, ju do të ndieni dashurinë e tij për ju. Megjithatë ai është përgjegjës për të gjithë lagjen ose degën, në qendër të vëmendjes së tij është mirëqenia e të rinjve dhe të rejave. Ju nuk po e shqetësoni atë duke i kërkuar ndihmë.

Ju mund t'i luteni Atit Qiellor për forcë dhe kurajë që të flisni me peshkopin tuaj. Ai e ka autorizuar peshkopin tuaj që t'ju ndihmojë dhe peshkopi juaj mezi pret të veprojë ashtu. Në qoftë se shkoni me zemër të hapur dhe një dëshirë për të qenë më të mirë, ju do të zbuloni se do të largoheni nga zyra e tij duke u ndier shumë më mirë sesa ndiheshit më përpara.

Ai Nuk do të Ketë një Opinion më të Keq për Ju

Peshkopit të lagjes suaj i është dhënë autoriteti për t'ju udhëhequr nëpër hapat e pendimit. Ndonjëherë e vetmja mënyrë për ju që të pendoheni plotësisht nëpërmjet Shpëtimtarit, është të filloni të punoni me peshkopin tuaj. Kur kisha nevojë të flisja me peshkopin tim, ai më ndihmonte të gjeja Shpëtimtarin dhe të mbyllja plagën më të thellë që kisha pasur ndonjëherë. Peshkopi juaj dëshiron t'ju ndihmojë. Thirrja e tij është që të përkujdeset për ju dhe ai nuk do të ketë një opinion më të keq për ju për shkak të diçkaje për të cilën keni nevojë të takoheni me të.

Medison D., 18 vjeçe, Juta, SHBA

Peshkopi Juaj Është i Gatshëm të Ndhimjojë

E kisha zakon të ndihesha në siklet në intervista, por përfundimisht kuptova se peshkopi im ishte përherë i gatshëm të më ndihmonte të zgjidhja problemet e mia. Mirëbesojini peshkopit tuaj; ai është bari dhe lagjja është tufa e tij.

Xhemi R., 19 vjeçe, Koçabamba, Bolivi



Ai Nuk do të Tradhtojë Mirëbesimin Tuaj

Kam arritur të di për vete se një peshkop është ndoshta i rrituri

më i besuar nga i cili një adoleshent mund të kërkojë ndihmë. Ai kurrë nuk do ta tradhtojë mirëbesimin tuaj – çdo gjë që ndani me të, mbetet në zyrën e tij. Ndonjëherë është kaq e vështirë të bisedoni për problemet tuaja, por të folurit ballë për ballë me dikë që ju do

dhe kujdeset e do më të mirën për ju e bën shumë më të lehtë.

Nikol S., 18 vjeçe, Ajdaho, SHBA



Ju Mund të Mbështeteni tek Ai

Peshkopi ose presidenti i degës suaj është një shërbëtor i vërtetë i Zotit. Ju mund të mbështeteni tek ai për udhërrëfim ndërsa kërkonti frymëzim nga Fryma e Shenjtë dhe shkrimet e shenjta. Ju duhet të kuptoni se peshkopi është aty për t’ju ndihmuar dhe se ai udhëhiqet nga Perëndia.

Stanjislav R., 19 vjeç, Donjeck, Ukrainë



Mbani Mend se Ai ju Do

Nëse keni diçka që vërtet dëshironi ta diskutoni me peshkopin, mund të jetë më e lehtë që së pari të bisedoni me të për shkollën dhe gjëra të tjera të përgjithshme. Nëse jeni të tensionuar ngaqë keni nevojë të flisni me të për çështje pendimi, vetëm kujtoni se ai ju do. Ju nuk duhet të jeni të tensionuar për atë që ai do të mendojë për ju, pasi për ç’arsye do t’ju shihte juve me përbuzje ngaqë dëshironi të jeni më pranë Krishtit?

Ashli D., 17 vjeçe, Arizona, SHBA



Lutuni që ta Dini për Vete

Pyeteni veten për arsyen përse ndiheni në siklet që të flisni me peshkopin. A mendoni se ai nuk do të jetë në gjendje të ndihmojë të zgjidhni problemet tuaja? Lutuni që ta dini

për vete se peshkopi ju do dhe është thirrur t’ju ndihmojë.

Adam H., 13 vjeç, Kaliforni, SHBA

Edhe nëse Bëni një Gabim

Mund të jetë e vështirë dhe turpëruese t’i rrëfeni gjëra peshkopit tuaj por, kur të dilni nga ajo zyrë, ju do të ndiheni të lehtësuar dhe do ta dini se Ati Qiellor ju do. Ai dëshiron që ju të jeni të lumtur, edhe nëse bëni një gabim.

Amanda W., 16 vjeçe, Juta, SHBA

Ai Është Gati për të Ndhmuar

Peshkopi është bariu i lagjes suaj. Mbani mend se ai do të bëjë çdo gjë të mundshme për t’ju ndihmuar dhe ai ka fuqinë e Perëndisë në anën e tij. Nëse ndiheni i frikësuar, ju mund të luteni për forcë që të jeni në gjendje të flisni me peshkopin tuaj. Në fund, ju do të jeni i kënaqur që shkuat tek ai – dhe do t’ia vlejë.

Samuel H., 14 vjeç, Ajdaho, SHBA

Për më shumë informacion mbi këtë temë, shihni C. Skot Grou, “Përse dhe Çfarë Duhet t’i Rrëfëj Peshkopit Tim?” Liahona, tetor 2013, f. 59.



FLITINI NË MIRËBESIM ATIJ

“Kërkoni këshillë nga udhëheqësit tuaj të priftërisë,

veçanërisht nga peshkopi juaj. Ai i njeh standardet dhe di se çfarë t’ju mësojë. Kërkoni për mundësi që të jeni me të. Ju mund të prisni nga ai që t’ju bëjë pyetje të drejtpërdrejta, zhbiruese. Mirëbesojini atij. Flitini në mirëbesim atij. Kërkojini t’ju ndihmojë të kuptoni atë që Zoti pret nga ju. Bëni një zotim për të jetuar në përputhje me standardet e Kishës për moralin. Një marrëdhënie domethënëse me një udhëheqës të rritur është thelbësore për t’ju ndihmuar të qëndroni moralisht të pastër dhe të denjë.”

Plaku M. Rasëll Ballard, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Purity Precedes Power”, Ensign, nëntor 1990, f. 37.

PYETJA PASUESE

“Në shkollë më tallin ngaqë jam shdm. E di se duhet të mbroj atë në të cilën besoj, por është kaq e vështirë! Si mund të bëhem i guximshëm sa duhet për t’ju thënë atyre njerëzve që të ndalojnë?”

Dërgojeni përgjigjen tuaj dhe, nëse dëshironi, një fotografi me rezolucion të lartë deri më 1 maj 2014 te liahona.lds.org, nëpërmjet postës elektronike te liahona@ldschurch.org ose nëpërmjet postës (shih adresën në faqen 3).

Informacioni dhe leja e mëposhtme duhet të përfshihen në postimin elektronik apo letrën tuaj: 1) emri i plotë, 2) data e lindjes, 3) lagjja ose dega, 4) kunji ose distrikti, 5) leja juaj me shkrim dhe, nëse jeni nën moshën 18 vjeç, leja me shkrim e prindit tuaj (postimi elektronik pranohet) për botimin e përgjigjes dhe të fotografisë suaj.

Përgjigjet mund të redaktohen lidhur me gjatësinë apo qartësinë.



*Eli e dinte se cili ishte heroi
i saj, por ajo ishte shumë e
frikësuar për ta thënë atë.*

Cili Është

Nga Sharlot Mej Shepard

Bazuar në një ndodhi të vërtetë

*“Mbaje ti nderin, ndërgjegjen, besim’n; qëndro si hero”
 (“Ji i Drejtë”, Himne dhe Këngë të Fëmijëve, f. 64).*

Eli e hëngri thoin e saj me nervozizëm.
Zonjusha Fic po kalonte në rreshtat e
bankave dhe po i bënte një pyetje çdo
nxënësi, një e nga një.

“Cili është heroi yt?” e pyeti Zonju-
sha Fic Xhereminë.

Xheremia nuk humbi kohë për
t’u përgjigjur. “Babi im!” tha ai
me krenari.

Zonjusha Fic buzëqeshi.

“Dhe i yti, Sara?”



Heroi Juaj?

Përgjigjja e saj erdhi po aq shpejt. “Abraham Linkolni.” Eli e ndjente zemrën e saj të rrihte fort ndërsa Zonjusha Fic vazhdonte të ecte në rreshtin e nxënësve. Ata kishin qenë duke folur për heronjtë gjatë gjithë ditës dhe tani gjithsecili duhej të thoshte se kush ishte heroi i tyre – para gjithë klasës!

Amberi dhe Xhastini thanë se heronjtë e tyre ishin nënat e tyre. Uollteri tha se heroi i tij ishte gjyshi i tij. Disa nxënës të tjerë thanë se heronjtë e tyre ishin një mbret ose president.

Kishin mbetur vetëm pak nxënës përpara se Zonjusha Fic të arrinte tek Eli. Ajo duhej të mendonte për një hero – dhe shpejt.

Eli pa poshtë te këpucët e saj, e turpëruar. Të vije me një hero nuk ishte problemi i vërtetë. Ajo tashmë e dinte se cili ishte heroi i saj. Ai ishte Jezu Krishti. Ai kishte shëruar të sëmurët, kishte ngritur të vdekurit dhe kishte paguar çmimin për mëkatet e gjithsecilit. Ai ishte heroi më i madh që ka jetuar ndonjëherë! Ajo thjesht ishte shumë e frikësuar ta thoshte atë.

Eli e hëngri sërish thoin e saj nga mendimi se do t'i tregonte të gjithë klasës se Jezu Krishti ishte heroi i saj. Po sikur Xheremia të qeshte me të? Po sikur Sara dhe Amberi të bënin thashetheme për të në pushim të madh?

Sigurisht që ajo e dinte se Jezu Krishti ishte heroi i saj. Por kjo nuk do të thoshte se çdo njeri tjetër duhej ta dinte gjithashtu.

Zonjusha Fic ndaloi pikërisht përpara bankës së Elit dhe buzëqeshi. “Dhe cili është heroi yt, Eli?”

Eli hodhi një vështrim nga rreshti i nxënësve afër saj deri te Zonjusha Fic. “Abraham Linkolni”, pëshpëriti ajo.

Zonjushës Fic i rrezëlliu fytyra. “Mirë!” tha ajo teksa shkoi te nxënësi tjetër në rresht.

Sapo ajo u largua, shpatullat e Elit u lëshuan të lehtësuara. Gjysma e së keqes që mbaroi. Gjëja e fundit që i duhej, ishte që çdo njeri në klasë të dinte se heroi i saj ishte –

“Jezu Krishti”, tha një zë.


Eli çakërriti sytë ndërsa pa me ngadalë rreth e rrotull. Atje – vetëm pak më poshtë rreshtit – qëndronte i ulur një djalë i vogël me flokë të çrregullta. Ai ishte i dobët e i turpshëm dhe ulej gjithmonë të fund të klasës. Eli as nuk ia dinte emrin. Ajo nuk mbante mend që ai të kishte thënë ndonjëherë një fjalë të vetme – deri tani.

Disa nxënës u kthyen për ta vështruar ngultas djalin, por ai nuk e kishte mendjen tek ata. Ai thjesht pa nga Zonjusha Fic dhe foli sërish. “Heroi im është Jezu Krishti.”

Zonjusha Fic buzëqeshi me gëzim dhe vazhdoi më poshtë. Por Eli pa nga djali me habi. Ajo kishte qenë e frikësuar t'i thoshte gjithsecilit për heroin e saj, por ai nuk kishte qenë. Ai madje as nuk shkonte në kishën e saj! Por ai e dinte sa e rëndësishme ishte të qëndronte si një shembull i Jezu Krishtit, madje edhe kur ishte e vështirë.

Eli i buzëqeshi djalit. Ajo nuk do të ishte më e frikësuar të thoshte se cili ishte heroi i saj. Në fund të fundit, ajo tashmë kishte dy prej tyre. ■

Autorja jeton në Kaliforni, SHBA.



Lutje dhe Katedrale

Nga Mek-Kelli Xhorxh

Bazuar në një ndodhi të vërtetë

“[Ju] jeni dishepujt e mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin” (Gjoni 13:35).

Deni pa lart, por ende nuk mund ta shihte kulmin e katedrales së bukur. Njerëz që i përkisnin një kishë tjetër, vinin këtu. Deni nuk e kuptoi arsyen përse familja e saj po e vizitonte këtë kishë një ditë të premtjeje, por Babi tha se ata po shkonin te diçka që quhej Adhurimi i Mbrëmjes.

“Çfarë është ajo?” pyeti Deni.

“Është një mbledhje ku njerëzit këndojnë, lexojnë shkrimet e shenjta dhe luten së bashku”, tha Babi. “Si një familje e madhe në fund të ditës.”

Denit i pëlqeu mënyra se si dukej ajo nga shpjegimi. Ajo dhe familja e saj po vizitonin Anglinë. Të dielën e kaluar, ata shkuan në një lagje në një qytet të quajtur Jork. Në Fillore, të gjithë fëmijët dinin të njëjtat shkrime të shenjta dhe këngë që dinte Deni. Ajo e dinte se lagja që vizitoi, ishte pjesë e Kishës së vërtetë të Jezusit, po njësoj si lagja e saj në shtëpi.

Por kjo katedrale ishte shumë ndryshe nga çka ishte mësuar ajo. Ajo vuri re një tavolinë të vogël të mbushur me qirinj. Deni pa një djalë të ndizte një qiri.

“Përse po ndizni qirinj?” e pyeti Deni atë.

Djali buzëqeshi. “Unë ndez një qiri kur lutem për gjëra të veçanta.





“Ne duhet t’i duam të gjithë njerëzit, të jemi dëgjues të mirë dhe të tregojmë shqetësim për bindjet e tyre të sinqerta.”

Plaku Dallin H. Ouks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Dashuria për të Tjerët dhe të Jetuarit me Ndryshimet”, *Liahona*, nëntor 2014, f. 26–27.

Për sa kohë flaka digjet, shpresoj që lutja do të vazhdojë të dëgjohej nga Perëndia.”

Denit ata iu dukën si qirinjtë e zakonshëm. Ajo ishte pak e hutuar, por dëshironte të ishte e sjellshme. Ajo i buzëqeshi djalit.

Deni dhe familja e saj u ulën dhe shpejt filloi Adhurimi i Mbrëmjes. Ajo pa të njëjtin djalë disa rreshta larg. Pastaj ajo kuptoi se nuk njihnte asnjë prej këngëve që të gjithë po këndonin. Kur u lutën, ata lexuan me zë nga një libër i vogël. Çdo gjë dukej e ndryshme nga çka ishte mësuar ajo.

Por muzika ishte e bukur, edhe pse nuk ishte e njohur. Pastaj një burrë u ngrit që të lexonte shkrimet e shenjta. Ai kishte veshur mantel, në vend të një kostumi dhe kollareje si peshkopi i Denit. Por si filloi të lexonte, Deni e kuptoi se e njihnte këtë histori! Ai po lexonte për Jezusin që shëroi 10 lebroset.

“Babi”, pëshpëriti Deni, “më pëlqen shumë kjo histori.”

Babi buzëqeshi. “Edhe mua.”

Pastaj burri me mantel bëri një lutje. Ai i kërkoi Perëndisë të bekonte ata që ishin të sëmurë dhe në nevojë. Ashtu siç bënte Deni! Ai kërkoi edhe një bekim të veçantë për udhëheqësit e kishës së tij. Denit iu kujtua se si familja e saj

gjithmonë i kërkonte Atit Qiellor të bekonte Presidentin Tomas S. Monson dhe këshilltarët e tij.

Një ndjenjë e ngrohtë erdhi në zemrën e Denit. Ajo e dinte se Ati Qiellor po i tregonte asaj që Ai i donte të gjithë fëmijët e Tij dhe i dëgjonte të gjitha lutjet e tyre, edhe nëse shkonin në një kishë të ndryshme dhe nuk kishin plotësinë e ungjillit.

Kur u ngritën për t’u larguar, Babi kontrolloi telefonin e tij. Ai u duk i trishtuar kur lexoi mesazhet e tij. “Motra Monson ndërroi jetë”, tha ai.

“Oh, jo!” Deni bëri një lutje të shpejtë në zemrën e saj që Presidenti Monson të ishte mirë.

“A je mirë?” dikush pyeti. Ishte djali i mëparshëm. Ai e kishte dëgjuar Denin dhe dukej i shqetësuar.

“Motra Monson ndërroi jetë”, tha Deni. “Ajo ishte gruaja e profetit tonë, Presidentit Monson.”

“Më vjen keq”, tha ai përzemërsisht. “Do të ndez një qiri për të.”

Deni buzëqeshi dhe e falënderoi. Ajo mendoi se ishte gjë e mirë nga ana e djalit të bënte një lutje të veçantë për Presidentin Monson. Ajo e dinte se Ati Qiellor do ta dëgjonte lutjen që bëri ajo në zemrën e saj dhe lutjen që bëri djali gjithashtu. ■

Autorja jeton në Jutá, SHBA.





**Nga Plaku
Rasëll M. Nelson,**


i Kuorunit të
Dymbëdhjetë
Apostujve

*Anëtarët e Kuorunit
të Dymbëdhjetë Apos-
tujve janë dëshmitarë
të veçantë të Jezu
Krishtit.*


Përse të qenit **I BINDUR** është kaq i rëndësishëm?



Mbajtja e urdhërimeve
sjell bekime, çdo herë!



Shkelja e urdhërimeve sjell humbje
të bekimeve, çdo herë!



Edhe nëse "gjithkush po e bën atë",
e gabuara kurrë nuk është e drejtë.



Kur je i bindur ndaj Perëndisë,
ti e le besimin tënd të dalë në pah.

“Kjo është dita
që Zoti ka bërë;
le të gëzohemi
dhe të ngazëllojmë
në të.”

– Psalmeve 118:24



Jezusi Shëron një Lebrros



Nga Erin Sanderson

Mendoni për një rast kur ju ishit i sëmurë. LA bëri dikush diçka të mirë për t'ju ndihmuar të ndiheni më mirë?

Në Dhiatën e Re ne lexojmë për mënyrën se si Jezusi tregoi dashamirësi ndaj njerëzve që ishin të sëmurë. Një ditë, një burrë me një sëmundje të dhimbshme të lëkurës të quajtur lebër, shkoi te Jezusi. Ai e dinte se Jezusi kishte fuqinë që të shëronte këdo që ishte i sëmurë. Ai besonte se Jezusi mund ta shëronte atë. Jezusi e preku lebrrosin dhe tha: “Qofsh pastruar” (Marku 1:41). Sapo Jezusi pati folur, burri u shërua.

Ne mund t'i ndjekim gjurmët e Jezusit duke qenë të mirë dhe të dashur ndaj të tjerëve që janë të sëmurë ose të pikëlluar. ■

Autorja jeton në Juta, SHBA.

IDE PËR BISEDË FAMILJARE

Ju mund të përdorni figurat nga shkrimet e shenjta në faqen 74 për të treguar historinë nga Marku 1:40–42. Pastaj ju mund të lexoni te Judë 1:22 dhe të planifikoni se si të bëni diçka si familje, për të bërë një ndryshim në jetën e dikujt. Ndoshta ju mund t'i shërbeni dikujt në fshehtësi!

Kënga: “Tell Me the Stories of Jesus” [“Historitë e Jezusit m’Trego”] (*Children’s Songbook*, nr. 57)

Shkrimi i Shenjtë: Marku 1:40–42

Video: Shkoni te [Biblevideos.org](https://www.biblevideos.org) për të parë “Jesus Heals a Lame Man on the Sabbath” [“Jezusi Shëron një Burrë të Çalë në Shabat”] dhe “Jesus Heals a Man Born Blind” [“Jezusi Shëron një Njeri të Lindur të Verbër”].



NDJEKJA E GJURMËVE TË JEZUSIT

Me familjen tuaj, interpretoni me role mënyrën se si ju mund të tregoni dashuri për të tjerët në këto situata. Improvizoni disa nga vetë situatat tuaja.



Një familje e re ka ardhur në lagjen tuaj.

Disa fëmijë po tregohen të këqij me një fëmijë tjetër në shkollë.

Një vizitor që nuk njih askënd në kishë, vjen në Filllore.

Vëllai ose motra juaj më e vogël nuk ka asnjë njeri me të luaj.

Foshnja po qan dhe nëna juaj po përpiqet të bëjë darkën.

Një njeri në lagjen ose degën tuaj është i sëmurë dhe nuk mund të lëvizë nga shtëpia.

MËSONI MË SHUMË: UNGJITË

Dhiata e Re ka katër libra të veçantë të quajtur Ungjijtë, të cilët u shkruan nga disa prej dishepujve të Jezusit. Ungjijtë tregojnë rreth kohës kur Jezu Krishti jetoi në tokë. Historia e shërimit të lebrostit është në tre prej Ungjijve. Ajo është te Marku 1:40–42 dhe gjithashtu te Mateu 8:2–4 dhe Lluka 5:12–14.

KËSHILLË PËR SHKRIMIN E SHENJTË: KËRKIM PËR FJALË

Te Marku 1:41 përdoret fjala *mëshiruar*. Ndonjëherë në Bibël ka fjalë të mëdha që mund të mos i kuptoni. Kur gjeni një fjalë që nuk e dini, ju mund të përdorni Udhëzuesin për Shkrimet e Shenjta që t'ju ndihmojë! Për shembull, ju mund të kërkonit fjalën "Mëshirë" për të zbuluar se çfarë kuptimi ka dhe për të gjetur shkrime të tjera të shenjta që e përdorin atë. Çfarë fjalësh të tjera mund të kërkonit te historia e Jezusit që shëroi burrin me lebër?

Jezusi Shëron të Sëmurin

Marku 1:40–42; Lluka 4:38–40

Ngjiteni këtë faqe në letër të trashë ose karton. Pastaj pritini figurat dhe ngjitini në shkopinj artizanale ose çanta prej letre. Përdorini për të interpretuar histori me role nga Dhiata e Re. *Mund të shtypni më shumë kopje në internet te liahona.lds.org.*



Turma



Jezu Krishti



Lebrosi




Vjehra e Pjetrit



Nga Plaku
Klaudio D. Zivic,
i Të Shtatëdhjetëve

Shtegu I DREJTË



“Dëgjoni fjalët e atij Perëndie që ju bëri” (DeB 43:23).

Shumë vite më parë, unë dhe familja ime vizituam Parkun Kombëtar të Harqeve në Juta, SHBA. Njëri prej harqeve më të bukur dhe të famshëm në park është Harku Delikat dhe ne vendosëm t’i ngjiteshim malit që ta arrinim atë.

Ne filluam me entuziazëm, por shpejt të tjerët donin të pushonin. Unë dëshiroja të shkoja atje më shpejt, kështu që vazhdova i vetëm. Pa i kushtuar vëmendje shtegut që duhet të merrja, fillova të ndiqja një burrë që dukej se e dinte se ku po shkonte.

Shtegu u bë më i vështirë për t’u ngjitur. Isha i sigurt se familja ime nuk do t’ia kishte dalë mbanë. Papritur pashë Harkun Delikat por, për habinë time, unë nuk

mund ta arrija atë. Shtegu që kisha marrë, nuk të çonte te harku.

Isha i zhgënjyer dhe u ktheva. Prita me padurim derisa u takova sërish me grupin tim. Ata më treguan se kishin ndjekur shenjat që tregonin udhën e drejtë dhe, me kujdes e përpjekje, kishin arritur te Harku Delikat. Fatkeqësisht, unë kisha marrë udhën e gabuar. Çfarë mësimi mora!

Mos ia ndani sytë shtegut tuaj për te jeta e përjetshme me Atin tuaj Qiellor. Ndiqni parimet e ungjillit dhe urdhërimet që mësoni dhe ju do të jeni në shtegun e drejtë për të jetuar me Të përgjithmonë. ■

Nga “Le të mos Marrim Udhën e Gabuar”, Liahona, maj 2014, f. 39–41.

E Di se Jezusi më Do

Nga Xhejn Mek-Brajd Çoejt





Bazuar në një ndodhi të vërtetë

Leini po përpiquej tepër fort të tregonte nderim në kishë. Por ajo ishte e lodhur dhe donte shumë të tundte këmbët.



Pasi sakramenti mbaroi, Leini hapi librin e saj për Jezusin. Ajo gjeti figurën e Jezusit me fëmijët e vegjël. Kjo e bëri të ndihej e qetë dhe e lumtur brenda vetes.

Historia vijon në faqen 79.



1-Priteni



Libri im për JEZUSIN

8

*E Di, Shpëtimtari Më Do
Nga Temi Xhepson Krimër dhe Derena Bell*

1

2-Paloseni

5

*Un' s'e kam prekur as ndenja pran' Tij,
por di që jetoj vërtet.*



4

*Dashurin' që ndjen për ata familj,
dhe për mua e ndien.*

4-Priteni



3-Paloseni




Shum' koh' më parë në një vend të bukur,
fëmij't rreth Jezusit mbledhur.

2



Zemrën ia fal Atij.
E di, Shpëtimtari më do.

7



Ndjen dashurin' dhe pan' lotët e Tij,
Kur i bekoj dhe i m'soi.

3



Jeton, e dli' Plot besim pas Tij do shkoj.

6

Paloseni

Paloseni



Pasi mbaroi mbledhja e sakramentit, Leini e pyeti mamin: “Përse është më e lehtë të tregoj nderim kur shikoj librin tim për Jezusin?”

“Mendoj ngaqë të kujton se sa shumë të do Jezusi”, tha Mami.

Leini pohoi me kokë. “A mendon se Jezusi e di që e dua Atë gjithashtu?” pyeti ajo.

Mami i dha një përqaftim Leinit. “Po, jam e sigurt se Ai e di.” ■



Autorja jeton në Kolorado, SHBA.

Ky muaj shënon 100 vjet që kur Presidenca e Parë i nxiti anëtarët të bënin mbrëmje familjare. Fragmenti vijues vjen nga letra e Presidencës së Parë që paraqet mbrëmjen familjare. Ajo u lëshua për botim në prill të 1915-ës dhe u shtyp te Improvement Era në qershor të 1915-ës (faqet 733–734). Përdorimi i germës së madhe dhe i shenjave të pikësimit është modernizuar.

Të Dashur Vëllezër e Motra:
Ne i këshillojmë shenjtoret e ditëve të mëvonshme ta zbatojnë me përpikëri urdhërimin e Zotit të dhënë në seksionin e 68-të të Doktrinës e Besëlidhjeve:

“Dhe përsëri, për aq sa prindërit kanë fëmijë në Sion . . . të cilët nuk i mësojnë të kuptojnë doktrinën e pendimit, të besimit në Krishtin, Birin e Perëndisë së gjallë, dhe të pagëzimit e të dhuratës së Frymës së Shenjtë me anë të vënies së duarve, kur janë tetë vjeç, mëkati qoftë mbi kokat e prindërve. . . .

Dhe ata gjithashtu duhet t'i mësojnë fëmijët e tyre të luten dhe të ecin drejt përpara Zotit” [shih DeB 68:25–28].

Fëmijët e Sionit duhet të zbatojnë më plotësisht edhe urdhërimin e Zotit dhënë

Izraelit të lashtë dhe përsëritur për shenjtoret e ditëve të mëvonshme:

“Do të nderosh atin tënd dhe nënën tënde, me qëllim që ditët e tua të jenë të gjata mbi tokën që Zoti, Perëndia yt, po të jep” [Eksodi 20:12].

Këto zbulesa gjejnë zbatim fuqishëm për shenjtoret e ditëve të mëvonshme dhe u kërkohet etërve dhe nënave në këtë Kishë që këto urdhërime të jepen mësim e të zbatohen në shtëpitë e tyre.

Për këtë qëllim, ne këshillojmë dhe nxitim fillimin e një “mbrëmjeje

familjare” në mbarë Kishën, kohë në të cilën etërit dhe nënat të mund të mbledhin së bashku djemtë e vajzat e tyre në shtëpi dhe t'u mësojnë atyre fjalën e Zotit. Kështu ata mund të mësojnë më plotësisht nevojat dhe kërkesat e familjeve të tyre, duke u njohur, në të njëjtën kohë, ata vetë

100 VITE Mbrëmje Familjare



dhe fëmijët e tyre në mënyrë më të plotë me parimet e ungjillit të Jezu Krishtit. Kjo mbrëmje familjare duhet t'i kushtohet lutjes, këndimit të himneve, këngëve, muzikës instrumentale, leximit të shkrimeve të shenjta, temave familjare dhe udhëzimeve të veçanta mbi parimet e ungjillit dhe mbi problemet morale të jetës, si edhe detyrave e detyrimeve të fëmijëve ndaj prindërve, shtëpisë, Kishës, shoqërisë dhe kombit. Për fëmijët më të vegjël mund të paraqiten recitime,

këngë, histori dhe lojëra të përshtatshme. Mund të shërbehen gosti të lehta të llojit që mund të përgatiten më shumë në shtëpi.

Formalizmi dhe ashpërsia duhet të shmangen me maturi dhe e gjithë familja duhet të marrë pjesë në aktivitetet.

Këto mbledhje do të sigurojnë mundësi për mirëbesim të ndërsjellë mes prindërve dhe fëmijëve, mes vëllezërve dhe motrave, si edhe do të japin mundësi për fjalë paralajmërimi, këshille dhe këshillimi nga prindërit për djemtë dhe vajzat e tyre. Ato do të ofrojnë mundësi për djemtë dhe vajzat që të nderojnë atin dhe nënën dhe të tregojnë vlerësimin e tyre për bekimet e shtëpisë në mënyrë që premtimi i Zotit për ta vërtet të mund të plotësohet dhe jeta e tyre të zgjatet e të bëhet e lumtur. . . .

Ne . . . i nxitim të rinjtë të qëndrojnë në shtëpi atë mbrëmje dhe të përdorin të gjitha energjitë e tyre që ta bëjnë atë sa më udhëzuese, të dobishme dhe interesante.

Nëse shenjtoret i binden kësaj këshille, ne premtojmë se bekime të mëdha do të pasojnë. Dashuria në shtëpi dhe bindja ndaj prindërve do të rriten. Besimi do të zhvillohet në zemrat e rinisë së Izraelit dhe ata do të fitojnë fuqi për të luftuar ndikimet e liga dhe tundimet që i mësojnë ata.

Vëllezërit tuaj,
JOZEF F. SMITH
ANTON H. LAND
ÇARLS W. PENROUS
Presidenca e Parë ■

IDE



Si mund t'i jap përparësi mbrëmjes familjare?

“Ndërkohë që po veproni për ta forcuar familjen tuaj dhe për ta përmirësuar paqen, kujtoni . . . mbrëmjen familjare të përjavshme. Jini të kujdesshëm të mos e bëni mbrëmjen tuaj familjare thjesht një mendim të mëvonshëm të një dite plot punë. Vendosni që mbrëmjen e së hënës familja juaj do të jetë në shtëpi së bashku për mbrëmjen. Mos i lejoni kërkesat e punësimit, sportet, veprimtari-të jashtëshkollore, detyrat e shkollës apo çfarëdo tjetër që të bëhen më të rëndësishme se sa ajo kohë që kaloni së bashku në shtëpi me familjen tuaj. Struktura e mbrëmjes suaj nuk është aq e rëndësishme sa koha e përfshirë në të. Ungjilli duhet të mësohet si në mënyrë formale, ashtu edhe në mënyrë joformale. Bëjeni atë një përvojë domethënëse për secilin anëtar të familjes.”

Gjithashtu në Këtë Botim

PËR TË RINJTË NË MOSHË MADHORE

SHKO PËRPARA ME **Besim**

Këto katër pikëvështrime nga jeta e Nefit mund t'ju japin mirëbesim në vetë marrjen tuaj të vendimeve.



f. 44

PËR RININË



f. 50

PËR SHKAK TË **JOZEFIT**

Si është e ndryshme jeta juaj për shkak të Profetit Jozef Smith? Merrini parasysh këto gjashtë mënyra.

PËR FËMIJËT

E DI SE JEZUSI MË DO

Bëni broshurën tuaj për t'ju ndihmuar që të jeni nderues gjatë kishës.



f. 76

